



Flamur Sofiu

F i k h u

1

**jurisprudencia
islame**

Prishtinë, 2003

Flamur Sofiu

الفقه الميسر

على مذهب الإمام الأعظم أبي حنيفة النعمان

FIKHU -1

(Jurisprudencia Islame)

كتاب الطهارة

و

كتاب الصلاة

Te drejten Elektronike e ka www.edukataislame.com

Beharbeqiri@hotmail.com

E drejta e Botimit i takon Autorit

Prishtinë 2003

PARATHËNIE

الحمد لله رب العالمين ، الذي رسم طريق المجد للمؤمنين ، و وضع سبيل السعادة للعالمين، و شرع للعالمين مبادئ الخير و الإصلاح ، و الصلاة و السلام على سيدنا محمد المبعوث رحمة للعالمين . أما بعد:

Lënda e Fikhut në Medresenë e mesme “Alauddin” mësohet në të katër vitet. Deri më tash nxënësve të vitit të parë u ka munguar një tekst i tillë. Edhe pse ky tekst mund të jetë i vonuar, besoj që sado pak do t’u dalë ndihmë atyre.

Ky tekst përputhet plotësisht me planprogramin mësimor aktual të lëndës së fikhut. Meqë ky tekst u dedikohet nxënësve të Medresesë, jam munduar që të ketë një stil të lehtë dhe të afërt për nivelin e tyre.

Gjatë shtjellimit dhe elaborimit të njësisë, krejtësisht i jam përmbajtur me dh’hebit hanefi.

Ky tekst është një orvatje modeste dhe shpresoj se do të kihet dobi prej tij.

Jam i vetëdijshëm për ndonjë gabim dhe lëshim eventual që mund të më jetë përvjedhur, prandaj preferoj që sygjerimet dhe vërejtjet tuaja t’i dërgoni, sepse ato do të jenë të mirëseardhura për përpilimin e një teksti më të plotë dhe më të shëndoshë nga të metat dhe gabimet.

Në fund ju shpreh falënderimet e mia të gjithë atyre që kontribuan dhe ndihmuan që ky libër të shohë dritën. Do të veçoja kontributin e pakursyer të drejtorit të Medresesë së mesme “Alaud-din”, prof. Ekrem ef. Simnicën, i cili nuk kurseu asgjë për përgatitjen e këtij libri. Dua t’i falënderoj të gjithë ata që ndihmuan në

aspektin profesional, e, në veçanti, prof. Sabri Bajgorën dhe prof. Emin ef. Behramin, që më sygjerimet dhe vërejtjet e tyre më ndihmuan që ky libër të dalë sa më i plotë.

Autori
9 prill 2003

FIKHU SI SHKENCË

عِلْمُ الْفِقْهِ

Fjala *fikh* në kuptimin etimologjik d.t.th. të kuptuarit, të njohurit, ndërsa në kuptimin terminologjik fikhu është: (أَلْعِلْمُ بِالْأَحْكَامِ الشَّرْعِيَّةِ الْعَمَلِيَّةِ الْمَكْتَسَبِ مِنْ أَدَلَّتِهَا التَّفْصِيلِيَّةِ) “*Njohja e dispozitave të Sheriatit që duhet të zbatohen, e të cilat (dispozitat) rezultojnë nga burimet e sheriatit në mënyrë të hollësishme*”.

Tematikat të cilat i përfshinë kjo shkencë kanë të bëjnë me veprat e të ngarkuarit me obligime fetare si, f.v., të falurit e namazit, të agjëruarit etj.

I ngarkuar me obligime fetare (الْمُكَلَّفُ) konsiderohet ai person i cili është i aftë psikikisht dhe madhor .

Termet që me së shumti do të përdoren gjatë mësimin të kësaj shkence janë:

1. الْفَرَضُ - **farzi**. Me këtë term nënkuptohet obligimi i prerë që duhet ta zbatojë i ngarkuari me obligime, si, f.v., të falurit e namazit, të agjëruarit e ramazanit etj.

2. الْوَأَجِبُ - **vaxhibi**. Me termin *vaxhib* nënkuptohet ai obligim që kërkohet të zbatohet, por është në një kategori më të ulët se *farzi* si psh., të falurit e namazit të vitrit, të falurit e namazit të bajramit etj.

3. السُّنَّةُ - **sunnet**. *Sunnet* konsiderohet ajo vepër e cila po që se zbatohet ka shpërblim e nëse nuk zbatohet ka qortim, por jo edhe dënim.

4. الْمُسْتَحَبُّ ، الْمَنْدُوبُ - **mustehabi, mendubi**. Konsiderohet ajo vepër e cila nëse zbatohet ka shpërblim, e nëse jo nuk ka as qortim e as ndëshkim.

5. **الْحَرَامُ - harami.** *Haram* është ajo vepër që është rreptësisht e ndaluar të veprohet, si: pirja e alkoolit, të bërit amoralitet-zina etj.

6. **الْمَكْرُوهُ تَحْرِيْمًا - mekruhi tahrimen.** *Mekruhi tahrimen* konsiderohet ajo vepër e cila është e urrejtur të veprohet, ai që e kryen ndëshkohet, ndërsa ai i cili nuk e kryen shpërblehet. Si psh. të veshurit e teshave të mëndafshit nga ana e meshkujve etj.

7. **الْمَكْرُوهُ تَنْزِيْهًا - mekruhi tenzihen.** *Mekruhi tenzihen* konsiderohen ato vepra që janë të urrejtura të zbatohen, por vepruesi i tyre nuk ndëshkohet, por qortohet. P.sh. të ngrënit me dorë të majtë etj.

8. **الْمُبَاحُ - mubahi.** *Mubah* konsiderohet ajo vepër që mbetet në zgjedhje të robit të veprojë apo të mos e veprojë.

9. **الْمَذْهَبُ - medh'hebi.** *Medh'heb* është rruga, shkolla apo drejtimi juridik, të cilit *imami-muxhtehidi* i është përmbajtur me rastin e trajtimit të disa çështjeve të *fikhut*. Sot në botë janë të përhapura vetëm këto **medh'hebe**: *hanefinjtë, malikitë, shafi'injtë dhe hanbelinjtë.*

PASTËRTIA

كِتَابُ الطَّهَارَةِ

Në shkencën e *fikhut* me shprehjen الطَّهَارَةُ – pastërtia, kuptohet mënjanimi i ndytësirave lëndore¹ dhe atyre kuptimore².

Rëndësia e pastërtisë sipas Islamit është shumë më rëndësi, ngase Allahu xh.sh. e ka ngritur dhe çmuar pastërtinë në një gradë shumë të lartë, e ajo është që Allahu xh.sh. i do ata të cilët pastrohen. Mu për këtë Allahu thotë: (إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ التَّوَّابِينَ وَيُحِبُّ الْمُتَطَهِّرِينَ) “**Vërtetë Allahu i do ata që pendohen shumë dhe i do të pastërtit**”.³ Allahu i Lartësuar pastërtinë e ka bërë një prej kushtëve qenësore për faljen e namazit, pra, doemos duhet të jetë i pastër trupi, vendi, rrobat etj.

Pastërtia الطَّهَارَةُ nga ndytësirat është dy llojesh:

1. الطَّهَارَةُ عَنِ الْأَخْبَاطِ - Pastrimi nga ndytësirat lëndore.

Me këtë lloj të pastrimit kuptohet pastrimi nga ndytësirat e dukshme (النَّجَاسَةُ الْحَقِيقِيَّةُ) si f.v., pastrimi nga urina, gjaku, coftina etj.

2. الطَّهَارَةُ عَنِ الْأَحْدَاثِ - Pastrimi nga ndytësirat kuptimore. Me pastrimin nga ndytësirat kuptimore (النَّجَاسَةُ الْحُكْمِيَّةُ) synohet pastrimi nga *xhenabeti*, *hajzi* dhe

¹ Ndytësirë lëndore (الْعَبَثُ) konsiderohet ajo ndytësirë e cila është e dukshme si, f.v., urina etj.

² Ndytësirë kuptimore (الْحَدَثُ) konsiderohet ajo ndytësirë që në shikim është e padukshme, por që fetarisht personi konsiderohet i papastër f.v., kur personi është xhunub; femra me menstruacione etj.

³ El-Bekare: 222

nifasi dhe të marrurit *abdest* kur njeriu është pa *abdest*. Gjendja me *xhenabet*, *hajz* dhe *nifas* në shkencën e *fikhut* emërtohet (الْحَدَثُ الْأَكْبَرُ) ndërsa të qenët pa *abdest* quhet (الْحَدَثُ الْأَصْغَرُ).

UJËRAT DHE DISPOZITAT E TYRE

الْمِيَاهُ وَ أَحْكَامُهَا

Ujërat ndahen në këto lloje:

1. أَنْوَاعُ الْمِيَاهِ الَّتِي يَصِحُّ التَّطَهِيرُ بِهَا. –Llojet e ujërave me të cilët është i vlefshëm pastrimi.
2. أَنْوَاعُ الْمِيَاهِ مِنْ حَيْثُ أَوْصَافِهَا الشَّرْعِيَّةِ. –Llojet e ujërave sipas asaj se si i cilëson *Sheriati*.

Ujërat me të cilët është i vlefshëm pastrimi

الْمِيَاهُ الَّتِي يَصِحُّ التَّطَهِيرُ بِهَا

Në këtë lloj të ujërave bëjnë pjesë këta ujëra:

- a. مَاءُ الْمَطَرِ - uji i shiut,
- b. مِيَاهُ الْبُيُوتِ – ujërat e burimeve,
- c. مِيَاهُ الْأَنْهَارِ –ujërat e lumenjve,
- ç. مِيَاهُ الْبِحَارِ -ujërat e deteve,
- d. مِيَاهُ الْأَبَارِ – ujërat e puseve,
- e. مِيَاهُ الْأَوْدِيَةِ – ujërat e përroskave,
- ë. مَاءُ الثَّلْجِ – uji i borës,
- f. مَاءُ الْبُرْدِ – uji i breshërit.

Ujërat sipas asaj se si i cilëson sheriati

الْمِيَاهُ مِنْ حَيْثُ أَوْصَافِهَا الشَّرْعِيَّةُ

Këto lloje të ujërave ndahen në këto grupe:

a. طَاهِرٌ مُطَهَّرٌ – **i pastër në vete dhe i vlefshëm për pastrim.** Ky lloj uji është uji që është i pastër dhe i pa përzier me asgjë. Uji i tillë në *fikh* quhet (الْمَاءُ الْمُطَلَّقُ) ngase posedon të gjitha veçoritë ashtu siç është krijuar. Uji konsiderohet i pastër në vete dhe i vlefshëm për pastrim edhe atëherë kur qëndron gjatë në një vend dhe aty të jenë formuar algat. Po që se ndodhë që në këtë rast këtij uji t'i ndryshojë ngjyra duke marrë ngjyrën e vendit ku qëndron, ai konsiderohet i pastër dhe i vlefshëm për pastrim.

b. طَاهِرٌ مُطَهَّرٌ لَكِنَّهُ مَكْرُوهٌ الْإِسْتِعْمَالِ تَنْزِيهًا – **i pastër në vete dhe i vlefshëm për pastrim, por përdorimi i tij është mekruhi tenzihen.** Në këtë grup të ujit bën pjesë uji në të cilin ka pirë macja, miu, pula, shpenzët etj. Përdorimi i këtij uji është *mekruhi tenzihen* po që se kemi ujë tjetër, e nëse nuk ka ujë tjetër përveç këtij, atëherë, nuk është *mekruh* të merret *abdest* me të.

c. طَاهِرٌ فِي نَفْسِهِ غَيْرٌ مُطَهَّرٌ لِلْحَدَثِ بِخِلَافِ الْخَبَثِ – **i pastër në vete, por jo i vlefshëm për të pastruar ndytësirën kuptimore, anipse e pastron ndytësirën lëndore.** Ky lloj uji është i pastër në vete dhe mund të përdoret për pastrimin e ndytësirës lëndore si, f.v., pastrimin e rrobave, të duarve etj., mirëpo, me të nuk mund të merret *abdest* dhe as të pastrohemi nga *xhenabeti*. Në këtë grup të ujit përfshihen tri lloje të ujit:

1. **الْمَاءُ الْمُسْتَعْمَلُ** - **Uji i përdorur**. Uji i përdorur konsiderohet uji që është përdorur njëherë për *abdest*, apo për evitimin e *xhenabetit*. Uji i tillë është i pastër, por nuk vlen për marrje të abdestit dhe as për pastrim nga *xhenabeti*.

2. **الْمَاءُ الْمَخْلُوطُ مِنَ الْمَائِعَاتِ** - **Uji i përzier me elemente të lëngëta**. Ky lloj i ujit është i përzier me ndonjë lëng dhe, i tilli konsiderohet i pastër në vete, por nuk vlen për pastrim nga ndytësira kuptimore.

3. **الْمَاءُ الْمَخْلُوطُ مِنَ الْجَامِدَاتِ الطَّاهِرَاتِ** - **Uji i përzier me elemente të ngurta e të pastra**. Kur ndodhë që uji është i përzierë me diçka të ngurtë dhe të pastër, i tilli është i pastër në vete por nuk ka veçori pastruese.

4. **مَاءُ الْأَزْهَارِ وَالتَّمَارِ** - **Lengu i luleve dhe i pemëve**. Po ashtu lengu i luleve dhe i pemëve konsiderohet i pastër në vete por nuk ka veçori pastruese.

ج. **الْمَاءُ الْمَشْكُوكُ** - **Uji i dyshimtë**. Uji i dyshimtë konsiderohet uji në të cilin ka pirë apo llapitur gomari ose mushka. Ky ujë në vete është i pastër por është i dyshimtë pastrimi me të, mirëpo, kur jemi të detyruar ta përdorim, në rast mungese, lejohet të marrim *abdest* me këtë ujë, por, krahas abdestit duhet të marrim edhe *tejemum*.

d. **الْمَاءُ النَّجِسُ** - **Uji i ndytë**. Uji i ndytë konsiderohet uji në të cilin ka rënë ndonjë ndytësisrë, por, pavarsisht nëse i është ndryshuar ndonjë veçori, uji i tillë konsiderohet i ndytë dhe nuk është i pastër as në vete e as nuk ka veçori pastruese. Pra, me ujin e tillë nuk mund të vijë në shprehje pastrimi as i ndytësisrës lëndore e as i asaj kuptimore. Kur ndodhë që uji, në të

cilin ka rënë ndytësira, është i palevizëshem dhe i paktë konsiderohet i ndytë, e, po që se uji në të cilin ka rënë ndytësira levizë ose nuk levizë, por megjithatë sasia e tij është e madhe, atëherë, uji i tillë konsiderohet i pastër.

S'URI DHE DISPOZITAT E TIJ

أَحْكَامُ الْأَسَارِ

Su'ri është uji i pakët e i mbetur pasi në të ka pirë njeriu apo ndonjë gjallesë tjetër. Ky lloj i ujit ndahet në katër grupe:

1. سُورٌ طَاهِرٌ مُطَهَّرٌ. **su'ri i cili në vete është i pastër dhe ka veti pastruese**⁴. Në këtë lloj të *su'rit* bën pjesë ai lloj i ujit në të cilin ka pirë njeriu⁵, shtazët⁶ mishi i të cilave është *hallall* të hahet dhe shpezët që nuk janë shkyese. Po që se ndodhë që lopa ha gjëra të flliqëta dhe e tilla llapitë në këtë *su'r* atëherë uji i tillë është *mekruh* të përdoret.

2. سُورٌ نَجِسٌ لَا يَجُوزُ اسْتِعْمَالُهُ. **su'ri i cili është i ndytë dhe nuk lejohet përdorimi i tij**. Ky lloj i *su'rit* është ai lloj uji në të cilin ka pirë qeni, derri dhe ndonjë shtazë e

⁴Për atë se ky lloj i *su'rit* konsiderohet i pastër kemi argument transmetimin që e bën Buhariu: أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ شَرِبَ وَأَعْطَى فَضَّلَ سُورَهُ اِعْرَابِيًّا عَنْ يَمِينِهِ فَشَرِبَ ثُمَّ شَرِبَ أَبُو بَكْرٍ سُورَ الْأَعْرَابِيِّ "Pejgamberi s.a.w.s. ka pirë ujë dhe i ka dhënë atë që ka mbetur beduinit i cili ishte në anën e djathtë të tij, e i cili piu, e pastaj e piu Ebu Bekrin atë që kishte mbetur prej beduinit".

⁵ Me njeriun në këtë rast nuk duhet të kuptohet vetëm muslimani, por edhe nëse jomuslimani pi ujë, uji i tillë është i pastër dhe ka cilësi pastruese. Po ashtu uji është i pastër dhe ka cilësi pastruese edhe nëse njeriu që ka pirë ujë është xhunub apo femra është me menstruacione ose në kohën e pas lindjes.

⁶ Shtazët që u hahet mishi janë: deveja, lopa, delja etj.

egër dhembëshkyese si, f.v., luani, tigri, ujku, hijena, dhelpra etj.

3. سُورٌ طَاهِرٌ مَكْرُوهٌ اسْتِعْمَالُهُ كَرَاهَةٌ تَنْزِيهِهِ - **Su'ri i cili është i pastër, por përdorimi i tij është mekruhi tenzihen.** *Su'ri* i tillë është ai ujë në të cilin ka pirë macja shtëpiake, pula dhe shpezët të cilët kanë kthetra. Ky lloj i *su'rit* nuk është *mekruhi tenzihen* të përdoret nëse nuk ka ujë tjetër.

4. سُورٌ مَشْكُوكٌ فِي حُكْمِ طَهْوَرِيَّتِهِ - **Su'ri i cili është i dyshimtë në pastërtinë e tij.** Ky lloj i *su'rit* është uji në të cilin ka pirë mushka apo gomari. Me këtë lloj të ujit mund të merret abdest kur nuk ka ujë tjetër por, pas abdestit, duhet të merret edhe *tejemum*.

PUSI DHE DISPOZITAT E TIJ

أَحْكَامُ الْآبَارِ

Rreth ujit të pusit ekzistojnë këto dispozita:

1. Kur ndodhë që në pus të bie ndonjë gjallesë dhe nxirret e gjallë, atëherë na paraqiten dy gjendje:

a. Nëse gjallesa e cila ka rënë në esencë nuk është e ndytë si, f.v., delja, lopa etj. dhe nëse ato nuk kanë pasur ndytësi, atëherë nuk është obligim të hiqet diçka nga uji, por preferohet që të zbrasen 20 kofa. Uji i tillë konsiderohet i pastër. E po që se ndodhë që shtaza e cila në esencë është e pastër, por ka pasur ndytësi, atëherë, uji i tillë konsiderohet i ndytë.

b. Nëse gjallesa e rënë në esencë është e ndytë si, f.v., derri, qeni etj., atëherë duhet që uji të nxirret i tëri nëse është e mundur, e nëse jo, duhet nxjerrë 200 kofa ujë.

2. Nëse gjallesa e cila ka gjak siç është njeriu, delja etj. dhe po që se kjo gjallesë fryhet apo kalbet, sa që i shkëputen gjymtyrët, apo i bien qimet, atëherë uji i këtij pusi konsiderohet i papastër, dhe pusi i tillë mund të pastrohet vetëm pasi t'i nxirret i tërë uji. Po që se ndodhë që nuk mund t'i nxirret i tërë uji, atëherë, së paku të nxirren 200 kofa të ujit. Pastrimi i pusit të tillë bëhet atëherë kur të nxirret ngordhësira.

3. Kur ndodhë që në pus mbytet ndonjë gjallesë që ka gjak, por nuk është e fryrë, dhe as e kalbur, në këtë rast paraqiten tri gjendje:

a. Nëse gjallesa e mbytur është njeri apo dele, atëherë duhet nxjerrë gjithë ujin ose së paku 200 kofa.

b. Po që se gjallesa është e vogël, si, f.v., pula, maceja etj., dhe e tilla ka ngordhur por nuk është fryrë e as kalbur sa që t'i bien qimet, pusi do të konsiderohet i pastër pasi të jenë nxjerrur 40 kofa.

c. Kur ndodhë që gjallesa është e vogël si, f.v., zogu, miu etj. uji i tillë do të konsiderohet i pastër pasi të nxirren 20 kofa ujë.

Shënim: Uji i pusit konsiderohet i pastër edhe pse ka rënë diçka në të, në këto raste:

1. Kur në pusë bien glasat e zogut, pëllumbit e të ngjashëm.

2. Nuk konsiderohet i ndytë pusi po që se në të ka ngordhë ndonjë gjallesë që nuk ka gjak si, f.v., peshku, akrepi, etj.

3. Nuk e ndotë pusin nëse në të ngordhë ndonjë gjallesë që jeton në ujë si, f.v., bretkosa etj.

Kur fillohet me pastrimin e pusit, së pari duhet të nxirret gjallesa e ngordhur, e pastaj të pastrohet pusi, litari dhe kofa.

NDYTËSIRAT DHE MËNYRA E PASTRIMIT TË TYRE

النجاسات و كيفية تطهيرها

Ndytësirat fillimisht ndahen në dy grupe:

1. نَجَاسَةٌ حَقِيقِيَّةٌ – ndytësirë e dukshme-lëndore.
2. نَجَاسَةٌ حُكْمِيَّةٌ – ndytësirë e padukshme-kuptimore.

Ndytësirat e dukshme-lëndore ndahen në dy grupe:

- a. نَجَاسَةٌ مَغْلُظَةٌ – ndytësirë e madhe.
- b. نَجَاسَةٌ مَخْفِيَّةٌ – ndytësirë e vogël.

Në grupin e ndytësirave të mëdha bëjnë pjesë:

1. **Gjaku i cili rrjedh nga njeriu apo nga ndonjë shtazë.** Kur kemi të bëjmë me gjakun i cili nuk rrjedh por ka mbetur në mish, gjaku i tillë nuk konsiderohet ndytësirë, po ashtu gjaku i shtazëve që jetojnë në ujë dhe gjaku i ndonjë mize apo mushkonje që ka pak gjak nuk konsiderohet ndytësirë.

2. **Çdo gjë që del nga trupi i njeriut dhe e prish abdestin,** si psh. Urina, nevoja e madhe, sperma etj.

3. **Ngordhësira.** Në grupin e ngordhësirave bëjnë pjesë të gjitha ato shtazë që sipas shariatit konsiderohen të ngrodhura si, f.v., shtaza e therur jo sipas shariatit. Shtazët që jetojnë në ujë edhe nëse kanë ngordhur nuk konsiderohen ndytësira. Si mishi po ashtu edhe lëkura e ngordhësirës konsiderohet ndytësirë.

4. **Vera.**

5. **Urina e kafshëve që nuk u hahet mishi.**

6. **Urina e kafshëve mishngrënëse dhe jargët e tyre.**

7. **Urina e shpezëve shtëpiake.**

8. **Qeni dhe derri.**

Në grupin e ndytësirave të lehta bëjnë pjesë:

1. **Urina e kafshëve që u hahet mishi.**

2. **Urina e kalit.**

3. **Urina e shpezëve që nuk u hahet mishi.**

Shënim: Masa e ndytësirës së rëndë në gjendje të ngurtë kap peshën e një *dërhem* (afër 4 gr. e gjysmë), ndërsa ndytësira në gjendje të lengët, sa mund të mbajë grushti i shtrirë i dorës. Ndërsa ndytësirë e lehtë konsiderohet ajo që përfshinë 1/4 e më pak të petkut, respektivisht të trupit të njeriut.

Mënyrat e pastrimit të ndytësirës:

Të gjithë dijetarët janë unanimes për faktin se vendet që duhet të janë të pastra për t'u falur namazi janë: trupi, rrobat dhe vendi ku do të falet namazi. Si mënyra të pastrimit, përveç pastrimit me ujë, mund të përmendim:

1. **Fërkimi.** Me fërkim mund të pastrohet vendi i pikur prej spermës së tharë, pavarësisht se sperma e kujt është, e mashkullit apo e femrës⁷.

2. **Shkundja.** Me anë të shkundjes mund të pastrohet pambuku i ndytë, po që se ndytësira është pak,

⁷ Për këtë si argument kemi thënëjen e Aishes r.a. e cila ka thënë: *كُنْتُ أَفْرِكُ الْمَنِيِّ فِيَّ* "Unë e kam fërkuar spermën e Pejgamberit të Zotit kur ajo ishte e tharë, ndërsa e kam pastruar kur ishte e lengët". (Buhariu dhe Muslimi).

dhe me anë të shkundjes mund të menjanohen shenjat e papastërtisë.

3. **Rexhja.** Rexhja pastron lekurën e çdo kafshe me përjashtim të lekurës së derrit dhe të qenit.

4. **Evitimi i ndytësirës.** Me anë të evitimit apo mënjanimi të ndytësirës pastrohet tlyeni i ngurtë, apo të ngjashëm me të⁸.

5. **Tharja-Terja.** Toka pastrohet me terjen dhe tharjen e ndytësirës.⁹

6. **Mes'hi.** Me anë të mes'hit mund të pastrohet çdo send i ngurtë, siç është shpata, qelqi, enët etj.¹⁰

7. **Therja Islame.** Kur ndodhë muslimani ther ndonjë kafshë që nuk i hahet mishi, atëherë me anë të therjes mund të pastrohet vetëm lëkura e jo edhe mishi.

8. **Shndërrimi i një materjeje në materje tjetër.** Si, f.v., kur alkooli shndërrohet në uthull; kur ngordhësira shndërrohet në hi etj.

⁸ Argument për këtë është hadithi i Pejgamberit s.a.w.s.: *أَلْقَوْهَا وَ مَا حَوْلَهَا فَطَرَحُوهُ وَ كُلُوا*: "Hudhe atë dhe atë për rreth, dhe hane tlyenin tuaj". (Buhari).

⁹ Si argument për këtë kemi rastin e Ibn Umerit r.a.: *كُنْتُ أَيْتُ فِي الْمَسْجِدِ فِي عَهْدِ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وَ كُنْتُ شَابًا عَزَبًا وَ كَانَتْ الْكِلَابُ تُبُولُ وَ تَقْبِلُ وَ تُدْبِرُ فِي الْمَسْجِدِ فَلَمْ يَكُونُوا يَرُشُونَ شَيْئًا* "Unë kam banuar në xhami në kohën e Pejgamberit s.a.w.s., atëherë isha i ri dhe i pamartuar, qentë urinonin rreth xhamisë dhe nuk hudhnin ujë në vendet e urinës". (Ebu Davudi).

¹⁰ Argument për këtë është veprimi i sahabëve të Pejgamberit s.a.w.s. të cilët kur luftonin shpatat e tyre ishin të përgjakura, i pastronin ato duke i fshirë-mes'h dhe faleshin me to.

PASTRIMI I VENDDALJES SË NEVOJËS SË MADHE DHE TË VOGËL

الإِسْتِجَاءُ وَ الإِسْتِثْرَاءُ

Me shprehjen *الإِسْتِجَاءُ* nënkuptohet pastrimi i venddaljes së nevojës së madhe, ndërsa me shprehjen *الإِسْتِثْرَاءُ* nënkuptohet pastrimi dhe terja e venddaljes së urinës ose nevojës së madhe.

Pastrimi i venddaljes se nevojës së madhe mund të jetë:

1. Farz- Kur ndodhë që ndytësira të shtrihet dhe të tejkalojë masën e caktuar atëherë pastrimi në këtë rast është farz.

2. Vaxhib- Po që se ndodhë që ndytësira nuk e tejkalon masën e një *dërhem* atëherë pastrimi në këtë rast është vaxhib.

3. Sunnet- Kur ndodhë që ndytësira nuk është shtrirë përtej pjesës fundore-zgurdhës, pastrimi në këtë rast është sunnet.

Pastrimi i venddaljes pas kryerejs së nevojës së madhe më së miri është të bëhet me ujë, po nëse nuk ka ujë mund të pastrohet me gur e të ngjashme. Me rastin e pastrimit duhet patur kujdes që ndytësira në tërësi të pastrohet. Pas çdo pastrimi të ndytësirës është mirë që duart të lahen mirë e mirë me sapun.

Sunnetet dhe mustehabet e pastrimit prej nevojës së madhe

سنن الإستنجاء و مستحباته

1. Të pastruarit së paku tri herë venddaljen e nevojës së madhe.
2. Të pastruarit me elemente që mund të përdoren për pastrim si, f.v., uji, dheu, gurët etj. Nuk lejohet të përdoren për pastrim thengjilli, guri i lëmuar, xhami apo ndonjë pëlhurë që ka vlerë etj.
3. Që pastrimi të bëhet me dorën e majtë.¹¹
4. Që të mos bëhet pastrimi me eshtra dhe bajga.¹²
5. Duhet që të kryhet nevoja në ndonjë vend ku nuk mund shihet nga të tjerët.

Çka rekomandohet dhe çka urrehet gjatë kryerjes së nevojës

آداب التحلي و مكروهاته

1. Që në nevojto të hyhet me këmbën e majtë e të dilet me këmbën e djathtë.

¹¹ Për këtë Pejgamberi s.a.w.s. ka thënë: إِذَا بَالَ أَحَدُكُمْ فَلَا يَمْسَحُ بِيَمِينِهِ وَإِذَا أَتَى الْخَلَاءَ فَلَا يَبْسُجُ بِيَمِينِهِ... "Kur të urinojë dikush prej jush të mos e fshijë me dorën e djathtë, dhe kur të shkojë dikush në nevojto të mos e pastrojë ndytësirën me dorën e djathtë...". (Buhariu, Muslimi dhe të tjerët).

¹² Ebu Hurejrete r.a. transmeton se Pejgamberi s.a.w.s.i ka thënë atij: أُنْبِئِي أَحِبَّارًا: "Më sill mua gurë për ta pastruar venddaljen e urinës, e mos më sill eshtra dhe bajga! E unë i thash: çka është problemi i eshtrave dhe bajgave? Ato dyja janë ushqim i exhinëve". (Buhariu).

2. Para hyrjes të thuhet kjo dua:

(اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْخَبْثِ وَالْخَبَائِثِ).

3. Urrehet të hyhet në nevojtoje me *Mus'haf* apo me diç që në të është i shkruar emri i Allahut xh.sh.

4. Gjatë kryerjes së nevojës nuk duhet kthyer nga kibla as nga ana e kundërt e kiblës.¹³

Të mos kryhet nevoja në atë rrugë ku kalojnë njerëzit, apo në vendet ku ka hije që mund të pushojnë njerëzit.

5. Të mos flitet duke e kryer nevojën, prejashtimisht në raste të domosdoshme.

6. Që të mos qendrohet në nevojtoje gjatë pa pasur nevojë.

7. Kur të dilet prej nevojtores të lexohet kjo dua:

(الْحَمْدُ الَّذِي أَذْهَبَ عَنِّي الْأَذَى وَ عَافَانِي).

¹³ Argument për këtë është hadithi i Pejgamberit s.a.w.s.: لَا تَسْتَقْبِلُوا الْقِبْلَةَ وَلَا تَسْتَدْبِرُوهَا " (Kur ta kryeni nevojën), mos u ktheheni nga kibla e as kah ana e kundërt e saj, por kthehuni nga lindja apo perëndimi". (Buhariu dhe Muslimi).

A B D E S T I

الْوُضُوءُ

Me shprehjen الوُضُوءُ në jurisprudencen islame kuptohet pastrimi specifik i cili bëhet para se të hyhet në namaz. Në këtë pastrim përfshihet pastrimi i tri gjymtyrëve të trupit dhe mes'hi i kokës me të cilin plotësohet kushti për kryerjen e ibadeteve.

Abdesti është një prej kushteve që namazi të konsiderohet i vlefshëm. Allahu xh.sh. për këtë thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا قُمْتُمْ إِلَى الصَّلَاةِ فَاغْسِلُوا وُجُوهَكُمْ وَأَيْدِيَكُمْ إِلَى الْمَرَافِقِ
(وَأَمْسَحُوا بِرُءُوسِكُمْ وَأَرْجُلَكُمْ إِلَى الْكَعْبَيْنِ)

"O ju që keni besuar, kur të ngriteni për t'u falur, pastroni fytyrat tuaja, duart deri në bërryla, fërkoni kokat tuaja dhe lani këmbët deri në dy zogjët".¹⁴

Po ashtu ka shumë hadithe të Pejgamberit s.a.w.s. të cilët flasin për vleren dhe dobin e abdestit, e ne po e përmendim këtë:

إِنَّ أُمَّتِي يُدْعَوْنَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ غُرًّا مُحَجَّلِينَ مِنْ آثَارِ الْوُضُوءِ فَمَنْ اسْتَطَاعَ
مِنْكُمْ أَنْ يُطِيلَ غُرَّتَهُ فَلْيَفْعَلْ

"Vërtetë, Ummeti im Ditën e Gjykimit do të thirren sipas shenjës së bardhë në ballë, këmbëve dhe durave të bardha nga gjurmët e abdestit. Kush ka mundësi ta rrisë shenjën e tij, le ta rrisë".¹⁵

¹⁴ El-Maide: 6

¹⁵ Buhariu

Kushtet e abdestit

شُرُوطُ الْوُضُوءِ

Kushtet për të qenë i vlefshëm abdesti janë:

1. Që të pastrohen të gjitha gjymtyrët e caktuara dhe të mos mbetet asnjëra prej tyre pa u pastruar. Po që se ndodhë që të mbetet pa u pastruar ndonjë pjesë e vogël e gjymtyrëve pa u pastruar, pastrimi i të cilave është *farz*, atëherë abdesti nuk është i vlefshëm.

2. Të evitohet çdo gjë që e prish abdestin para se të fillohet marrja e abdestit.

3. Gjymtyra e cila duhet të pastrohet, të mos ketë ndonjë pengesë që të pengojë depërtimin e ujit në lëkurë, si psh.: vaji, manykiri etj.

Kushtet e obligueshmërisë së abdestit

Për të qënë abdesti detyrim i domosdoshëm duhet të plotësohen këto kushte:

1. të jesh i mençur,
2. të jesh i moshrritur,
3. të jesh musliman,
4. të kesh ujë të mjaftueshëm për të marrë abdest,
5. të jetë abdesi i prishur,
6. femra të jetë e pastër nga menstruacionet dhe nga koha e lehonisë.

Farzet e abdestit

فَرَائِضُ الوُضُوءِ

Farzet e abdestit janë katër:

1. **غَسَلُ الوَجهِ مَرَّةً وَاحِدَةً** - **Larja e fytyrës një herë.**¹⁶ Me pastrimin apo larjen e fytyrës nënkuptohet pastrimi i tërësishëm i fytyrës duke filluar nga rrenjët e flokëve dhe deri në fund të arrëzës së fytit, pastaj nga veshi i djathtë e deri tek i majti. Duhet patur kujdes që gjatë pastrimit të vetullave dhe të mustaqeve uji të depërtojë deri në rrenjët e qimeve. Ndërsa, sa i përketë mjekrës, duhet pasur parasysh madhësinë e saj, po që se mjekra është e shkurtër, atëherë uji duhet depërtuar në lëkurë, e nëse është më e gjatë se tre gishta nuk obligohet depërtimi i ujit në lëkurë, por pastrimi sipërfaqësor është obligim. Po ashtu gjatë pastrimit të fytyrës nuk obligohet depërtimi i ujit në brendësi të buzëve, ngase brendësia e buzëve konsiderohet pjesë e brendshme e gojës.

2. **غَسَلُ اليَدَيْنِ مَعَ المِرْفَقَيْنِ مَرَّةً وَاحِدَةً** - **Pastrimi i duarve deri në bërryla vetëm një herë.**¹⁷ Pastrimi i bërrylave konsiderohet *farz*.

¹⁶ Argument për këtë është fjala e Allahut xh.sh. : (فَاغْسِلُوا وُجُوهَكُمْ) "...*lani fytyrat tuaja...*".

¹⁷ Argument për këtë është ajeti: (وَأَيْدِيكُمْ إِلَى المِرْفَاقِ) "...*dhe duart tuaja deri në bërryla...*".

3. مَسْحُ رُبْعِ الرَّأْسِ مَرَّةً وَاحِدَةً. - **Dhënia mes'h 1/4 të kokës, një herë.**¹⁸ Të dhënit *mes'h* kokës nënkupton fërkimin e 1/4 së kokës me dorën e lagur.

4. غَسْلُ الْقَدَمَيْنِ مَعَ الْكَعْبَيْنِ مَرَّةً وَاحِدَةً. - **Pastrimi i këmbeve deri mbi zogjët e këmbeve, një herë.**¹⁹

Sunnetet e abdestit

سُنُنُ الْوُضُوءِ

Sunnetet e abdestit janë:

1. النِّيَّةُ - **nijjeti.** Nijjeti mund të shqiptohet me gjuhë, por vlen edhe vetëm me zemër.

2. التَّسْمِيَةُ - **të përmendurit emrin e Allahut**²⁰.

3. غَسْلُ الْيَدَيْنِ إِلَى الرُّسْغَيْنِ. - **pastrimi i duarve deri në nyje.**²¹

4. تَخْلِيلُ الْأَصَابِعِ الْيَدَيْنِ وَالْقَدَمَيْنِ. - **fërkimi i gishtave të duarve dhe të këmbeve.**

5. الْإِسْتِيَاكُ عِنْدَ الْمَضْمَاطَةِ. - **pastrimi i dhëmbëve me misvak.**²²

¹⁸ Këtë e argumenton ajeti: (وَأَمْسَحُوا بِرُءُوسِكُمْ) " ... *fërkoni kokat tuaja...* ".

¹⁹ Argument për këtë është ajeti : (وَأَرْجُلَكُمْ إِلَى الْكَعْبَيْنِ) " ...*lani këmbet deri në dy zogjët...* ".

²⁰ Pejgamberi s.a.w.s. për këtë çështje ka thenë: (لَا وَضُوءَ لِمَنْ لَمْ يَذْكُرْ اسْمَ اللَّهِ عَلَيْهِ) " *Nuk ka abdest të plotë ai cili nuk fillon me bismilah*". (Ibn Maxhe).

²¹ Argument për këtë është hadithi i Pejgamberit s.a.w.s.: إِذَا اسْتَيْقَظَ أَحَدُكُمْ مِنْ نَوْمِهِ فَلَا يَغْسِلُ يَدَهُ فِي وَضُوئِهِ حَتَّى يَغْسِلَهَا ثَلَاثًا فَإِنْ أَحَدَكُمْ لَا يَذْرِي أَيْنَ بَاتَتْ يَدُهُ *Kur të zgjohet ndonjëri prej jush nga gjumi, mos t'i fusë duart e tij për të marrë abdest derisa t'i pastrojë tri herë, sepse ai nuk e di se ku kanë qendruar duart e tij gjatë gjumit*". (Nesaiu).

6. **الْمُضْمَصَةُ وَالِاسْتِنْشَاقُ ثَلَاثًا** - pastrimi i gojës dhe i hundës tri herë.²³

7. **تَخْلِيلُ اللَّحْيَةِ** - fërkimi i mjekrës.²⁴ Fërkimi i mjekrës bëhet në atë mënyrë që të fillohet prej anës së poshtme përpjetë.

8. **تَنْلِيثُ الْغُسْلِ** - pastrimi tri herë i duarve, fytyrës dhe i këmbëve.²⁵

9. **اسْتِيعَابُ الرَّأْسِ بِالْمَسْحِ مَرَّةً وَاحِدَةً** - përfshirja e kokës me dorë të lagët një herë.

10. **مَسْحُ الْأُذُنَيْنِ** - mes'hi i veshëve me dorë të lagur.²⁶

11. **الْبَدْءُ بِالْيَمِينِ عِنْدَ غَسْلِ الْيَدَيْنِ وَالْقَدَمَيْنِ** - të fillohet nga ana e djathtë pastrimi i duarve dhe i këmbëve.²⁷

12. **مَسْحُ الرَّقَبَةِ** - të dhenit mes'h qafës.²⁸ Kur t'i jepet mes'h qafës kurresesi nuk lejohet t'i jepet mes'h edhe fytit.

²² Këtë e argumenton hadithi: (لَوْ لَا أَنْ أَشَقُّ عَلَى أُمَّتِي لِأَمْرِهِمْ بِالسَّوَاكِ مَعَ كُلِّ وُضُوءٍ) "Sikur të mos bëhej ngarkesë për ummetin tim, do të urdhëroja që t'i pastrojnë dhëmbët me misvak për çdo abdest". Transmeton Teberaniu.

²³ Pejgamberi s.a.w.s. ka thënë: (مَنْ تَوَضَّأَ فَلْيَسْتِثْرِ) "Kush merr abdest le të fusë ujin thellë në hundë". (Buhariu).

²⁴ Këtë e argumenton veprimi i Pejgamberit s.a.w.s.: أَنْ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَانَ يَخْلِلُ "Pejgamberi s.a.w.s. vërtetë e ka fërkuar mjekren e tij". (Ibn Maxhe dhe Tirmidhiu).

²⁵ Këtë e argumentojnë shumë hadithe të sakta kur shpjegojnë metodën e abdestit nga ana e Pejgamberit s.a.w.s.

²⁶ Pejgamberi s.a.w.s. ka thënë: (الْأُذُنَانِ مِنَ الرَّأْسِ) "Veshët janë pjesë të kokës". (Ibn Maxhe).

²⁷ Argument është veprimi i Pejgamberit s.a.w.s. i cili gjithmonë punët i fillonte nga e djathta. Po ashtu mund të përmendim edhe këtë hadith: إِذَا لَبَسْتُمْ وَإِذَا تَوَضَّأْتُمْ فَإَبْدُؤُوا بِأَيْمَانِكُمْ "Kur të visheni dhe të filloni abdestin filloni nga ana e djathtë". (Ahmedi).

13. التَّيْبُ - të pastruarit e gjymtyrëve sipas rradhës që është e përcaktuar, kur të merret abdest.

14. الْمَوَالَةَ - të marrurit abdest pa ndërprerje deri në fund.

Adabet e abdestit

آدابُ الوُضوءِ

Adabet e abdestit janë:

1. الْجُلُوسُ فِي مَكَانٍ مُرْتَفِعٍ تَحَرُّزًا عَنِ الْعَسَالَةِ - të ulurit në një vend të lartë nga toka, në mënyrë që të ruhet nga stërpikja e ujit.

2. اسْتِقْبَالُ الْقِبْلَةِ إِنْ تَيَسَّرَ - të kthyerit nga kibla nëse është e mundur.

3. عَدَمُ التَّكَلُّمِ بِكَلَامِ النَّاسِ - të mos bisedohet duke marrë abdest.

4. عَدَمُ الاسْتِعَانَةِ بِغَيْرِهِ مِنْ غَيْرِ عُدْرِ بِهِ - të mos kërkohet ndihmë nga tjetri pa nevojë të arsyeshme.

5. الْجَمْعُ بَيْنَ نِيَّةِ الْقَلْبِ وَفِعْلِ اللِّسَانِ - të bashkuarit e nijetit me zemër dhe me gjuhë.

6. التَّسْمِيَةُ وَالنِّيَّةُ عِنْدَ غُسْلِ كُلِّ عُضْوٍ - të shqiptohet *besmelja* dhe *nijjeti* në pastrimin e çdo gjymtyre.

²⁸ Argument është hadithi të cilin e transmeton Taberaniu nga Ke'ab ibn Amer el-Jamij i cili ka thënë: *أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ تَوَضَّأَ فَمَضْمَضَ ثَلَاثًا وَاسْتَنْشَقَ ثَلَاثًا، يَأْخُذُ لِكُلِّ وَاحِدَةٍ مَاءً جَدِيدًا وَغَسَلَ وَجْهَهُ ثَلَاثًا فَلَمَّا مَسَحَ رَأْسَهُ قَالَ هَكَذَا وَ أَوْمَأَ بِيَدِهِ مِنْ مُقَدِّمِ رَأْسِهِ حَتَّى بَلَغَ بِهِمَا إِلَى أَسْفَلِ* "Vërtetë Pejgamberi s.a.w.s. kur merrte abdest e pastronte tri herë gojën dhe tri herë hundën, për çdo herë merrte ujë të ri, e ka pastronte tri herë fytyrën dhe kur i jepte mes'h kokës së tij fillonte prej fillimit të flokëve e deri në fund të qafës". Po ashtu transmetohet se kur Ibn Umeri r.a. ka marrë abdest i ka dhenë mes'h qafës. Sipas disa djetarëve hanefinj të dhënit mes'h qafës është mendub e jo sunnet.

7. -تَحْرِيكُ الْخَاتِمِ الْوَاسِعِ- të lëvizurit e unazës nëse ajo është e gjerë në gisht. Po që se ndodhë që unaza të jetë e ngushtë në gisht, atëherë doemos duhet hequr atë kur të marrim abdest, ngase në këtë rast uji nuk ka mundësi të depërtojë në vendin ku është unaza.

8. -إِدْخَالُ خِنْصَرِهِ فِي صَمَاحِ أُذُنَيْهِ مُبَالَغَةً فِي الْمَسْحِ- të pastrohet brendësia e veshëve, me qëllim që të arrijë pastrimin.

9. -كَوْنُ الْمَضْمُضَةِ وَالْإِسْتِنْشَاقِ بِالْيَمَنِ وَالْإِمْتِخَاطِ بِالْيَسْرَى- të futurit ujë në gojë dhe në hundë me dorë të djathtë, ndërsa qyrrat të pastrohen me dorë të majtë.

10. -تَقْدِيمُ الْوُضُوءِ قَبْلَ دُخُولِ الْوَقْتِ لِغَيْرِ الْمَعْدُورِ- të merret abdest para se të hyjë koha e namazit për atë i cili nuk ka arsye që të vonojë marrjen e abdestit.

11. -أَنْ يَشْرَبَ مِنْ فَضْلِ وَضُوئِهِ مُسْتَقْبِلَ الْقِبْلَةِ- që të pijë ujë pas marrjes abdest i drejtuar nga kibla.

12. -الِإِثْيَانُ بِالشَّهَادَتَيْنِ بَعْدَهُ فَإِنَّمَا مُسْتَقْبِلَ الْقِبْلَةِ- të shqiptohet shehadeti në fund të abdestit duke qëndruar në këmbë dhe i drejtuar nga kibla.

13. Pas marrjes abdest të thuhet kjo dua: (اللَّهُمَّ اجْعَلْنِي مِنَ التَّوَّابِينَ وَاجْعَلْنِي مِنَ الْمُتَطَهِّرِينَ).

14. -تَرْكُ التَّجْفِيفِ إِبْقَاءَ عَلَى آثَارِ الْوُضُوءِ- të mos fshihet me peshqir pas marrjes së abdestit, me qëllim që të ngelin gjurmët e marrjes së abdestit.

15. -إِطَالَةُ الْغُرَّةِ وَالتَّحْجِيلِ- të bëjë pastrimin e fytyrës, duarve dhe këmbëve me sipërfaqe më të madhe se sa është *farz*.

Mekruhet e abdestit

مَكْرُوهَاتُ الْوُضُوءِ

Mekruhet e abdestit janë:

1. الإسْرَافُ فِي صَبِّ الْمَاءِ - shpenzimi i tepërt i ujit²⁹.
2. التَّقْتِيرُ بِإِسْتِعْمَالِ الْمَاءِ - që uji të mos jetë i pakët³⁰. Uji kur të merret abdest duhet të jetë i mjaftueshëm sa për t'i lagur gjymtyrët të cilat duhet të pastrohen.
3. الزِّيَادَةُ عَلَى الْقَدْرِ الْمَسْنُونِ - pastrimi më tepër sesa është *sunnet*. Me këtë nënkuptohet që gjymtyrët e trupit të mos pastrohen më tepër se tri herë.
4. ضَرْبُ الْوَجْهِ بِالْمَاءِ - përplasja e ujit për fytyrë.
5. التَّكَلُّمُ بِكَلَامِ النَّاسِ - të biseduarit me tjerët.
6. الإِسْتِعَانَةُ بِالْغَيْرِ بِغَيْرِ عُدْرٍ - të ndihmohet nga të tjerët në marrjen e abdestit pa arsye të justifikueshme.³¹
7. الْمُبَالَغَةُ فِي الْمَضْمَضَةِ وَالِاسْتِنْشَاقِ لِلصَّائِمِ - të shpërlarit tepër gojën dhe hundën gjatë kohës së agjërimit.

²⁹ Pse nuk lejohet shpenzimi i pa nevojshëm i ujit, vërejmë nga kuptimi i përgjithësuar i ajetit: (وَلَا تُسْرِفُوا إِنَّهُ لَا يُحِبُّ الْمُسْرِفِينَ) "...*mos e teproni, se vërtetë Ai nuk i do ata të cilët e teprojnë*". Poashtu si argument mund të përmendim rastin kur një herë Pejgamberi s.a.w.s. kaloi pranë Sa'dit i cili ishte duke marrë abdest dhe në atë rast i tha: (مَا هَذَا السَّرْفُ؟ أَمْ فِي الْوُضُوءِ إِسْرَافٌ؟) قَالَ: نَعَمْ وَإِنْ كُنْتُ عَلَى نَهْرٍ جَارٍ) "Çka është ky shpenzim i tepërt i ujit? Sa'di tha: A, edhe në abdest ka shpenzim të tepërt!? E Pejgamberi s.a.w.s. i tha: "Po, edhe nëse je pranë lumit që rrjedh" . (Ibn Maxhe).

³⁰ Kjo vërtetohet me ixhmain e dijetarëve.

³¹ Për këtë argumenton transmetimi që e bëri Ibn Abbasi r.a. : كَانَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ لَا يَكْبَلُ طَهْرَةَ إِلَى أَحَدٍ *Pejgamberi s.a.w.s. nuk kërkonte prej askujt që t'i ndihmojë në marrjen e abdestit*". (Ibn Maxheh).

8. تَرَكُ سُنَّةَ مَنْ سَنَّ الوُضُوءَ عَامِدًا لِعَيْرِ عُذْرٍ - të lëshuarit e suneteve të abdestit me qëllim, pa arsye.

Çka e prish abdestin

نَوَاقِصُ الوُضُوءِ

Gjërat që e prishin abdestin janë:

1. خُرُوجُ شَيْءٍ مِنْ أَحَدِ السِّيَالَيْنِ. - **të dalët e diçkaj nga organet e turpshme.** F.v., të dalurit e urines, apo nevojës së madhe, gazrat, pa marrë parasysh se është pak apo shumë, me qëllim apo pa qëllim. Po ashtu, çdo gjë që del nga penisi i mashkullit dhe vagina e femrës e prish abdestin, ngase këto organe në vete bartin ndytësira.

2. الغُومُ - **gjumi**³². Gjumi e prish abdestin nëse personi mbështet dhe fle. Po që se ndodhë që dikush, ulur, kotet³³ pa u mbështetur, atëherë nuk e prish abdestin.

3. خُصُولُ مَا يَسْتُرُ الْعَقْلَ وَ يَفْقَدُ التَّمْيِيزَ. - **Kur ndodhë humbja e vetëdijes, çmenduria, alivanosja apo dehja.** Kur personi i cili ka marrë abdest është në njërin prej këtyre gjendjeve, abdesti konsiderohet i prishur.

4. خُرُوجُ الدَّمِ أَوْ الْقَيْحِ أَوْ الصَّدِيدِ مِنَ الْبَدَنِ. - **të dalurit e gjakut, limfës ose qelbit nga trupi i njeriut.**³⁴

³² Argument për këtë është hadithi: (فَمَنْ نَامَ فَلْيَتَوَضَّأْ) "Kush fle, le të marrë abdest". Ahmedi.

³³ Argument për atë se kotja nuk e prish abdestin, është transmetimi i Katades i cili tregon: se as'habët e Pejgamberit s.a.w.s. pritnin namazin e jacisë dhe koteshin, ashtu përgjumshëm ulnin kokën, e pastaj faleshin po me atë abdest.

³⁴ Për këtë Pejgamberi s.a.w.s. ka thënë: يَعَادُ الوُضُوءَ مِنْ سَبْعٍ: مِنْ إِفْطَارِ الْبَوْلِ وَ الدَّمِ السَّائِلِ وَ الْقَيْحِ وَ دَسْعَةِ تَمَأَلِ الْفَمِ وَ نَوْمِ مُضْجَعِ وَ فَيْقَهَةِ الرَّجْلِ فِي الصَّلَاةِ وَ خُرُوجِ الدَّمِ "Për shtatë gjëra përsëritet abdesti: prej pikave të urinës, gjakut që rrjedh, qelbit, vjelljes

5. **الْقَيْءُ - vjellja.** Të vjellurit e ushqimit, lëngjeve, gjakut që del nga barku nëse goja mbushet plot. Po ashtu priset abdesti nëse vjell shumë herë nga pak.

6. **ظُهُورُ الدَّمِ فِي الفَمِ إِذَا غَلَبَ عَلَى البَصَاقِ أَوْ سَاوَاهُ - të paraqiturit e gjakut në gojë kur është më tepër gjak se pështymë apo përgjysmë.** Nëse ndodhë që gjaku të jetë më pak se pështyma nuk e prish abdestin.

7. **المُبَاشَرَةُ الفَاحِشَةُ - prekja e penisit me vaginën drejpërsdrejti me epsh.** Nëse ndodhë që të kihet rroba të veshura apo ndonjë pengesë në mes organeve seksuale të mashkullit dhe të femres abdesti nuk priset.

8. **القَهْقَهَةُ - të qeshurit me zë në namaz.** Të qeshurit me zë në namazin që ka *ruku* dhe *sexhde* e prish abdestin, ndërsa në namazin e xhenazes dhe në sexhden e leximit abdesti nuk priset.

Çka nuk e prish abdestin

أُمُورٌ لَا تَنْقُضُ الوُضُوءَ

Abdestin nuk e prishin:

1. Gjaku i cili duket por nuk rrjedh nga vendi i vet.
2. Të dalurit e ndonjë gazi nga vagina e femrës.
3. Të koturit.
4. Të prekurit e organit gjenital.
5. Të prekurit e femrës.
6. Të dalurit e ndonjë krimbi nga veshi apo varra.

gojëplotë, gjumit i shtrirë, qeshja e burrit më zë në namaz dhe dalja e gjakut". (Bejhekiu).

7. Të rënit e dregzës nga varra, por me kusht që gjaku të mos rrjedhë nga vendi i vet.

Llojet e abdestit

أَنْوَاعُ الْوُضُوءِ

Llojet e abdestit janë:

1. الْوُضُوءُ فَرَضًا - **abdesti farz**. Abdesti *farz* është për të falur namaz, pavarësisht prej asaj se çfarë kategorie është namazi, për *sexhden* e leximit të Kur'ani dhe prekjen e tij.

2. الْوُضُوءُ وَاجِبًا - **abdesti vaxhib**. Abdesti vaxhib është abdesi që merret më qëllim të *tavafit* rreth Qabesë.

3. الْوُضُوءُ مَنْدُوبًا - **abdesti mendub**. Abdesti është *mendub* në disa raste si f.v.:

- a. kur të preken librat e Sheriatit,
- b. marrja e abdestit për çdo kohë të namazit³⁵,
- c. marrja e abdestit pas hidhërimit,
- ç. marrja e abdestit para pastrimit nga papastërtia (*xhenabeti*),
- d. marrja e abdestit pas pastrimit të të vdekurit,
- e. marrja e abdestit gjatë qëndrimit në Arefat, duke e bërë *sa'jin* në mes kodrave Safa dhe Merve,
- ë. marrja e abdestit gjatë vizitës së varrit të Pejgamberit s.a.w.s.
- f. marrja e abdestit kur bihet për të fjetur³⁶

³⁵ Mu për këtë Pejgamberi s.a.w.s. ka thënë: لَوْلَا أَنُ أَشَقَّ عَلَى أُمَّتِي لِأَمْرِهِمْ عِنْدَ كُلِّ صَلَاةٍ بِوُضُوءٍ وَمَعَ كُلِّ وُضُوءٍ بِسِوَاكَ "Sikur të mos ishte stergarkesë për ummetin tim, kisha për t'i urdhëruar që për çdo namaz të marrin abdest dhe për çdo abdest t'i pastronin dhëmbët me misvak". (Ahmedi).

g. marrja e abdestit për të thirrë ezanin,
 k. marrja e abdestit për studimin e shkencave islame,
 veçanërisht gjatë studimit të hadithit të Pejgamberit
 s.a.w.s.

i. abdesti mbi abdest

j. abdesti pas përgojimit, rrenës etj.

Disa rregulla të përgjithshme rreth abdestit

أَحْكَامٌ عَامَّةٌ

1. Ai i cili ka marrë abdest dhe pastaj i pret thonjtë nuk ka nevojë të marrë abdest prapë, dhe poashtu nëse i ka shkurtuar flokët nuk ka nevojë ta ripërsërisë abdestin.

2. Kur ndodhë që lëkura është e varruar duhet të mbështillet me diçka e pastaj ajo pjesë e trupit të lahet apo t'i jepet *mes'h*, mirëpo, pasi është marrë abdest nëse hiqet mbështjellësja e varrës, atëherë nuk nevojitet të lahet ajo pjesë e mbështjellur e as t'i jepet *mes'h*.

3. Kur ndodh që dikush ka marrë abdest, mirëpo pas një kohe dyshon nese ka abdest apo jo, do të veprojë në atë mënyrë që do të mendojë se, a e ka prishur abdestin, e nëse nuk i kujtohet se e ka prishur abdestin, në këtë rast gjykohet se ka abdest. E gjithë kjo bazohet në rregullen e *shariatit*: (الْيَقِينُ لَا يَزُولُ بِالشَّكِّ)

"Bindja nuk eliminohet me dyshim".

4. Po që se ndodhë që personi gjatë marrjes së abdestit ose pasi ta përfundojë, fillon të dyshojë se mos ka harruar të pastrojë ndonjë gjymtyrë, ai duhet të

³⁶ Për këtë Pejgamberi s.a.w.s. ka thënë: إِذَا أَتَيْتَ مَضْجَعَكَ فَتَوَضَّأْ وَضُوءَكَ لِلصَّلَاةِ ثُمَّ اصْطَبِجْ عَلَيَّ شِئْنُكَ الْأَيْمَنِ "Kur të shkosh për të fjetur merr abdest sikur për namaz, e pastaj shtrihu në dyshek kah ana e djathtë". (Buhariu, Tirmidhiu dhe Ahmed).

rikthehet dhe ta pastrojë prapë atë gjymtyrë. Ky veprim vjen në shprehje nëse nuk ndodhë shpesh, e po që se dyshimi i tillë ndodhë si shpesh, atëherë gjykohej se ajo gjymtyrë është pastruar dhe nuk ka nevojë të pastrohet prapë.

GUSLI

الْغُسْلُ

Me fjalën *gusl* në terminologjinë e fikhut nënkuptohet "Përdorimi i ujit për pastrim në tërë trupin në mënyrë të veçantë". Për vlefshmërinë dhe obligueshmërinë e *guslit* kemi argument fjalën e Allahut xh.sh. (وَإِنْ كُنْتُمْ جُنُبًا فَأَطَّهَرُوا) "...dhe nëse jeni *xhunub, pastrohuni...*"³⁷.

Shkaqet që e obligojnë guslin

مُوجِبَاتُ الْغُسْلِ

Shkaqet e tilla janë:

1. **خُرُوجُ الْمَنِيِّ** - ejakulimi i spermës³⁸, pa marrë parasysh se kjo ngjan në gjendje të zgjuar, në ëndërr, apo sperma del jashtë për shkak të shikimit, paramendimit, masturbimit etj. Ejakulimi i spermës

³⁷ El-Maide: 6

³⁸ Argument për këtë është hadithi: (الْمَاءُ مِنَ الْمَاءِ) "Uji nga uji (pastrimi me ujë obligohet me daljen e ujit-spermës". (Ibn Maxheh). Po ashtu si argument mund të përmendim transmetimin e Ummi Selemes r.a. e cila ka treguar se i ka thënë Pejgamberit s.a.w.s.: يَا رَسُولَ اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ لَا يَسْتَجِيبُ مِنَ الْحَقِّ هَلْ مِنَ الْمَرْأَةِ مِنْ غُسْلٍ إِذَا هِيَ احْتَلَمَتْ فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ نَعَمْ إِذَا رَأَتْ الْمَاءَ "O Pejgamber i Zotit, s'ka dyshim se Allahu nuk turpërohet nga e vërteta. A është femra e obliguar të pastrohet, nëse ajo bëhet e papastër? Pejgamberi s.a.w.s. u përgjigj duke thënë: Po, nëse e sheh spermën". (Buhariu dhe Muslimi).

kushtëzohet të jetë me dëfrim. Kur ndodhë që sperma del jashtë për shkak të ngarkesës, rrahjes, etj, atëherë personi i tillë nuk obligohet për pastrim, ngase ejakulimi i spermës është bërë pa dëfrim. Në këtë rregull përfshihen të dy gjinitë, mashkulli dhe femra.

2. **الجماع - marrëdhëniet seksuale.** Marrëdhënie seksuale konsiderohet takimi seksual mes dy gjinive³⁹. Kur ndodhë që koka e penisit të futet në vaginën e femrës, pavarësisht a është ejakuluar apo jo sperma, të dy konsiderohen të papastër dhe obligohen për t'u pastruar.

3. **الحيض - hajzi-menstruacionet.** Femrës pasi t'i kenë kaluar menstruacionet (*hajzi*) është e detyruar që të pastrohet⁴⁰.

4. **النفاس - nifasi.** Pas kryerjes së nifasit femra obligohet të pastrohet ngase duhet t'i kryejë obligimet fetare si, f.v., të falë namazin etj.

5. **الكافر - pabesimtari.** Kur ndodhë që pabesimtari të bëhet musliman dhe para Islamit ka qenë *xhunub*, ai doemos duhet të pastrohet ngase ka obligime për të

³⁹ Këtë e argumenton hadithi: (إِذَا تَقَى الْحَيْضَانِ وَغَابَتِ الْحَشْفَةُ وَجَبَ الْغُسْلُ أَنْزَلَ أَوْ لَمْ يُنْزَلْ) "Kur të bëhet takimi në mes mashkullit dhe femrës dhe zhytet koka e penisit në vaginën e femrës, obligohet pastrimi, pavarësisht se a ka ejakuluar apo jo". (Ibn Maxheh).

⁴⁰ Për këtë kemi argument fjalën e Allahut xh.sh. : وَكَأْتَسْرُبُوهُنَّ حَتَّى يَطْهُرْنَ فَإِذَا تَطَهَّرْنَ...*dhe mos iu afrohuni atyre (për marrëdhënie) derisa të pastrohen, e kur të pastrohen afrohuni atyre ashtu si iu ka urdhëruar juve Allahu...*. El-Bekare: 222. Po ashtu si argument mund të përmendim rastin e një gruaje të quajtur Fatime bint Hubejsi, të cilës i ishte drejtuar Pejgamberi s.a.w.s. duke i thënë: (إِذَا أَقْبَلَتِ الْحَيْضَةَ فَدَعِي الصَّلَاةَ فَإِذَا أَدْبَرْتَ فَأَغْسِلِي وَصَلِّي) "Kur të vijnë menstruacionet ndërpreje namazin, e kur të ndërprehen pastrohu dhe fale namazin". (Buhariu).

zbatuar. Po që se nuk ka qenë *xhunub*, nuk e ka obligim të pastrohet, por, megjithatë më mirë është që të pastrohet.

6. **الْمَيْتُ - i vdekuri.** Kur vdes muslimani është *farz kifaje* që të pastrohet.

Kur shihet se ekzistojnë të gjitha këto shkaqe që u përmendën, atëherë *gusli* është *farz* të zbatohet, d.t.th., doemos duhet të pastrohet.

Shënim: Disa gjëra edhe pse dalin nga trupi i njeriut nuk e shkaktojnë obligueshmërinë e *guslit*, d.t.th., nuk ka nevojë për t'u pastruar. Si gjëra të tilla mund të përmendim:

a. Dalja e një lëngut të bardhë dhe të hollë (sekrecion) nga organi gjenital për shkak të zgjuarjes së epshit. Ky lloj i lëngu në shkencën e *fikhut* njihet me emrin (الْمَذِيّ), dalja e këtij lëngu e prish abdestin, por nuk e obligon *guslin*.

b. Dalja e një lëngu të bardhë dhe të trashë nga organi gjenital pas urinimit, por nganjëherë ka mundësi të dalë edhe para urinimit. Në të shumtën e rasteve lëngu i tillë del për shkak të bartjes së ndonjë barre të rëndë. Ky lloj lëngu në shkencën e *fikhut* njihet si (الْوَدِيّ). Dalja e këtij lëngu e prish abdestin, por nuk e obligon *guslin*.

Gusli sunnet

الْأَغْسَالُ الْمَسْنُونَةُ

Gusli sunnet është në këto raste:

1. **غَسْلُ الْجُمُعَةِ** **pastrimi në ditën e xhuma.**⁴¹ *Sunnet* është pastrimi në ditën e xhuma vetëm për ata të cilët shkojnë në xhami për ta falur xhumanë. Pastrimi i tillë duhet të bëhet para se të shkohet në xhami.
2. **غَسْلُ الْعِيدَيْنِ** **pastrimi në dy bajramet.**⁴² Pastrimi në këto ditë është sunnet për burra, gra e fëmijë.
3. **غَسْلُ الْإِحْرَامِ لِلْحَجِّ أَوْ لِلْعُمْرَةِ** **të pastruarit për të veshur ihramin për haxh apo për umre.**
4. **غَسْلُ يَوْمِ عَرَفَةَ لِلْحَجِّ لِعِيَرِهِ** **të pastruarit ditën e Arefatit për haxhiun e jo për tjerët.**

Gusli mendub

الْأَغْسَالُ الْمُنْدُوبَةُ

Gusli *mendub* është në këto raste:

1. Personi i cili e pranon Islamin edhe nëse është i pastër, rekomandohet të pastrohet.
2. Me rastin e faljes së namazit për shkak të zënies së diellit dhe hënës.
3. Me rastin e hyrjes në Mekke për të bërë *tavafin*, të qëndruarit në Muzdelife, të hyrit në Mina ditën e parë të bajramit dhe për gjuajtjen e guralecave.
4. Me rastin e hyrjes në Medinë dhe në xhaminë e Pejgamberit s.a.w.s.

⁴¹ Këtë e argumenton hadithi i Pejgamberit s.a.w.s.: (مَنْ جَاءَ مِنْكُمْ الْجُمُعَةَ فَلْيَغْتَسِلْ) "Kush vjen prej jush në xhuma, le të pastrohet". (Buhariu, Muslimi dhe të tjerët).

⁴² Transmetohet se Pejgamberi s.a.w.s. është pastruar ditën e xhuma, ditën e Arefatit, ditën e fitër bajramit dhe në ditën e kurban bajramit. كَانَ يَغْتَسِلُ يَوْمَ الْجُمُعَةِ وَ يَوْمِ عَرَفَةَ وَ يَوْمَ الْفِطْرِ وَ يَوْمَ النَّحْرِ (Transmeton Ibn Ahmedi në "Zevaidil Musned").

5. Pas shërimit nga çmenduria, alivanosja dhe pas kalimit të dehjes së atij që ka pirë alkool.
6. Kur të hyhet në moshën madhore, qoftë mashkulli apo femra.
7. Ai i cili e pastron xhenazen.
8. Pastruesi i xhenazes pasi ta ketë pastruar xhenazen.

Farzet e guslit

فَرَائِضُ الْغُسْلِ

Farzet e guslit janë:

1. **الْمَضْمَضَةُ وَالِاسْتِشْقَاقُ مَرَّةً** - **pastrimi i gojës dhe hundës një herë.**⁴³
2. **تَغْمِيمُ الْبَدَنِ بِالْمَاءِ الطَّهْوَرِ مَرَّةً** - **pastrimi i tërë trupit një herë me ujë të pastër.** Kur të bëhet pastrimi i trupit duhet që të mos mbetet ndonjë pjesë e trupit pa u larë, duhet që vendet gjenitale të pastrohen mirë, të pastrohet brendësia e kërthizës, nëse mashkulli ka flokë të gjata dhe i ka bërë gërshetë duhet t'i shprishë dhe t'i pastrojë. Femrat të cilat i kanë flokët e gjata dhe nëse uji ka mundësi për të depërtuar deri në rrënjët e flokëve pa i shprishur gërshetet, lejohet të lahen pa u shprishur.

Sunnetet e guslit

سُنُنُ الْغُسْلِ

Sunnetet e guslit janë:

1. **Të bërit nijjet me zemër.**
2. **të fillohet pastrimi me *bismilah*,**

⁴³ Si argument për këtë hanefinjte e marrin ajetin: (وَإِنْ كُنْتُمْ جُنُبًا فَاطَّهَّرُوا) "...*dhe nëse jeni të papastër, pastrohuni...*".

3. pastrimi i duarve deri në nyje,
4. evitimi i ndytësirës nga trupi,
5. të pastruarit e organeve gjenitale, posaçërisht femra duhet të e pastrojë vaginën brenda,
6. të merret abdest para se të fillohet larja, mirëpo këmbët duhet të lahen pasi të përfundojë larja,
7. tri herë të derdhet uji mbi trup,
8. të fillohet derdhja e ujit prej kokës e pastaj të lahet supi i djathtë e pastaj i majti,
9. të pastruarit e pjesëve të trupit një nga një.

Adabet e guslit

آدابُ الْغُسْلِ

Adabet e guslit janë të njëjta sikur të abdestit, me përjashtim të drejtimit nga kibla, lutjeve dhe të përmendurit të Allahut, ngase gjatë pastrimit njeriu është i zdashur. Rekomandohet pastrimi me ndonjë vend ku njeriu nuk shihet dhe poashtu rekomandohet falja e dy rekatëve namaz pas pastrimit.

Mekruhet e guslit

مَكْرُوهَاتُ الْغُسْلِ

Mekruhet e guslit janë të njëjta me ato të abdestit, me përjashtim të asaj se të bërit dua gjatë pastrimit është *mekruh*, ndërsa te abdesti nuk është *mekruh*.

Çka ndalohet për të papastërin

مَا يُحْرَمُ عَلَى الْجَنَّبِ

Kur personi është i papastër i ndalohen këto gjëra:

1. الصَّلَاةُ -namazi⁴⁴.
2. مَسُّ الْقُرْآنِ -prekja e Kur'anit.⁴⁵
3. قِرَاءَةُ الْقُرْآنِ -leximi i Kur'anit.⁴⁶
4. الطَّوْفُ حَوْلَ الْكَعْبَةِ -tavafi rreth Qabes.
5. الدُّخُولُ فِي الْمَسْجِدِ -të hyrit në xhami.⁴⁷

T E J E M - M U M I

التَّيْمُمُ

Fjala "tejemmum" në kuptimin etimologjik d.t.th. qëllim, ndërsa në kuptimin terminologjik me *tejemmum* nënkuptohet "***Të fërkuarit e fytyrës dhe duarve me dhe të pastër kur nuk ekziston uji***".

Vlefshmëria e tejemmumit vërehet qartë nga ajeti kur'anor: (وَإِنْ كُنْتُمْ مَرْضَىٰ أَوْ عَلَىٰ سَفَرٍ أَوْ جَاءَ أَحَدٌ مِنْكُمْ مِنَ الْغَائِطِ أَوْ لَامَسْتُمُ النِّسَاءَ فَلَمْ تَجِدُوا مَاءً فَتَيَمَّمُوا صَعِيدًا طَيِّبًا فَامْسَحُوا بِوُجُوهِكُمْ وَأَيْدِيكُمْ مِنْهُ)

"... dhe nëse jeni të sëmurë ose në udhëtim, ose i ka ardhur dikujt që ta kryejë nevojën, ose keni bërë

⁴⁴ Si argument se njeriu kur është i papastër nuk ka të drejtë të falet kemi fjalën e Allahut xh.sh. : (وَإِنْ كُنْتُمْ جُنُبًا فَاطَّهَّرُوا) "***...dhe nëse jeni të papastër, pastrohuni...***".

⁴⁵ Argument për këtë është ajeti: (لَا يَمَسُّهُ إِلَّا الْمُطَهَّرُونَ) "***Atë nuk e prekin vetëm të pastërtit***". (El Vakia: 79). Poashtu si argument është edhe hadithi : لَا يَمَسُّ الْقُرْآنَ إِلَّا : "Nuk lejohet ta prekë Kur'anin, vetëm se i pastërti". (Maliku dhe DareKutni).

⁴⁶ Argument për këtë është hadithi: (لَا يَقْرَأُ الْجُنُبُ وَلَا الْحَائِضُ شَيْئًا مِنَ الْقُرْآنِ) "***Nuk i lejohet të lexojë atij që është xhunub dhe femres me menstruacione asgjë nga Kur'ani***". (Tirmidhiu dhe Ebu Davudi).

⁴⁷ Këtë e argumenton hadithi i Pejgamberit s.a.w.s.: (إِنَّ الْمَسْجِدَ لَا يَحِلُّ لِحَيْبٍ وَلَا لِحَائِضٍ) "***Në të vertetë nuk lejohet të hyjë në xhami i papastri dhe femra me menstruacione***". (Ibn Maxhe).

marrëdhënie seksuale me gratë, dhe nuk gjeni ujë, merreni tejemmum me dhe të pastër duke i fërkuar fytyrat tuaja dhe duart tuaja...".

Tejemmumi zëvendëson ujin kur ai mungon, por edhe në momente specifike kur ka ujë, por s'mund të përdoret për shkak të ndonjë rasti aksidental, i cili pamundëson përdorimin e ujit. *Tejemmumi* përveç asaj që vlen si zëvendësim për abdestin, ai mund të zëvendësojë edhe pastrimin nga *xhenabeti*-papastërtia. *Tejemmumi* nuk është i vlefshëm për të mënjanuar papastërtinë, ngase *tejemmumi* është lehtësim e nuk është pastrues i ndytësirës.

Shkaqet për të marrë tejemmum

Shkaqet të cilat e arsytojnë marrjen e tejemmumit janë:

1. Kur nuk gjendet uji, apo uji është larg afërisht 1848 m. apo një milë.
2. Kur uji është afër por ekziston frika nga ndonjë egërsirë, hajn, kriminel etj.
3. Kur uji është afër por nuk ka mjet me çka të nxirret uji.
4. Kur ujë ka, por ai është i pakët vetëm sa për nevojat e domosdoshme si, f.v., për të pirë, përgatitur ushqimin etj.
5. Kur uji është i pakët dhe nuk mjafton sa për të marrë abdest apo edhe për t'u pastruar.
6. Kur *musaliu* është i sëmurë dhe uji e dëmton atë nëse e përdorë për abdest apo për pastrim.
7. Kur është acar i madh dhe është frika se nëse përdoret uji do të dëmtojë shëndetin.

8. Kur njeriu është i sëmurë dhe nuk ka mundësi të marrë vetë abdest dhe askush nuk është afër që t'i ndihmojë të marrë abdest.

9. Kur shihet se namazi i xhenazes dhe i bajramit do të mbarojë nëse do të marrim abdest.

Ruknet e tejemmunit

أَرْكَانُ التَّيْمُمِ

Tejemmumi i ka dy *rukne*:

1. مَسْحُ الْوَجْهِ كُلِّهِ مَرَّةً وَاحِدَةً - të fërkuarit e fytyrës një herë,
2. مَسْحُ الْيَدَيْنِ إِلَى الْمِرْفَقَيْنِ - të fërkuarit e duarve deri në bërryla.⁴⁸

Kushtet e tejemmunit

شُرُوطُ التَّيْمُمِ

Kushtet e *tejemmunit* janë:

1. Të ekzistojë arsyeja e justifikueshme për të marrë *tejemmum*,
2. Të bëhet nijjet me zemër dhe të përcaktohet para se të merret *tejemmum* se për çka është duke marrë *tejemmum* si, f.v., të bëjë *nijjet* se nëse merr *tejemmum* për namaz, leximin e Kur'anit, apo për pastrim nga *xhenabeti* etj.
3. *Tejemmumi* të merret me diçka që është e pastër nga elementet e tokës si psh. dheu, rëra, guri etj.
4. Të bëhen dy prekje në tokë edhe atë me shuplaka të hapura.

⁴⁸ Këtë e argumenton fjala e Allahut xh.sh. : (فَامْسَحُوا بِوُجُوهِكُمْ وَأَيْدِيكُمْ مِنْهُ) "...*fërkon* fytyrat tuaja dhe duart tuaja...".

5. Ti jepet *mes'h* fytyrës dhe duarve me tërë shuplakën e dorës, sepse nëse jepet vetëm më gishtrinjt nuk lejohet.

6. Mënjanimi i sendeve që pengojnë *mes'hin* siç është qiriu, yndyra etj.

Sunnetet e tejemmumit

سُنُنُ التَّيْمُمِ

Sunnetet e *tejemmumit* janë:

1. التَّسْمِيَةُ - shqiptimi i *besmeles*,
2. التَّرْتِيبُ - marrja e tejemumit me rend, ashtu siç kishte marrë Pejgamberi s.a.w.s.
3. الْمَوْالَاةُ - pandërprershmëria në marrjen e tejemmumit .
4. تَقْدِيمُ الْيَدِ الْيُمْنَى فِي الْمَسْحِ عَلَى الْيَدِ الْيُسْرَى - që më se pari të fshihet dora e djathtë e pastaj e majta.
5. أَقْبَالُ الْيَدَيْنِ وَادْبَارُهُمَا - rrëshqitja e duarve para dhe prapa pasi të vendosen në dhe.
6. تَفْرِيجُ الْأَصَابِعِ - hapja e gishtave në atë mënyrë që dheu- pluhuri të depërtojë në mes tyre.
7. نَقْضُ الْيَدَيْنِ - shkundja e duarve pas ngritjes nga dheu.
8. تَأْخِيرُ التَّيْمُمِ لِمَنْ يَرْجُو إِدْرَاكَ الْمَاءِ بِغَلْبَةِ الظَّنِّ قَبْلَ خُرُوجِ الْوَقْتِ - të vonuarit e marrjes së tejemmumit duke shpresuar se uji do të vijë para se të kalojë koha e namazit.
9. اسْتِقْبَالُ الْقِبْلَةِ - të kthyerit nga kibla duke marrë *tejemmum*.

Mënyra e të marrurit tejemmum

كَيْفِيَّةُ التَّيْمُمِ

Pasi të bëhet *nijjeti* dhe të thuhet *basmelja*, lëshohen duart në dhe të pastër ose gur, i rrëshqasim para dhe mbrapa, i shkundim dhe me këto duar fërkojmë fytyrën. Përsëri i vendosim duart në atë dhe apo gur, e pastaj i rrëshqasim para dhe prapa, dhe me dorën e majtë e fshijmë krahun e djathtë e mandej me dorën e djathtë e fshijmë krahun e majtë.

Disa rregulla që kanë të bëjnë me tejemmumin

أَحْكَامُ التَّيْمُمِ

1. Preferohet që *musaliu* ta vonojë marrjen e *tejemmumit* deri në kohën e fundit të namazit nëse shpreson se do t'i arrijë uji.

2. *Tejemmumi* e zëvendëson abdestin dhe *guslin* dhe se po që se është dikush *xhunub*, në të njëjtën kohë e largon papastërtinë dhe mund të falë namaz.

3. Çka e prish abdestin e prishë edhe *tejemmumin*, me përjashtim të asaj që *tejemumin* e prishë ardhja e ujit dhe evitimi i shkaqeve që e kanë shkaktuar marrjen e *tejemmumit*.

4. Kush ka marrë *tejemmum* dhe është falur, e pastaj, i ka ardhur uji, nuk ka nevojë ta përsërisë namazin edhe po që se ka kohë për ta falur.

5. Ai i cili i ka duart dhe këmbët e këputura dhe në të njëjtën kohë nuk ka kush t'i japë *tejemmum*, atëherë, personi i tillë nëse gjendet afër murit dhe ka mundësi që vetëm me njëren anë të fytyrës të marrë *tejemmum*, mund ta falë namazin. E po që se në fytyrën e tij ekziston ndonjë plagë dhe nuk ekziston mundësia e marrjes së *tejemmumit*, atëherë e falë namazin pa

pastrim dhe pa *tejemmum* dhe këtë namaz s'ka nevojë ta bëjë *kaza*.

MES 'HI MBI MESTE

الْمَسْحُ عَلَى الْخُفَيْنِ

Meste në shkencën e fikhut konsiderohet ajo mbathje e cila e mbulon këmbën deri në zogun e saj. Për vlefshmërinë dhe argumentimin e *mes'hit* mbi meste kemi argumente të qarta sepse transmetohet nga Mugire ibn Shu'beta r.a. të ketë thënë:

كُنْتُ مَعَ النَّبِيِّ صَلَّى

اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فِي سَفَرٍ فَأَهْوَيْتُ لِأَنْزِعَ خُفَّيْهِ فَقَالَ دَعُهُمَا فَإِنِّي أَدْخَلْتُهُمَا طَاهِرَتَيْنِ (فَمَسَحَ عَلَيْهِمَا) "*Kam qenë me Pejgamberin s.a.w.s. në udhëtim dhe, kur mori abdest, dëshirova t'ia zbathi mestet, dhe ndërkohë më tha: "Lëri ato se unë i kam veshur të pastëra, dhe vetëm iu dha mes'h".*"⁴⁹

Mes'hi mbi meste vlen për meshkujt dhe për femrat.

Kushtet e mes'hit mbi meste

شُرُوطُ الْمَسْحِ عَلَى الْخُفَيْنِ

Kushtet e tilla janë:

1. Mestet të mbathen pas pastrimit të këmbëve,
2. ta mbulojnë zogun e këmbëve,
3. të jetë e mundur ecja me to,
4. që të mos jetë e grisur më shumë se tre gishta të vegjël të këmbës,
5. të rrinë vetë në këmbë pa i shtrënguar me asgjë,
6. që të mos e lëshojnë ujin.

Kohëzgjatja e mes'hit mbi meste

⁴⁹ Buhariu

مُدَّةُ الْمَسْحِ

Mes'hi për atë që është vendas zgjatë 24 orë, ndërsa për atë që është në udhëtim zgjatë tri ditë e tri netë. Këtë e argumenton trasnsmetimi i Aliut r.a. i cili thotë: "Pejgamberi s.a.w.s. ka caktuar që koha e mesteve për udhëtarin të jetë tri ditë e tri netë, ndërsa për vendasin një ditë e një natë".⁵⁰

Koha e *mes'hit* fillon nga momenti kur personi i cili ka pasur abdest dhe, pasi e ka prishur atë, merr abdest përsëri dhe u jep *mes'h* mesteve. Pra, nga momenti kur u ka dhënë *mes'h* fillon koha e mesteve. Si psh. nëse *musaliu* ka marrë abdest para se të falë sabahun dhe i ka mbathur mestet, pasi ka lind dielli e ka prishur abdestin e pastaj ka marrë abdest dhe iu ka dhënë *mes'h* mesteve, prej këtij momenti fillon *mes'hi* mbi meste, d.t.th. prej momentit kur u jepet *mes'h*, e jo prej kohës kur mbathen.

Mënyra e mes'hit

كَيْفِيَّةُ الْمَسْحِ

Mes'hi mbi meste merret në këtë mënyrë: me gishtat e lagur të dorës së djathtë fërkohet mestja e djathtë prej gishtave deri te nyjat e këmbës, po kështu veprohet edhe me këmbën e majtë.

Çka e prish mes'hin mbi meste

نَوَاقِضُ الْمَسْحِ عَلَى الْخُفَيْنِ

Mes'hin mbi meste e prish:

1. Çdo gjë që e prish abdestin e prish edhe *mes'hin* mbi meste,
2. z bathja e mesteve apo e njëres prej tyre,

⁵⁰ Transmeton Muslimi.

3. kur depërton uji dhe lagët këmba më shumë se gjysma, dhe,

4. kalimi i afatit të paraparë sipas rregullave të Sheriatit.

Mes'hi mbi çorap

الْمَسْحُ عَلَى الْجُورِبَيْنِ

Të dhënit *mes'h* çorapeve është i vlefshëm, duke argumentuar me transmetimin që e bën Mugire bin Shu'betë, se: (أَنَّهُ تَوَضَّأَ وَ مَسَحَ عَلَى الْجُورِبَيْنِ) "*Vërtetë ai (Pejgamberi s.a.w.s.) merrte abdest dhe u jepte mes'h çorapeve*".

Kushtëzohet që për të qenë i vlefshëm *mes'hi* mbi çorapë, ato duhet të jenë të trasha dhe që uji nuk mund të depërtojë në to. Të gjitha rregullat që vlejné për mestet vlejné edhe për çorapet.⁵¹

Mes'hi mbi plagë dhe mbi fashë

الْمَسْحُ عَلَى الْجُرُوحِ وَ الْجَبَائِرِ

Kur ndodhë që në trup gjendet ndonjë varrë apo plagë dhe duhet të marrë abdest apo të pastrohet nga *xhenabeti*, i tilli duhet të veprojë kështu:

- po që se ndodhë që uji nuk e dëmton varrën duhet të pastrohet,

- nëse ndodhë që varra dëmtohet nga përdorimi i ujit, duhet vetëm të fërkohet varra, kurse rreth saj të pastrohet pjesa e trupit,

⁵¹ Sa u përketë çorapeve të holla në të cilat uji depërton lehtë *mes'hi* mbi to nuk është i vlefshëm.

- po që se edhe *mes'hi* e dëmton varrën, atëherë, duhet lënë krejt, as nuk duhet pastruar, as nuk duhet dhënë *mes'h*,

Nëse ndodhë që varra apo plaga të mbështillet me fashë, atëherë sa herë të merret abdest duhet dhënë *mes'h* fashës.

MENSTRUACIONET-HAJZI

الْحَيْضُ

Me shprehjen *الْحَيْضُ* në kuptimin etimologjik nënkuptojmë të rrjedhurit, ndërsa në terminologjinë e *fikhut*, me këtë shprehje nënkuptohet cikli mujor i menstruacioneve tek femrat.

Koha minimale e ciklit të menstruacioneve është tri ditë, ndërsa koha maksimale e tyre është dhjetë ditë. Këtë e argumenton fjala e Pejgamberit s.a.w.s.: (أَقْلُ) (الْحَيْضُ ثَلَاثَةُ أَيَّامٍ بِلَيْالِيهِنَّ وَ أَكْثَرُهُ عَشْرَةُ أَيَّامٍ) " *Më së paku menstruacionet zgjasin tri ditë e tri netë, e më së shumti dhjetë ditë*".⁵²

Të gjitha llojet e gjakut, pa marrë parasysh ngjyrën e tyre, gjatë kohës së menstruacioneve, konsiderohen *hajz*. Po ashtu edhe gjaku i cili ka ngjyrë dheu, konsiderohet *hajz*.

⁵² Transmeton Dare Kutnijju

NIFASI –gjakderdhja pas lindjes

النِّفَاسُ

Shprehja النِّفَاسُ në kuptimin etimologjik d.t.th. lindje, ndërsa në kuptimin terminologjik gjakderdhje nga mitra e femrës pas lindjes.

Koha më e gjatë e *nifasit* është katërdhjetë ditë, me përjashtim nëse femra vëren ndërprerjen e gjakut para kësaj kohe.

Çka ndalohet gjatë kohës së hajzit dhe nifasit

مَا يُحْرَمُ بِالْحَيْضِ وَ النِّفَاسِ

Të gjithë dijetarët janë unanimesë se të gjitha ato që ndalohen gjatë kohës së *hajzit* poashtu ndalohen edhe gjatë kohës së *nifasit*. Gjërat e ndaluara janë:

1. **الصَّلَاةُ - të falurit e namazit.** Femra gjatë *hajzit* dhe *nifasit* nuk mund të falë asnjë lloj të namazit, pavarësisht nga kategoria e namazit; *farz*, *vaxhib*, *nafile*, *sunnet* dhe as nuk mund të kryejë *sexhden* e leximit. Këtë e argumenton hadithi i Pejgamberit s.a.w.s. i transmetuar nga Aishja r.a. ku i thotë Fatimes-bijës së Ebu Hubejshit: (**فَإِذَا أَقْبَلَتِ الْحَيْضَةَ فَاتْرُكِي الصَّلَاةَ**) "*Kur të vijnë menstruacionet, lëre namazin...*"⁵³. Femra, namazin e mbetur për shkak të *hajzit* dhe *nifasit* nuk duhet ta bëjë *kaza*.

2. **الصَّوْمُ -agjërimi.** Femra kur është me *hajz* dhe *nifas* nuk i lejohet të agjërojë, por, ditët e paagjeruara duhet t'i bëjë *kaza*. Këtë e argumenton transmetimi i Aishes r.a. e cila thotë:

⁵³ Buhariu dhe Muslimi

(كَانَ يُصِيئًا ذَلِكَ فَنُؤْمِرُ بِقِضَاءِ الصَّوْمِ وَلَا نُؤْمِرُ بِقِضَاءِ الصَّلَاةِ) "Ne ishim me hajz dhe urdhëroheshim për ta bërë kaza agjërimin, ndërsa nuk urdhëroheshim ta bënim kaza namazin".⁵⁴

3. **قِرَاءَةُ الْقُرْآنِ - leximi i Kur'anit.** Kur ndodhë që femra është me hajz dhe nifas nuk i lejohet të lexojë Kur'an. Këtë e vërteton hadithi i trasmentuar nga Ibn Umeri r.a., ku Pejgamberi s.a.w.s. ka thënë: (لَا تَقْرَأُ الْحَائِضُ) "Nuk lexon asgjë nga Kur'ani femra me menstruacione dhe i papastërti".⁵⁵

4. **مَسُّ الْمُصْحَفِ – të prekurit e mus'hafit.** Prekja e mus'hafit për femrën e cila është me hajz dhe nifas është e ndaluar rreptësisht sikur që është e ndaluar për personin që është i papastër.

5. **الْجِمَاعُ - marrëdhëniet intime seksuale.** Gjatë periudhës kur femra është me hajz dhe nifas nuk lejohet të kihet marrëdhënie intime seksuale. Mu për këtë Allahu xh.sh. thotë: (وَلَا تَقْرُبُوهُنَّ حَتَّى يَطْهُرْنَ) "...dhe mos u afrohuni atyre (për marrdhënie seksuale) derisa të pastrohen..."⁵⁶.

6. **الِاسْتِمْتَاعُ بِمَا تَحْتَ الْإِزَارِ فِيمَا بَيْنَ السُّرَّةِ وَالرُّكْبَةِ - dëfrimi nën kërthizë.** Kur femra është me hajz apo nifas, i lejohet mashkullit të dëfrehet me të deri në kërthizën e saj, kurse nën të, ndalohet. Këtë e argumenton rasti i një sahabiu i cili kishte pyetur Pejgamberin s.a.w.s. :

⁵⁴ Buhariu dhe Muslimi

⁵⁵ Tirmidhiu dhe Ebu Davudi

⁵⁶ El-Bekare : 222

(مَا يَحِلُّ لِي مِنْ امْرَأَتِي وَهِيَ حَائِضٌ قَالَ لَكَ مَا فَوْقَ الْإِزَارِ) "Çka më lejohet mua kur gruaja ime është me menstruacione? Pejgamberi s.a.w.s. iu pergjijgj: "Të lejohet dëfrimi në pjesë të saj mbi kërthizë".⁵⁷

7. الطَّوَّافُ بِالْكَعْبَةِ – **tavafi rreth Qabesë**. Nuk lejohet *tavafi* rreth Qabes kur femra është me menstruacione dhe në kohën pas lindjes. Këtë e argumenton hadithi të cilin e transmeton Aishja r.a. të cilës i kishin ardhur menstruacionet në kohën e haxhit, e Pejgamberi s.a.w.s. i kishte thënë: (إِفْعَلِي مَا يَفْعَلُ الْحَاجُّ غَيْرَ أَنْ لَا تَطُوفِي بِالْبَيْتِ) (حَتَّى تَطْهُرِي) "Vepru ashtu siç vepron haxhiu, me përjashtim të tavafit rreth Qabesë, derisa të pastrohesh."⁵⁸

8. دُخُولُ الْمَسْجِدِ - **të hyrët në xhami**. Femrës kur është me *hajz* dhe *nifas* nuk i lejohet të hyjë në xhami, përveç në raste të jashtëzakonshme kur doemos duhet të hyjë në të. Për këtë kemi si argument hadithin e Pejgamberit s.a.w.s. : (لَا أُحِلُّ الْمَسْجِدَ لِحَائِضٍ وَلَا جُنُبٍ) "Nuk lejohet që në xhami të hyjë femra me hajz dhe i papastri".⁵⁹

ISTIHADA

الِاسْتِحَاظَةُ

Me shprehjen *الِاسْتِحَاظَةُ* në terminologjinë e fikhut nënkuptohet : *gjakderdhja nga mitra e femrës jashtë afatit të hajzit dhe nifasit*. Prandaj çdo gjakderdhje që

⁵⁷ Ebu Davudi

⁵⁸ Buhariu

⁵⁹ Ebu Davudi

është më tepër se koha e *hajzit* apo më pak, apo paraqitet gjakderdhja para kohës së pubertetit konsiderohet *istihada*.

Istihada mund të jetë e përhershme dhe e përkohshme. Femra kur është me *istihada* duhet të marrë abdest për çdo kohë të namazit dhe mund të falë me një abdest sa të dojë nga namazet brenda kohës së një namazi, si psh. nëse ka marrë abdest për drekë dhe e ka falur drekën, e tilla, derisa të vijë koha e namazit të ikindisë ka mundësi që me të njëjtin abdest të falë namaze nafîle, kaza etj.

N A M A Z I

الصلاة

Shprehja الصلاة në kuptimi gjuhësor d.t.th. lutje. Allahu xh.sh. në Kur'an i thotë Pejgamberit s.a.w.s.: {وَصَلِّ عَلَيْهِمْ إِنَّ صَلَاتَكَ سَكَنٌ لَهُمْ} “*Lutu për ata se vërtetë lutja jote është qetësim për ta*”. Ndërsa الصلاة në terminologjinë e *fikhut* është: (Ibadet i veçantë i cili përbëhet prej fjalëve dhe veprave të posaçme, fillon me tekbir dhe mbaron me selam).

Namazi është shtyllë parësore e fesë islame, po ashtu ky ibadet ka qënë te të gjitha *Sheriatet* e Allahut xh.sh. që kanë qënë më herët, pavarësisht se metoda e të zbatuarit ka ndryshuar prej një *Sheriati* nga tjetri. Ky *ibadet* duhet doemos të zbatohet dhe kurrësesi nuk lejohet të mos zbatohet duke u munduar për të gjetur ndonjë arsye të pajustificueshme. Për shkak të rendësisë së madhe që ka ky *ibadet*, në Kur'an është përmendur më shumë se njëqind herë dhe për këtë çështje flasin shumë *hadithe*.

كوش është i obliguar me namaz على من تجب الصلاة

Namazi është *farzi ajn* për atë që është :

1. Musliman (المسلم). Musliman konsiderohet çdo person i cili e shpreh shehadetin dhe i beson asaj që i është zbritur Muhammedit s.a.w.s.
2. I mençur (العاقل). I mençur është ai njeri i cili ka aftësi të bëjë dallimin në mes të mirës dhe të keqës.

3. Madhor (البالغ). Mashkulli konsiderohet se ka hyrë në moshën madhore kur fillon t'i paraqitet polucioni, ndërsa femra nga koha kur fillojnë t'i paraqiten menstruacionet.

Shënim:

Fëmija i cili është në moshën shtatëvjeçe nëse e falë namazin, i tilli ka shpërblimin e Allahut xh.sh. edhe pse ende nuk ka hyrë në moshën madhore. Por, prindërit e kanë për obligim që fëmijën në këtë moshë ta nxisin për të falë namazin, që fëmija të jetë në gjendje ta kryejë më lehtë këtë obligim kur të vijë koha që ai të jetë i obliguar me *ibadetin* e tillë. Mu për këtë Pejgamberi s.a.w.s. ka thënë:

(مُرُوا أَوْلَادَكُمْ بِالصَّلَاةِ وَهُمْ أَبْنَاءُ سَبْعٍ وَاصِرُتُوهُمْ عَلَيْهَا وَهُمْ أَبْنَاءُ عَشْرِ)
 “Urdhëroni fëmijët tuaj me namaz qysh kur ata janë shtatëvjeç, e rrahni në moshën dhjetëvjeç (nëse ata nuk falen)”.

Norma e namazit

حكم الصلاة

1. Ai cili e fal namazin e ka shpërblimin e Allahut xh.sh., shpërblimin më madhështor.

2. Ai i cili e le pa e falur namazin ndëshkohet në botën tjetër. Ndërsa sa i përket dënimit në këtë botë, sipas *medh'hebit* hanefij, i tilli duhet të burgoset derisa të pendohet dhe të falet, e nëse nuk pendohet duhet të qëndrojë i burgosur deri në vdekje.

Kohët e namazit

أوقات الصلاة

Allahu xh.sh. ka thënë:

(إِنَّ الصَّلَاةَ كَانَتْ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ كِتَابًا مَوْقُوتًا)

“Vërtetë namazi për besimtarët është me kohë të caktuar”.

Pesë kohët e namazeve *farze* janë :

1. Namazi i sabahut (صلاة الفجر)
2. Namazi i drekës (صلاة الظهر).
3. Namazi i ikindisë (صلاة العصر).
4. Namazi i akshamit (صلاة المغرب).
5. Namazi i jacisë (صلاة العشاء).

Pesë kohët e namazit janë përcaktuar sipas asaj që Xhibrili a.s. e ka mësuar Pejgamberin s.a.w.s. Transmetohet nga Ibn Abbasi r.a. dhe Xhabiri r.a. se Xhibrili a.s. i është bërë imam Pejgamberit s.a.w.s. dy ditë resht, një ditë ia ka falur namazet në fillim të hyrjes së kohës, ndërsa në ditën tjetër ia ka falur para mbarimit të kohës së namazit.

Koha e namazit të sabahut fillon qysh prej agimit e deri pak para sa të lind dielli.

Koha e namazit të drekës fillon që nga koha kur dielli largohet nga kupa e qiellit dhe vazhdon deri sa hija e njeriut zgjatet sa dy herë trupi i njeriut.

Koha e namazit të ikindisë fillon prej atij momenti kur hija e njeriut është e zgjatur sa dy herë trupi i njeriut dhe zgjatë deri sa të përendojë dielli.

Koha e namazit të akshamit fillon që nga perëndimi i diellit e derisa të largohet kuqërimi i horizontit.

Koha e namazit të jacticë fillon që prej momentit kur largohet kuqërimi i horizontit deri në agimin e parë.

Kohët kur është mekruh për t'u falur

أوقات تكره فيها الصلاة

Të falurit e namazit në disa kohë është *mekruhi tahrimen* dhe nuk lejohet kurrësesi të falet as një lloj namazi, ndërsa, në disa kohë, është *mekruhi tenzihen* të falen namaze *nafile*, ndërsa namazet *farze* dhe *vaxhibe* lejohet të falen.

Mekruhi tahrimen është të falet në këto kohë:

1. Duke lindur dielli.
2. Kur dielli është në zenit të qiellit.
3. Duke përenduar dielli.

Në këto kohë nuk lejohet të falet as një lloj i namazit dhe se namazi i falur në këto kohë nuk pranohet. Po që se ndodhë që duke u falur hyn njëra prej këtyre kohëve, namazi duhet të ndërprehet dhe të përsëritet.

Mekruhi tenzihen të falen namaze *nafile* është në këto kohë:

1. Pasi të ketë hyrë koha e agimit nuk lejohet të falet *nafile* përveç dy *rekateve sunnet* të sabahut.
2. Pasi të falë *musaliu farzin* e ikindisë.
3. Para se të falet *farzi* i akshamit.
4. Kur imami ka hypur në *minber*.
5. Kur është duke u bërë *ikamet*.
6. Të falurit namaze *nafile* para se të falet dhe pasi të falet namazi i bajramit.

EZANI DHE IKAMETI

الأذان و الإقامة

Ezani dhe ikameti janë sunneti muekkede vetëm për meshkujt. *Ikameti* duhet të bëhet para se të falet *farzi*, një gjë të tillë duhet ta bëjnë vetëm meshkujt.

Të lajmëruarit për namaze të tjera si, f.v., namaz të *xhenazes*; namaz për të ra shi; namaz të bajramit etj., nuk bëhet me *ezan* por bëhet me shprehjen (الصلاة جامعة).

Forma e ezanit dhe e ikametit:

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ
اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ
أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ
أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ
أَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ
أَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ
حَيَّ عَلَى الصَّلَاةِ
حَيَّ عَلَى الصَّلَاةِ
حَيَّ عَلَى الْفَلَاحِ
حَيَّ عَلَى الْفَلَاحِ
اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ
لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ

Në ezanin e sabahut pas fjalëve: (حَيَّ عَلَى الْفَلَاحِ) duhet të lexohet dy herë fjala: (الصَّلَاةُ خَيْرٌ مِنَ النَّوْمِ). Në *ikamet* pas fjalëve (حَيَّ عَلَى الْفَلَاحِ) duhet të lexohet dy herë fjala : (قَدْ قَامَتِ الصَّلَاةُ).

Disa rregulla që kanë të bëjnë me ezanin

1. Nëse është thirrur *ezani* në qytet të vogël apo fshat, mjafton që të tjerët të falin namaz duke mos e përsëritur edhe një here *ezanin*, por, nëse e përsërisin *ezanin* secili *xhemat* në vete, lejohet dhe është gjë e pëlqyer (*mendub*).

2. Në qytetet e mëdha nëse *ezani* nuk arrin të dëgjohet nga të gjithë, atëherë është *sunnet* që çdo *xhemat* që nuk e dëgjon, të thërrasë *ezanin*.

3. Nëse dikush deshiron për të falur namaze *kaza* është *sunnet* të thërrasë *ezanin* dhe të bëjë *ikamet*. Po që se ka për t'i bërë *kaza* disa namaze, mundet vetëm me një *ezan*.

4. Ai i cili i falë namazet e mbetura (*kaza*) në xhami nuk duhet të bëjë *ikamet* e as të thërrasë *ezanin*.

5. Nëse ndodhë që namazi të priset dhe duhet të përseritet, nuk duhet as të thirrret *ezani* dhe as të bëhet *ikameti*.

6. Nuk është kusht për të pasur abdest kur të thirrret *ezani*, por, nëse merret abdest para se të thirrret është veprim i pëlqyer.

7. *Ezani* mund të thirrret edhe kur njeriu është i papastër (*xhunub*), por një veprim i tillë është *mekruh*.

8. Vlen *ezani* nëse është thirrur nga fëmija i moshës shtatëvje.

9. *Sunnet* është të përcillet në heshtje *muezini* duke e thirrur *ezanin*.

10. Dëgjuesi duhet ta thotë atë që thotë *muezini*, mirëpo, kur të arrijë *muezini* të fjala (حي على الصلاة) duhet të thuhet: (لا حول و لا قوة الا بالله), po ashtu edhe pas fjalëve: (حي على الفلاح) duhet të thuhet: (لا حول و لا قوة الا بالله).

11. Kur të kryhet *ezani* është *sunnet* që *muezini* dhe dëgjuesi i *ezanit* të lexojnë këtë dua:

اللَّهُمَّ رَبَّ هَذِهِ الدَّعْوَةِ التَّامَّةِ وَالصَّلَاةِ الْقَائِمَةِ آتِ مُحَمَّدًا الْوَسِيلَةَ وَالْفَضِيلَةَ
وَابْعَثْهُ مَقَامًا مَحْمُودًا الَّذِي وَعَدْتَهُ إِنَّكَ لَا تَخْلِفُ الْمِيعَادَ

Kushtet dhe pjesët përbërëse (ruknet) të namazit

شروط الصلاة و أركانها

Veprimet dhe shprehjet që janë brenda në namaz ndahen në këto kategori:

1. Veprimet dhe shprehjet që janë *farz* doemos duhet të zbatohen, e po që se njera prej tyre nuk zbatohet pa kurrëfarë arsye, atëherë namazi duhet të përsëritet.

2. Veprimet dhe shprehjet që janë *vaxhib*, nëse ndonjëri prej këtyre veprimeve lëshohet pa u zbatuar, pavarësisht a është lëshuar qëllimisht apo nga harresa, duhet të bëhet *sehvi sexhde*.

3. Veprimet dhe shprehjet që janë *sunnet*, nëse zbatohen ka shpërblim, e nëse lihen më qëllim, është gjë e urrejtur.

4. Veprimet dhe shprehjet që janë të rekomanduara (*mendub*) po që se zbatohen ka shpërblim e nëse nuk zbatohen nuk ka qortim.

Kushtet e namazit

شروط الصلاة

Kushtet e namazit janë parapërgatitje për të hyrë në namaz. Kushtet e tilla janë:

1. **Të qenët i pastër nga ndytësirat e padukshme** (الطهارة عن الحدث). Si ndytësirë e padukshme konsiderohet kur njeriu është pa abdest, i papastër (xhunub) dhe femra kur është me menstruacione apo në kohën e lehonisë.⁶⁰

2. **Të qenët i pastër nga ndytësirat e dukshme** (الطهارة عن الخبث). Me ndytësirat e dukshme nënkuptojmë ato ndytësira lëndore që e godasin trupin apo vendin ku duhet të falemi.⁶¹

Shënim:

Toka e tharë gjithmonë konsiderohet si vend i pastër për namaz, me përjashtim nëse në të ka ndytësirë. Kur thuhet të jetë vendi i pastër, nënkuptojmë vendin ku do të bihet në *sexhde*, të qëndrohet ulur dhe në këmbë. Nëse ndodhë që udhëtari nuk gjenë ujë për të evituar ndytësirën dhe nuk i mjaftojnë rrobat për të mbuluar pjesët e turpshme, atëherë ai duhet të falët me ndytësirë, dhe nuk duhet ta përsërisë namazin. E po që se ndodhë që vendasi (mukimi) ka ndytësirë dhe koha e namazit është afër për të përfunduar, i tilli nuk duhet të falet edhe po që se kalon koha pa u pastruar. *Sahibi yzri* (

⁶⁰ Si argument për këtë është fjala e Allahut xh.sh.: (وَإِنْ كُنْتُمْ جُنُبًا فَاطَّهَّرُوا) „...*nëse jeni të papastër, pastrohuni*...“, po ashtu edhe hadithi i Pejgamberit s.a.w.s.: (لَا يَقْبَلُ اللَّهُ صَلَاةَ أَحَدِكُمْ إِذَا أَحْدَثَ حَتَّى يَتَوَضَّأَ) “*Allahu nuk ia pranon namazin askujt që e ka prishur abdestin, derisa të mos marrë përsëri abdest*”.

⁶¹ Këtë e argumenton fjala e Allahut xh.sh.: (وَسَيَاكُ فَطَهَّرْ) “*Dhe rrobat tua pastroji*”.

(صَاحِبُ عَذْرِ), i sëmuri dhe plaku i moshës së thellë po që se ka ndytësirë dhe, përdorimi i ujit u bënë dëm, të tillët duhet të falen me të dhe nuk duhet të përsërisin namazin.

3. **Të jetë i mbuluar trupi** (ستر عورة). Meshkujt duhet doemos të kenë të mbuluar trupin prej gjunjve deri në kërthizë.⁶² Te femrat krejt trupi duhet të jetë i mbuluar përveç fytyrës, duarve dhe shputave të këmbëve deri në zogj.⁶³

Ai i cili është i burgosur, apo është në aso rrethanash në të cilat nuk mund të gjejë rroba, atëherë ai falet pa rroba, këmbët e shtrira kah *kibla* dhe namazin e tillë nuk duhet ta përsërisë.

4. **Të drejtuarit nga *kibla*** (إِسْتِقْبَالُ الْقِبْلَةِ)⁶⁴. Ai i cili gjendet në Qabe duhet të kthehet drejtë nga Qabeja, ndërsa ai i cili është larg Qabesë duhet të drejtohet nga ana e caktuar e *kibles*, nëse e di. Po që se ndodhë që nuk dihet nga është *kibla* dhe, nuk di kah të orientohet, duhet të falët kah ia merr mendja se është *kibla*. Ai i cili është i sëmure dhe nuk mund të drejtohet nga *kibla*, ose,

⁶² Argument është fjala e Pejgamberit s.a.w.s. (فَإِنْ مَا تَحْتَ السُّرَّةِ إِلَى الرُّكْبَةِ مِنَ الْعَوْرَةِ).
“Vërtetë prej nën kërthizës deri në gjunjë konsiderohet vend i turpshëm”.

⁶³ Hadithi i Pejgamberit s.a.w.s. të cilin e transmeton Aishja r.a. e cila tregon se Esma e bija e Ebu Bekrit, kishte hyrë te Pejgamberi s.a.w.s. dhe ajo kishte të veshura rroba të tejdukshme, Pejgamberi s.a.w.s. ia ktheu shpinën dhe i tha: “Oj Esma, kur femrat hyjnë në moshën madhore nuk lejohet t’i duket përveç kësaj e kësaj, bëri më shenjë në fytyrë dhe në duar”. Po ashtu si argument është fjala e Allahut xh.sh. : (وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ إِلَّا مَا ظَهَرَ مِنْهَا) “... të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme...”.

⁶⁴ Argument është ajeti : (فَوَلِّ وَجْهَكَ شَطْرَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ وَحَيْثُمَا كُنْتُمْ فَوَلُّوا وُجُوهَكُمْ شَطْرَهُ)
“Drejto fytyrën tendë nga Mesxhidi Harami (Qabeja), dhe ngado që të jeni ktheheni fytyrat tuaja nga ajo anë (Qabeja).”

kthyerja nga *kibla* e dëmton, atëherë i tilli do të falët në atë kahje në të cilën gjendet. Kur ndodhë që njeriut duke u falur i kujtohet se *kibla* është në anën tjetër, i lejohet të tillit të kthehet nga *kibla* duke mos e ndërprerë fare namazin.

5. **Të jetë koha e namazit** (وقت الصلاة)⁶⁵. Namazi për të qenë i kryer duhet doemos të falet në kohën e duhur, e po që se falet para se të hyjë koha, namazi i falur konsiderohet si namaz *nafile*, ndërsa namazi *farz* duhet të falet përsëri kur të hyjë koha e namazit të tillë.

6. **Të bërit *nijjet*** (النِّيَّة). *Nijjeti* është kusht të bëhet vetëm me zemër.⁶⁶ Parimore tek *nijjeti* është që *musaliu* të dijë se çfarë namazi mendon të falë.

Shënim: Tek namazet *farze* dhe *vaxhibe musaliu* duhet ta përcaktojë *nijjetin* me zemër se, cilin *farz* apo *vaxhib* ka për ta falur, f.v., të përcaktojë se do ta falë *farzin* e drekes apo të ikindisë apo *farzet* e tjera. Sa i përketë faktit nëse duhet të bëjë *nijjet* numrin e rekateve të namazeve *farze* dhe *vaxhibe*, një gjë e tillë nuk kërkohet të zbatohet. E po që se falë namaze *nafile* apo *sunnete*, nuk ka nevoj ta përcaktojë në *nijjet* se çfarë *sunneti* është duke falur, por mjafton që *nijjeti* të jetë për namaz. Po ashtu, *nijeti* për *farz* dhe *vaxhib*, mund të bëhet para se të shprehet *tekbiri* fillestar ose duke u shprehur, nëse ndodhë që pasi të hyjë në namaz të përcaktojë *musaliu* se cilin *farz* apo *vaxhib* është duke e falur, në këtë rast namazi i tillë shndërrohet në

⁶⁵ Argument për këtë është fjala e Allahut xh.sh. : (إِنَّ الصَّلَاةَ كَانَتْ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ كِتَابًا مَوْقُوتًا) : “*Vërtetë namazi është obligim për besimtarët në kohë të caktuar*”.

⁶⁶ Kjo argumentohet me hadithin e Pejgamberit s.a.w.s. : (إِنَّمَا الْأَعْمَالُ بِالنِّيَّاتِ) : “*Vërtetë veprat vlerësohen sipas qëllimit (nijjetit)*”.

namaz *nafile* dhe se *nijjeti* i tillë nuk vlen për t'u falur *farzi* apo *vaxhibi*. Nuk kushtëzohet të bëhet *nijjeti* para *tekbirit* fillestar, por *nijjeti* mund të behet edhe prej momentit kur është duke marrë abdest apo është duke i veshur rrobat për të falur namazin. E, po që se ndodhë që *musaliu* pasi të ketë bërë *nijjet*, është marrë me ndonjë veprim si, f.v., ka ngrënë ushqim, apo ka bërë ndonjë bisedë të zakonshme, i tilli duhet të përsërisë *nijjetin* me zemër.

Disa rregulla që kanë të bëjnë me *nijjetin*

1. *Nijjeti* është veprim që bëhet me zemër, ndërsa nëse *musaliu* me gjuhë shpreh gabimisht *nijjetin* si, f.v., e ka bërë *nijjet* me zemër për të falur drekën, ndërsa me gjuhë gabimisht thotë se po e bëjë *nijjet* për të falur ikindinë, në këtë rast *nijjeti* është i vlefshëm.

2. *Musaliu* kur të hyjë në namaz nuk mund ta ndryshojë *nijjetin* si, f.v., ka bërë *nijjet* për ta falur *farzin* e sabahut dhe, kur hyn në namaz, bën *nijjet* për të falur *sunnetin* e sabahut, në këtë rast do të konsiderohet se e ka kryer *farzin* e sabahut edhe pse *musaliu* ka dashur të ndryshojë *nijjetin*.

3. Ai i cili e ka bërë *nijjet* për të falur namaz *farz*, e pastaj, mendon se është duke falur *sunnet* dhe e plotëson namazin duke menduar se ka falur *sunnet*, mirëpo, më vonë i kujtohet se e ka pasur *nijjetin* për të falur *farz*, atëherë namazi i tij është kryer si *farz* dhe nuk ka nevojë të përsëritet.

4. Është *vaxhib* (obligim) për imamin, nëse në *xhematin* e tij ka femra, të bëjë *nijjet* se është imam edhe i femrave.

Kushtet mbrenda në namaz

أركان الصلاة

Kushte të brendshme të namazit konsiderohen ato veprime të cilat doemos duhet të zbatohen dhe, po që se lëshohet ndonjëri prej tyre, namazi është i prishur dhe duhet të përsëritet.

Kushtet e tilla janë:

1. **Tekbiri fillestar** (التحرمة)⁶⁷. Nuk mund të hyhet në namaz pa u thënë *tekbiri* fillestar, sepse me këtë *tekbir* fillon namazi. Kushtëzohet që *tekbiri* fillestar të shprehet me sinqeritet të plotë dhe me shprehje që e lartësojnë dhe e madhërojnë Allahun e Lartësuar si, f.v., اللهُ أَكْبَرُ, اللهُ أَكْبَرُ اللهُ أَكْبَرُ اللهُ أَكْبَرُ اللهُ أَكْبَرُ اللهُ أَكْبَرُ اللهُ أَكْبَرُ اللهُ, mirëpo, shprehja اللهُ أَكْبَرُ është *vaxhib* të thuhet në namaz dhe e tilla duhet të përdoret në të shprehurit e *tekbirit* fillestar. Po që se *musaliu* e fillon namazin me shprehje të cilat nuk shprehin madhërimin e Allahut si, f.v. بِسْمِ اللهُ (Me emër të Allahut) ; اَسْتَغْفِرُ اللهُ (Kërkoj falje prej Allahut) etj., namazi i tillë nuk vlen dhe duhet të përsëritet. Ai që i shurdhurë ose i sëmurë dhe nuk mund të shprehë *tekbirin* me zë, mjafton *nijjeti* i bërë më zemër.

2. **Të qëndruarit në këmbë** (القيام)⁶⁸. Me të qëndruarit në këmbë nënkuptohet qëndrimi drejtë, në

⁶⁷ Argument për këtë është fjala e Pejgamberit s.a.w.s. : مَفْسَاخُ الصَّلَاةِ الطُّهُورُ وَتَحْرِيمُهَا “Çelësi i namazit është pastërtia, fillimi i namazit është *tekbiri*, përfundimi i namazit është *selami*”.

⁶⁸ Argument për këtë është ajeti: (وَقُومُوا لِلَّهِ قَانِينَ) “Dhe ngrihuni për t'u falur me nënshtrueshmëri”. Po ashtu si argument mund të përmendim hadithin e Pejgamberit s.a.w.s. i cili i drejtohet sahabiut Umran bin Husajni i cili ishte i

mënyrë të zakonshme. Po që se ndodhë që *musaliu* duke e falur *farzin* i paraqitet marramendja apo ndonjë plogështi dhe nuk mund të qëndrojë në këmbë, i tilli duhet të vazhdojë namazin ulur. Të qëndruarit në këmbë është *rukn* vetëm për namazet *farze*, ndërsa namazet *nafile* mund të falën edhe pa qendruar në këmbë, mirëpo shpërblimi në këtë rast është i përgjysmuar.

3. Leximi i ndonjë pjese të Kur'anit (الْقِرَاءَةُ)⁶⁹.

Leximi në namazet *farze* është *rukn* në dy rekatet e para, ndërsa në namazet *vaxhibe*, *sunnete* dhe *nafile* është *rukn* në të gjitha rekatet. Gjatë leximit kushtëzohet që fjalët të shqiptohen qartë në heshtje, sa e dëgjon vetë *musaliu*.

4. Të bërit *ruku* në çdo rekat (الركوع)⁷⁰.

5. Të bërit *sexhde* dy herë në çdo rekat (السجود)⁷¹

Farz në të zbatuarit e *sexhdes* është që balli të prekë në tokë.

6. Ulja e fundit në çdo namaz (الْقُعُودُ الْأَخِيرُ)⁷²

sëmurë duke i thënë: (صَلِّ قَائِمًا فَإِنْ لَمْ تَسْتَطِعْ فَقَاعِدًا فَإِنْ لَمْ تَسْتَطِعْ فَعَلَى جَنْبٍ) “*Falu në këmbë, e nëse nuk mundesh, atëherë falu ulur, e po qe se nuk mundesh ulur, atëherë falu shtrirë*”. (Transmeton Muslimi)

⁶⁹ Argument për këtë është ajeti: (فَأَقْرُؤُوا مَا تَيَسَّرَ مِنَ الْقُرْآنِ) “*Lexoni atë që u vjen më së lehti prej Kur'anit*”. Po ashtu hadithin e Pejgamberit s.a.w.s. : (لَا صَلَاةَ إِلَّا بِقِرَاءَةٍ) “*Nuk ka namaz pa leximin e Kur'anit*”. (Transmeton Muslimi). Mund të përmendim edhe hadithin: (إِذَا قُمْتَ إِلَى الصَّلَاةِ فَكَبِّرْ ثُمَّ اقْرَأْ مَا تَيَسَّرَ مَعَكَ مِنَ الْقُرْآنِ) “*Kur të ngrihesh për të falur namazin bëre tekbirin e pastaj lexo ato që të vjen më lehtë prej Kur'anit*”. (Transmeton Buhariu dhe Muslimi).

⁷⁰ Argument është ajeti: (يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا ارْكَعُوا وَاسْجُدُوا) “*O ju që keni besuar bëni ruku dhe sexhde*”.

⁷¹ Shih argumentin për *rukunë*, i tilli është argument edhe për *sexhden*.

⁷² Këtë e argumenton hadithi i Pejgamberit s.a.w.s. që shpejgon se kur Pejgamberi s.a.w.s. i ka mësuar Ibn Mes'udit r.a. se si të bëte uljen e fundit i ka

VAXHIBET E NAMAZIT

وَاجِبَاتُ الصَّلَاةِ

Vaxhibet e namazit janë:

1. **Që tekberi fillestar të shprehet me fjalën (الله أكبر).** Nëse ndodhë që *musaliu* të harrojë apo gabimisht të fillojë *tekbirin* fillestar me ndonjë shprehje tjetër, f.v. (الله أرْحَمُ), apo me diçka të ngjashme, i tilli, nëse në fillim të *tekbirit* e vëren se ka gabuar, mund ta përsërisë *tekbirin* edhe një herë, mirëpo, nëse e fillon namazin pa e vërejtur gabimin duhet vazhduar namazin por në fund duhet bërë *sehvi sexhde*.

2. **Leximi i Fatihasë.**⁷³ Leximi i *fatihasë* në dy *rekatet* e namazeve *farze* është *vaxhib*, në *rekatet* e fundit është *sunnet*, ndërsa në namazet *nafile* dhe në *vitër* është *vaxhib* të lexohet në të gjitha *rekatet*.

3. **Sasia e të lexuarit nga Kur'ani së paku një ajet i gjatë, apo tre të shkurta, apo një sure e shkurtër pas fatihasë.** Leximi i Kur'anit në namazet *farze* bëhet vetëm në dy *rekatet*⁷⁴ e para, ndërsa, te namazet *nafile* dhe në *vitër* në të gjitha *rekatet*.

thenë: (إِذَا قُلْتُمْ هَذَا أَوْ فَعَلْتُمْ هَذَا فَقَدْ تَمَّتْ صَلَاتُكُمْ) “Kur të thuash këtë (*teshehudin*) dhe ta kryesh uljen e fundit, atëherë namazi yt është plotësuar”.

⁷³ Argument për këtë është fjala e Pejgamberit s.a.w.s.: مَنْ صَلَّى صَلَاةً لَمْ يَقْرَأْ بِأَمِّ الْقُرْآنِ فَهِيَ خِدَاجٌ فَهِيَ خِدَاجٌ فَهِيَ خِدَاجٌ “Ai që e falë namazin pa e lexuar *fatihanë*, ai namaz është i mangët, ai namaz është i mangët, ai namaz është i mangët”. (Transmeton Ahmedi dhe Ibn Maxhe).

⁷⁴ Argument për këtë është hadithi që transmeton Buhariu nga Abdila bin Ebi Katade e ky nga babai i tij i cili ka thënë: كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقْرَأُ فِي رَكَعَتَيْنِ مِنْ

4. الترتيب في القراءة - **Rradhitja e leximit.** Do të thotë të lexohet një herë *fatih*a e pastaj diç nga Kur'ani.⁷⁵ Nëse ndodhë që *musaliu* harron dhe e lexon *suren* para *fatih*as, e po që se ka shkuar në *ruku* dhe nuk e ka përsëritur *kiraetin* i tilli e vazhdon namazin dhe në fund bënë *sehvi sexhde*.

5. السُّجُودُ عَلَى الْأَنْفِ أَيْضًا مَعَ الْجُهِةِ - **Të vendosurit e hundës në *sexhde* bashkë me ballin.** Dihet që të vendosurit e ballit në *sexhde* është *farz*, ndërsa vendosja e hundës është *vaxhib*.

6. الْقُعُودُ الْأَوَّلُ - **Të qëndruarit në uljen e parë në namazet që kanë tri e më shumë *rekate***⁷⁶. Nëse ndodhë që *musaliu* të harrojë të qendrojë në këtë ulje, duhet doemos të bëjë *sehvi sexhde*.

7. قِرَاءَةُ الشَّهَادَةِ فِي الْقُعُودَيْنِ الْأَوَّلِ وَالْآخِرِ - **Leximi i *teshehudit* në uljen e parë dhe të fundit.**⁷⁷

8. الْقِيَامُ بَعْدَ الشَّهَادَةِ الْأَوَّلِ إِلَى الرَّكْعَةِ الثَّلَاثَةِ دُونَ تَأْخِيرِ - **Të ngriturit pas *teshehudit* duke mos u vonuar në *rekatin* e tretë.** Nëse *musaliu* vonohet aq sa mund ta kryejë ndonjë *rukn* atëhere ai duhet të bëjë *sehvi sexhde*, ngase e ka vonuar *rekatin* e tretë.

الطُّهْرِ وَالْعَصْرِ بِفَاتِحَةِ الْكِتَابِ وَ سُورَةٍ وَ يَسْمَعُنَا آيَةَ أَحْيَاثًا *“Pejgamberi s.a.w.s. lexonte në dy rekatet e drekës dhe të ikindisë fatihanë dhe një sure, e nganjëherë kemi dëgjuar leximin e ndonjë ajetit”.*

⁷⁵ Këtë e argumenton veprimi i vazhdueshem i Pejgamberit s.a.w.s. i cili në namaz gjithmonë e ka lexuar *fatihanë* e pastaj *suren* apo ajetin.

⁷⁶ Argument për këtë është veprimi i vazhdueshëm i Pejgamberit s.a.w.s. në qëndrimin në uljen e parë.

⁷⁷ Hadithi: (إِذَا قَعَدْتُمْ فِي كُلِّ رَكْعَةٍ فَقُولُوا : التَّحِيَّاتُ ...) *“Në çdo ulje thuani: et-tehijjatu ...”*

9. **إِنِّهَا الصَّلَاةَ بِالتَّسْلِيمِ - Të përfunduarit e namazit me selam**⁷⁸.

Vaxhib është të shprehet vetëm fjala (السلام), ndërsa fjala (عليكم ورحمة الله) është *sunnet*.

10. **الإِطْمِئْنَانُ عِنْدَ أَدَاءِ فَرَائِضِ الصَّلَاةِ - Të qenët i qetë duke i zbatuar ruknet e namazit.**⁷⁹ Ky rregull nënkupton atë që *musaliu* gjatë kohës së faljes së namazit nuk duhet të nxitojë në kryerjen e *rukneve* të namazit, por ai duhet të qëndrojë i qetë dhe t'i zbatoj ashtu si duhet, f.v., kur të shkohet në *ruku* të bëhet *rukuja* ngadalë dhe qetë etj.

11. **تَعْدِيلُ الْأَرْكَانِ - Të zbatuarit e rukneve në mënyrë të rregullt**⁸⁰.

12. **يَجِبُ عَلَى الْإِمَامِ الْجَهْرُ فِي الصَّلَوَاتِ الْجَهْرِيَّةِ وَالْأَسْرَارُ فِي الصَّلَوَاتِ السِّرِّيَّةِ - Që imami të lexojë në heshtje në namazin e drekës dhe të ikindisë, ndërsa në namazin e sabahut, akshamit dhe të jaciesë më zë.**

⁷⁸ Argument për këtë është fjala e Pejgamberit s.a.w.s. : **مِفْتَاحُ الصَّلَاةِ الطُّهُورُ وَتَحْرِيقُهَا** "Çelësi i namazit është pastërtia, fillimi i namazit është tekibri, përfundimi i namazit është selami".

⁷⁹ Argument për këtë është hadithi: **إِذَا قُنِيتَ إِلَى الصَّلَاةِ فَكَبِّرْ ثُمَّ اقْرَأْ مَا تيسَّرَ مَعَكَ مِنَ الْقُرْآنِ ثُمَّ ارْكَعْ حَتَّى تَطْمَئِنَّ رَأْسًا ثُمَّ ارْفَعْ حَتَّى تَعْتَدِلَ فَإِنَّمَا تَمَّ اسْجُدُ حَتَّى تَطْمَئِنَّ جَالِسًا ثُمَّ اسْجُدْ** "Kur të ngrihesh për t'u falur bëre tekbirin fillestar e pastaj lexo çka të duket më lehtë prej Kur'anit, e pastaj bëj ruku derisa të bësh rukunë qetë, pastaj ngritu derisa të drejtohesh drejt, pastaj bëj sexhde derisa të qëndrosh qetë në sexhde, e pastaj ngritu derisa të qëndrosh ulur i qetë, pastaj bën sexhde derisa të qëndrosh i qetë në sexhde, e pastaj kështu vepro gjatë gjithë namazit tënd". (Transmeton Buhariu dhe Muslimi).

⁸⁰ Argument hadithi i Pejgamberit s.a.w.s.: **اعْتَدِلُوا فِي الرُّكُوعِ وَالسُّجُودِ وَلَا يَسْطُ أَحَدُكُمْ** "Bëje rukunë dhe sexhden ashtu si duhet dhe mos t'i shtrijë ndonjëri prej jush krijët sikur që i shtrinë qeni".

13. **يَجِبُ عَلَى الْمُقْتَدِي أَنْ يَنْصِتَ وَرَاءَ إِمَامِهِ** – Që *muktediu* të heshtë kur të falet pas imamit⁸¹. Ai i cili është duke u falur pas imamit nuk i lejohet të lexojë *fatihanë* dhe as *suren* apo ajetin kur të qëndrojë në këmbë, pavarësisht se a është namaz që imami lexon më zë apo pa zë, ndërsa duatë dhe shprehjet tjera duhet t'i lexojë.

14. **يَجِبُ عَلَى الْمُقْتَدِي مُتَابَعَةَ إِمَامِهِ** - Duhet që *muktediu* ta ndjekë imamin dhe nuk lejohet të shkojë para apo të vonohet shumë pas imamit.⁸²

15. **الْقُنُوتُ وَالتَّكْبِيرُ فِي صَلَاةِ الْوَيْثْرِ** -Të bërit *kunut* dhe *tekbir* në namazin e *vitrit*.⁸³ Këndimi i duasë se *kunutit* është *sunnet*, ndërsa të bërit *kunut* dhe *tekbir* në namazin e *vitrit* konsiderohet *vaxhib*.

SUNNETET E NAMAZIT

سُنُنُ الصَّلَاةِ

Sunetet e namazit janë:

⁸¹ Argument është hadithi: (مَنْ كَانَ مَأْمُومًا فَقِرَاءَةُ الْإِمَامِ لَهُ قِرَاءَةٌ) “Kush është muktedi, për të mjafton vetëm leximi i imamit”.

⁸² Argument është hadithi: (إِنَّمَا جُعِلَ الْإِمَامُ لِيُؤْتَمَّ بِهِ فَإِذَا كَبَّرَ فَكَبِّرُوا وَإِذَا قَرَأَ فَأَنْصِتُوا) “Vërtetë imami është ai që duhet të ndiqet, kur ai bën *tekbirin* bëni edhe ju, e kur ai të lexojë diç nga *Kur’ani*, heshtni dhe dëgjoni”. (Transmeton: Muslimi, Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibn Maxhe).

⁸³ Argument është ky hadith: (أَنَّهُ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَانَ يَقْنُتُ فِي النَّالَةِ قَبْلَ الرَّكْعَةِ) “Vërtetë Pejgamberi s.a.w.s. bënte *kunut* në rekatën e tretë para se të shkonte në ruku”.

1. رَفْعُ اليَدَيْنِ لِلتَّحْرِيمَةِ - Të ngriturit e duarve deri në laprat e vesheve në *tekbirin* fillestar⁸⁴. Sa i përket femrës ajo i ngre duart deri të supet.

2. نَشْرُ أَصَابِعِهِ - Të zgjeruarit e gishtave gjatë ngritjes në *tekbirin* fillestar.

3. جَهْرُ الإِمَامِ بِالتَّكْبِيرِ - Që imami t'i shprehë *tekbiret* në namaz.⁸⁵ Thënia e *tekbireve* me zë nga ana e imamit është *sunnat* gjatë gjithë namazit.

4. وَضْعُ اليَدِ اليُمْنَى فَوْقَ اليُسْرَى تَحْتَ السَّرَّةِ - Të vendosurit e dorës së djathtë mbi të majtën nën kërthizë⁸⁶. Kur të lidhen duart për namaz, dora e djathtë duhet të vendoset mbi shpinën e dorës së majtë dhe me gishtin e madh e të vogël të përthekohet unaza e dorës së majtë. Femrat duart duhet t'i lidhin mbi gjoks.

5. التَّرْوِيعُ بَيْنَ الْقَدَمَيْنِ عِنْدَ إِطَالَةِ الْقِيَامِ - Të larguarit e këmbëve mes veti gjatë qëndrimit në këmbë në masën e katër gishtave.

⁸⁴ Argument është hadithi: (كَانَ إِذَا كَبَّرَ رَفَعَ يَدَيْهِ حَتَّى يُحَادِيَ نَهْمًا فُرُوعَ أُذُنَيْهِ) “Vërtetë Pejgamberi s.a.w.s. kur e ka bërë *tekbirin* fillestar i ka ngritur duart deri tek lapratt e veshëve”. (Transmeton Muslimi).

⁸⁵ Argument është hadithi: كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ إِذَا قَامَ إِلَى الصَّلَاةِ اعْتَدَلَ قَائِمًا ثُمَّ قَالَ اللَّهُ “Pejgamberi s.a.w.s. kur ngrihej për t'u falur drjetohej drejt dhe pastaj thonte Allahu Ekber”. (Transmeton Tirmidhiu).

⁸⁶ Argument është hadithi: ثَلَاثٌ مِنْ أَخْلَاقِ الْأَنْبِيَاءِ : تَعْجِيلُ الْإِفْطَارِ وَتَأْخِيرُ السُّحُورِ وَوَضْعُ اليُمْنَى عَلَى السَّرَّةِ “Tri gjëra janë prej etikës së Pejgamberëve: të shpejtuarit në ngrënien e iftarit, të vonuarit e syfyrit dhe të vendosurit e dorës së djathtë mbi të majtën nën kërthizë (në namaz).”

6. قِرَاءَةُ دُعَاءِ الشَّاءِ – Të lexuarit e *subhanekes*⁸⁷.
7. قِرَاءَةُ التَّعُوذِ وَ التَّسْمِيَةِ وَ التَّأْمِينِ سِرًّا – Të lexuarit e *eudhubesmeles dhe aminit pa zë*.⁸⁸
8. أَنْ يُكَبِّرَ الْمُصَلِّي لَهُ عِنْدَمَا يَتَّجِهَ إِلَى الرُّكُوعِ – Që *musaliu* kur të shkojë në *ruku* të thotë *tekbirin*.⁸⁹
9. أَنْ يُسَوِّيَ ظَهْرَهُ فَيَجْعَلُهُ مُسْتَقِيمًا حَالَ رُكُوعِهِ – Që *musaliu* kur të shkojë në *ruku* ta drejtojë shpinën drejt.
10. أَنْ يَقُولَ سُبْحَانَ رَبِّيَ الْعَظِيمِ ثَلَاثًا – Që *musaliu* të thotë tri herë *subhane rabbijel adhim*.⁹⁰
11. قَوْلُ سَمِعَ اللهُ لِمَنْ حَمِدَهُ – Të thënit *semiallahu limen hamideh* kur të ngrihet *musaliu* nga *rukuja*.⁹¹

⁸⁷ Argument për këtë është hadithi: كَانَ إِذَا كَبَّرَ رَفَعَ يَدَيْهِ حَتَّى يُحَازِي أُذُنَيْهِ وَيَقُولُ سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَ بِحَدِّكَ وَ تَبَارَكَ اسْمُكَ وَ تَعَالَى جَدُّكَ وَ لَا إِلَهَ غَيْرُكَ *“Pjegamberi s.a.w.s. kur e bënte tekbirin fillestar i ngritte duart deri te laprat e veshëve dhe këndonte Subhaneken...”*.

⁸⁸ Argument për atë se besmelja duhet të lexohet pa zë është transmetimi që e bënë Ibn Mesudi r.a.:

(صَلَّيْتُ خَلْفَ النَّبِيِّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وَ خَلْفَ أَبِي بَكْرٍ وَ عُثْمَانَ فَكَانُوا لَا يَجْهَرُونَ بِبِسْمِ اللهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ) *“Jam falur prapa Pejgamberit s.a.w.s. dhe prapa Ebi Bekrit dhe Uthmanit r.a. e ata nuk e lexonin më ze besmelen...”*. (Transmeton Nesaiu). Për atë se amini duhet të lexohet pa zë kemi argument hadithin: فَلَمَّا بَلَغَ غَيْرَ الْمُغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَ لَا الضَّالِّينَ قَالَ: آمِينَ وَ أَخْفَى بِهَا صَوْتَهُ *“...pasi ka arritur (Pejgamberi s.a.w.s.) te fjala gajril magdubi alejhim ve ledal-lin, ka thënë amin pa zë”*. Transmeton Ahmedi dhe Ebu Davudi.

⁸⁹ Argument është rasti kur Pejgamberi s.a.w.s. i drejtohet Enesi r.a. duke i thenë: (إِذَا رَكَعْتَ فَضَعْ يَدَكَ عَلَى رُكْبَتَيْكَ وَ فَرِّجْ بَيْنَ أَصَابِعِكَ وَ ارْفَعْ يَدَيْكَ) *“Kur të bësh ruku vendosi duart në gjunjë, dhe mbaj gishtat e ndarë mes veti dhe mos i prek me krah anët e barkut”*.

⁹⁰ Argument është hadithi: (إِذَا رَكَعَ أَحَدُكُمْ فَلْيَقُلْ ثَلَاثَ مَرَّاتٍ سُبْحَانَ رَبِّيَ الْعَظِيمِ...) *“Kur ndonjëri prej jush të bëjë ruku le të thotë tri herë: Subhane rabbijel adhim...”*.

⁹¹ Argument është hadithi: أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَانَ إِذَا قَامَ إِلَى الصَّلَاةِ يُكَبِّرُ حِينَ يَقُومُ ثُمَّ يُكَبِّرُ حِينَ يَرُكِعُ ثُمَّ يَقُولُ سَمِعَ اللهُ لِمَنْ حَمِدَهُ حِينَ يَرُكِعُ حِينَ يَرُفَعُ صَلْبَهُ مِنَ الرُّكُوعِ ثُمَّ يَقُولُ وَهُوَ قَائِمٌ رَبَّنَا لَكَ الْحَمْدُ... *“Vërtetë”*

12. قَوْلُ رَبَّنَا لَكَ الْحَمْدُ – Të thënit rabbena lekel hamd kur të drejtohem në këmbë pasi të ngritemi nga rukuja.⁹²

13. أَنْ يَنْزِلَ فِي السُّجُودِ عَلَى الْأَعْضَاءِ الْأَقْرَبِ إِلَى الْأَرْضِ – Të rënët në *sexhde* me pjesët e trupit që janë më afër tokës, d.t.th. në fillim t'i lëshojmë gjunjtë e pastaj duart e pastaj fytyrën.⁹³

14. أَنْ يَكُونَ السُّجُودُ عَلَى الْعِظَامِ السَّبْعَةِ – Që *sexhdja* të bëhet me shtatë gjymtyrë të trupit, e ato janë: balli, dy duartë, gjunjtë, dhe këmbët.⁹⁴

15. أَنْ يُجَافِيَ الرَّجُلَ مِرْفَقَيْهِ عَنْ جَنْبَيْهِ وَأَنْ يُجَافِيَ بَطْنَهُ عَنْ فَخْذَيْهِ فَلَا يَلْزُقُ بِهِمَا – Që *musaliu* kur të bjerë në *sexhde* t'i largojë këmbët mes veti dhe barkun mos ta bashkojë me kofshët. Sa i përket femrës, ajo duke u falur duhet të jetë sa më e strukur dhe duhet të bashkojë barkun me gjunj kur të bijë në *sexhde*.⁹⁵

Pejgamberi s.a.w.s. kur ngrihej për t'u falur thonte tekbinin, e pastaj bënte tekbinin kur shkonte në ruku, e kur ngrihej nga rukuja thonte semiallahu limen hamideh, e kur drejtohej drejt në këmbë thonte rabbena lekel hamd...” (Transmeton Buhariu dhe Muslimi).

⁹² Shih argumentin në fusnotën e mëparshme.

⁹³ Argument për këtë është hadithi i Pejgamberit s.a.w.s.: أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَانَ إِذَا سَجَدَ وَضَعَ رُكْبَتَيْهِ قَبْلَ يَدَيْهِ وَإِذَا نَهَضَ رَفَعَ يَدَيْهِ قَبْلَ رُكْبَتَيْهِ “Vërtetë Pejgamberi s.a.w.s. kur ka rënë në *sexhde* i ka lëshuar gjunjtë para duarve, e kur është ngritur prej *sexhdes* i ka ngritur duart para gjunjve”. (Transmetojnë katër imamët).

⁹⁴ Argument për këtë është hadithi: أَمْرُ أَنْ أَسْجُدَ عَلَى سَبْعَةِ عِظَامٍ: عَلَى الْجَبْهَةِ وَالْيَدَيْنِ وَالرُّكْبَتَيْنِ وَأَطْرَافِ الْقَدَمَيْنِ “Jam urdhëruar që të bëjë *sexhde* me shtatë gjymtyrë: me ballë, me dy duart, dy gjunjtë dhe me shputat e këmbëve”. (Transmeton Buhariu dhe Muslimi).

⁹⁵ Argument për këtë se femra duhet të jetë me e strukur në namaz e kemi rastin e Pejgamberit s.a.w.s. i cili kur ka kaluar pranë dy grave që ishin duke u falur u

Shënim: Po që se është grumbull i madh i *xhematit*, në këtë rast edhe meshkujt duhet të ngushtohen dhe, në qoftë nevoja, duhet mbledhur këmbët duke vepruar në atë mënyrë që mos ta pengosh atë që e ke afër.

16. **Që këmbët të mbahen në mënyrë vertikale kur të bjerë në *sexhde* dhe gishtat e këmbëve të jenë të kthyer nga kibla.**

17. **قَوْلُ سُبْحَانَ رَبِّيَ الْأَعْلَى ثَلَاثَ مَرَّاتٍ – Të thënë tri herë në *sexhde* subhane rabbijel e’ala.**⁹⁶

18. **أَنْ يُكَبِّرَ لِلْجُلُوسِ وَ هُوَ رَافِعٌ مِنَ السَّجْدَةِ الْأُولَى – Që të bëjë *tekbirin* për të shkuar në *sexhde*.**

19. **أَنْ يَكُونَ الْجُلُوسُ بَيْنَ السَّجْدَتَيْنِ – Të qëndruarit ulur për disa çaste në mes dy *sexhdeve*.**

20. **التَّكْبِيرُ لِلْقِيَامِ – Të bërët *tekbir* për t’u ngritur nga *sexhdeja* për të qëndruar në këmbë.**

21. **أَنْ يَبْدَأَ الْقِيَامَ مِنَ السُّجُودِ بِشَكْلِ مَرِيحٍ – Që ngritja prej *sexhdes* për të shkuar në *kijam* të bëhet në mënyrë të qetë.**

22. **الْإِفْتِرَاشُ – Të ulurit në atë mënyrë që këmba e majtë të shtrihet nga këmba e djathtë, ndërsa këmba e djathtë duhet të qendrojë në mënyrë vertikale që gishtat të jenë të kthyer nga *kibla* ndërsa duart**

ka thënë: (إِذَا سَجَدْتُمَا فَضُمَّمَا بَعْضَ اللَّحْمِ إِلَى بَعْضٍ فَإِنَّ الْمَرْأَةَ لَيْسَتْ فِي ذَلِكَ كَالرَّجُلِ) “Kur të bëni *sexhde* bashkoheni barkun me gjunjët, se vërtetë femra në këtë rast nuk duhet të veprojë si mashkulli”. (Transmeton Ebu Davudi).

⁹⁶ Argument është hadithi: (إِذَا سَجَدَ فَلْيَقُلْ سُبْحَانَ رَبِّيَ الْأَعْلَى ثَلَاثَ مَرَّاتٍ...) “...kur të bijë dikush në *sexhde* le të thotë subhane rabbijel e’ala, tri herë...”.

duhen vendosur mbi gjunj. Ky rregull vlen vetëm për meshkujt.

23. التَّورُكُ – Që femrat kur të ulen këmbët duhet t'i shtrijnë në anën e djathtë.

24. عِنْدَ النَّطْقِ بِالشَّهَادَتَيْنِ مِنَ التَّحِيَّاتِ أَنْ يَطْوِيَ أَصَابِعَ يَمَنَاهُ وَيَنْشُرُ السَّبَابَةَ. – Që kur të lexohet *shهادeti* në ulje, dora e djathtë duhet të mbështillet, e kur të thuhet shprehja (لا) të ngrihet gishti tregues, ndërsa të ulet tek shprehja (إلا).

25. قِرَاءَةُ الصَّلَوَاتِ الْإِبْرَاهِيمِيَّةِ – Të lexuarit e *salavateve*.

26. قِرَاءَةُ الْأَدْعِيَّةِ – Të lexuarit e *duave*.

27. -Që kur të japë *selam* duhet kthyer fytyrën nga ana e djathtë dhe nga e majta në mënyrë që, kur të kthehet fytyra, të duken mollëzat e fytyrës nga ai që është prapa.⁹⁷

ADABET E NAMAZIT

آدَابُ الصَّلَاةِ

Musaliu duhet të jetë sa më i koncentruar në namaz, dhe, mu për këtë, ai duhet t'u përmbahet disa

⁹⁷ Argument për këtë është transmetimi që e bën Sead bin Vekasi i cili tregon duke thënë: “كُنْتُ أَرَى رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يُسَلِّمُ عَنْ يَمِينِهِ وَيَسَارِهِ حَتَّى أَرَى بَيَاضَ خَدِّهِ” “E kam parë Pejgamberin s.a.w.s. i cili jepte *selam* nga ana e djathtë dhe pastaj nga ana e majtë saqë unë ia kam parë mollëzat e fytyrës”. Transmeton Muslimi.

rregullave të quajtura *adab*⁹⁸, të cilat i mundësojnë *musaliut* që të jetë sa më i disiplinuar në namaz.

Adabet e namazit janë:

1. **Që** *— أَنْ يَقُومَ إِلَى الصَّلَاةِ عِنْدَمَا يَقُولُ الْمُقِيمُ (حَيَّ عَلَى الْفَلَاحِ)* **Që** *musaliu* të ngritet për të hyrë në namaz, kur muezini, duke bërë ikamet, thotë “*hajje alel felah*” .

2. **Që** *— أَنْ يَنْظُرَ إِلَى مَوْضِعِ سُجُودِهِ* **Që** *musaliu* duke u falur të shikojë vendin se ku do të bjerë në *sexhde*.

3. **Që** *— أَنْ يَكْظِمَ فَمَّهُ عِنْدَ التَّأْوُبِ* **Që** *musaliu* mundësisht të mbyllë gojën nëse i hapet.

4. **Që** *— أَنْ يُخْرِجَ كَفَّيْهِ مِنْ كُمَيْهِ عِنْدَ التَّكْبِيرِ* **Që** t'i shtrijë mëngët e rrobëve nga dora para se të marrë *tekbirin*.

5. **Që** *— أَنْ يَحْضُرَ ذَهْنُهُ فِي مُتَابَعَةِ مَا يَقْرَأُهُ أَوْ يَفْعَلُهُ مِنَ الْأَفْعَالِ وَالْأَقْوَالِ* **Që** *musaliu* të përqendrojë të menduarit në atë që është duke e lexuar dhe në atë çka është duke folur dhe vepruar në namaz.

LUTJET PAS NAMAZIT

الذُّكُورُ الْوَارِدَةُ بَعْدَ الصَّلَاةِ

Rekomandohet që *musaliu* pasi ta ketë kryer namazin, të bëj disa lutje që të arrijë shpërblim nga Allahu xh.sh. Lutjet që i ka përdorur Pejgamberi s.a.w.s. janë të shumta.

⁹⁸ Adab d.m.th. diçka e preferueshme, e rekomanduar , e pëlqyeshme.

Lutjet më të njohura janë:

1. Që të kërkohet falja nga ana e Allahut xh.sh. tri herë dhe të lexohet : (اللَّهُمَّ أَنْتَ السَّلَامُ وَمِنْكَ السَّلَامُ تَبَارَكْتَ يَا ذَا الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ)⁹⁹.

2. Të lexohet ajeti *Kursijja*:

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ لَا تَأْخُذُهُ سِنَّةٌ وَلَا نَوْمٌ لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ

Kaptina el-Ihlas:

(قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ اللَّهُ الصَّمَدُ لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ)

Kaptina el-Felek:

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ

Kaptina en-Nas:

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ مَلِكِ (النَّاسِ إِلَهِ النَّاسِ مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ الَّذِي يُوَسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ)

3. Të thuhet 33 herë subhanallah, 33 herë elhamdulillah dhe 33 herë Allahu Ekber, e pastaj të lexohet:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ (الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ)

⁹⁹ Për këte është argument hadithi: كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ إِذَا انْصَرَفَ مِنْ صَلَاتِهِ اسْتَغْفَرَ: "Pejgamberi s.a.w.s. pasi e krynete namazin kërkonte falje nga Allahu xh.sh. tri herë duke thënë: O Zot! Ti je paqë, dhe nga Ti buron paqja, i pastër je pa të meta; je Pronar i madhërisë dhe fisnikërisë". (Transmeton Muslimi).

4. Të bëhet dua ja duke u lutur për vete dhe për besimtarët dhe se dua ja duhet të përfundojë me ajetet kur'anore:

سُبْحَانَ رَبِّكَ رَبِّ الْعِزَّةِ عَمَّا يَصِفُونَ وَسَلَامٌ عَلَى
(الْمُرْسَلِينَ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ)

GJËRAT QË E PRISHIN NAMAZIN

مُفْسِدَاتُ الصَّلَاةِ

Gjërat që e prishin namazin janë:

1. **الْحَدَثُ فِي الصَّلَاةِ** - **Të prishurit e abdestit**¹⁰⁰. Nëse ndodhë që duke u falur të shkaktohet prishja e *abdestit*, në atë moment edhe namazi konsiderohet i prishur, ngase, në këtë moment, nuk plotësohet kushti namazit-*abdesti*.

2. **طُرُوءُ النَّجَاسَةِ** – **Të paraqiturit e ndytësirës**. Nëse *musaliu* hyn në namaz e pastaj e godet ndytësira, qoftë trupin e tij apo vendin ku do të falet dhe ndytësira është e lëngët, atëherë duhet prishur namazin dhe duhet përsëritur. E nëse ndytësira është e ngurtë dhe ka mundësi për t'u evituar menjëherë, *musaliu* e vazhdon namazin; e nëse nuk mund ta evitojë menjëherë, por vonohet, sa të thuhet tri herë subhanallah, duhet përsëritur namazin.

Ai person i cili, pasi është falur, vëren se ka pasur ndytësirë dhe nuk e di se kur e ka goditur ndytësira, duhet të veprojë sipas asaj që ia merr mendja e tij; e nëse mendja e tij anon më shumë kah ajo se ndytësira e

¹⁰⁰Mu për këtë Pejgamberi s.a.w.s. ka thenë: (مَنْ قَاءَ أَوْ رَعَفَ فِي صَلَاتِهِ فَلْيُنْصَرَفْ وَ لْيَتَوَضَّأْ)
“Ai i cili ka vjellur ose i ka rrjedhur gjak, le të dalë prej namazit dhe të marre abdest”.

ka goditur pasi e ka kryer namazin, nuk e përsërit namazin, e nëse mendja e tij anon kah ajo se ndytësira ka mundësi ta ketë goditur gjatë kohës sa ka qenë në namaz, duhet ta përsërisë namazin.

Në rast se ndokush e sheh dikë tek falet në ndytësirë e cila pengon kryerjen e namazit, pas kryerjes së namazit duhet lajmëruar se në ç'kushte e ka falë namazin, por me kusht që të ketë bindje se *musaliu* do ta përsërisë faljen e namazit, e nëse nuk ka bindje se ai do ta përsërisë faljen e namazit, më mirë është të mos e lajmerojë. Sidoqoftë namazi i këtij është i kryer.

3. **اِنْكَشَافُ شَيْءٍ مِنَ الْعَوْرَةِ - Të zbuluarit e ndonjë pjesë të trupit që konsiderohet *avret*¹⁰¹.** Kur ndodhë që gjatë kohës kur *musaliu* është në namaz ta ketë të zbuluar ndonjë pjesë të trupit, qoftë nga harresa apo rastësisht, i tilli duhet të shikojë vendin e zbuluar se a është zbuluar $\frac{1}{4}$ e ndonjë pjesë të trupit që është *avret*, e nëse është kështu, duhet ta mbulojë menjëherë pjesën e zbuluar duke mos u vonuar aq sa mund të thuhet tri herë *subhanallah*. Në këtë rast namazi nuk konsiderohet i prishur dhe duhet të kryhet pa e ndërprerë fare. Nëse vonohet mbulimi i pjesës e cila është zbuluar në namaz më tepër sesa që të thuhet tri herë *subhanallah*, namazi konsiderohet i prishur dhe duhet të përsëritet. Kur ndodhë që *musaliu* me qëllim e zbulon pjesën e trupit që konsiderohet *avret*, namazi i tij konsiderohet i prishur, pavarësisht sa ka zgjatur e zbuluar pjesa e trupit, qoftë edhe më pak se të thuhet tri herë *subhanallah*.

¹⁰¹ Pjesë e turpshme.

4. **تَحْوِيلُ الصَّدْرِ عَنِ الْقِبْلَةِ** - **Largimi i gjoksit prej anës së kibles.** Nëse *musaliu* ndodhë që gjoksin e tij ta kthejë nga ndonjë anë tjetër duke u falur, namazi i tij konsiderohet i prishur dhe duhet përsëritur atë.

5. **أَلْكَالُ الْخَارِجِ عَنِ أَقْوَالِ الصَّلَاةِ** – **Të folurit në namaz.** Pavarsisht nëse *musaliu* flet nga harresa apo gabimisht, namazi i tij konsiderohet i prishur.

Në të folurit që e prish namazin bëjnë pjesë edhe këto veprime:

a. **التَّوَجُّعُ مِنْ أَلَمٍ أَوْ تَذَكُّرٌ مُصِيبَةٌ إِذَا نَطَقَ بِحَرْفَيْنِ** - Të shprehurit e dhimbjes apo të përkujtuarit e fatkeqësisë duke thënë qoftë edhe **ah, uh** e të ngjashme.

b. **تِلَاوَةُ الْقُرْآنِ بِقَصْدٍ مُخَاطَبَةِ الْغَيْرِ** – Të lexuarit e Kur'anit me qëllim që t'i flasë tjetrit si, f.v., të lexohet ajeti: (**أَدْخُلُوهَا**) (**بِسَلَامٍ آمِنِينَ**) “**Hyni në të me paqë dhe siguri**”, me qëllim që t'u jepet *selam* musafirëve etj.

6. **الْأَكْلُ وَالشُّرْبُ** - **Të ngrënit dhe pirja.** Nëse ndodhë që të gëlltitet një grimcë e ushqimit e mbetur mes dhëmbëve, qoftë edhe sa kokrra e bizeles, namazi konsiderohet i prishur; e nëse grimca e ushqimit është më e vogël se kokrra e bizeles namazi nuk priset, por, një veprim i tillë konsiderohet *mekruh*. Po ashtu nëse ndodhë që *musaliu* të kapërdijë ndonjë pikë uji apo ndonjë lloj pijeje, namazi i tillë është i prishur.

7. **الْعَمَلُ الْكَثِيرُ الْخَارِجُ عَنِ أَعْمَالِ الصَّلَاةِ** - **Të bërët e ndonjë veprimi të tepërt sa që tjetri konsideron se i tilli nuk është në namaz.** Nëse *musaliu* bën lëvizje të shumta në namaz sa që tjetrin e shtie të dyshojë nëse ky është në

namaz, në këtë rast, namazi konsiderohet i prishur dhe duhet përsëritur.

8. طُلُوعِ الشَّمْسِ وَهُوَ فِي صَلَاةِ الصُّبْحِ - **Të lindurit e diellit në kohën kur *musaliu* është duke e falur *farzin* e *sabahut*.** Kur ndodhë që të falet sabahu dhe duke u falur fillon të lindë dielli, namazi i tillë konsiderohet i prishur.

9. أَلْخَطَأُ الْفَاحِشُ فِي تِلَاوَةِ الْقُرْآنِ - **Leximi i Kur'anit gabimisht aq sa humb kuptimi i ajetit apo ndërrohet.**

10. الصَّحْكُ فِي الصَّلَاةِ - **Të qeshurit në namaz.** Me të qeshurit në namaz nënkuptohet kur *musaliu* e dëgjon veten që është duke qeshur por edhe ai që është afër e dëgjon. Në këtë rast namazi është i prishur dhe duhet përsëritur. Ndërsa, sa i përket buzëqeshjes namazi nuk priset.

11. اللَّهْتَهُةُ فِي الصَّلَاةِ - **Të qeshurit duke bërë haa...haa... në namaz.** Ky lloj i të qeshurit duke bërë haa...haa...e prish namazin po edhe *abdestin*.

12. قِرَاءَةٌ مَالًا يَحْفَظُهُ مِنَ الْقُرْآنِ مِنْ مُصْحَفٍ أَمَامَهُ - **Të lexuarit e asaj pjese të Kur'anit që nuk është mësuar përmendësh duke e pasur *mus'hafin* të hapur para vete.** Po që se *musaliu* deshiron ta zgjasë namazin dhe e vendos *mus'hafin* anash për të lexuar, në këtë rast, namazi konsiderohet i prishur, ngase namazi është *ibadet* e nuk është vend mësimi.

13. زِيَادَةُ رَكْعَةٍ فِي صَلَاةِ الْفَرَضِ فَقَطْ إِذَا كَانَ لَمْ يُؤَدِّ الْقُعُودُ الْأَخِيرُ - **Të shtuarit e *rekatit* vetëm në namazet *farze* nëse nuk ka qëndruar në uljen e fundit.** Nëse *musaliu* ka qëndruar

në uljen e fundit e pastaj është ngritur, namazi i tillë është i vlefshëm por duhet bërë *sehvi sexhde*¹⁰².

14. **مُحَاذَاةُ الرَّجُلِ صَبِيَّةٍ مُشْتَهَاةٍ أَوْ امْرَأَةٍ - Që mashkulli të falet krah për krah me femër e cila ka hyrë në moshën madhore, me gruan dhe me çdo femër, pavarësisht se ai i lejohet për t'u martuar apo jo.** F.v., namazi konsiderohet i prishur edhe nëse falemi krah për krah me nënën, motrën etj.

15. **لَا يَصِحُّ قَضَاءُ شَيْءٍ مِنَ الْفُرُوضِ الْفَائِتَةِ فِي أَوْقَاتِ كِرَاهَةِ التَّحْرِيمِ - Nuk është i vlefshëm namazi *farz* i bërë *kaza* në kohët kur është *mekruhi tahrimen* për t'u falur.**

ÇKA NUK E PRISH NAMAZIN

مَا لَا يُفْسِدُ الصَّلَاةَ

Namazin nuk e prish:

1. Kur kalimtari kalon në vendin e sexhdes, në këtë rast namazi i *musaliut* nuk priset, por kalimtari konsiderohet mëkatar.¹⁰³

2. Nëse e gëlltitë atë që i ka mbetur mes dhembëve e cila është më e vogël se kokrra e bizeles, por, pa përtypje të shumta.

3. Shikimi në diçka që është e shkruar dhe të cilën e kupton, por me kusht që të mos e shqiptojë.

MEKRUHET E NAMAZIT

¹⁰² Shih më hollësisht temën e cila flet për *sehvi sexhden*.

¹⁰³ Këtë e vërteton hadithi i Pejgamberit s.a.w.s.: لَسَوْ يَعْلَمُ الْمَارُّ بَيْنَ يَدَيْ الْمُصَلِّي مَاذَا عَلَيْهِ لَكَانَ أَنْ يَقِفَ أَرْبَعِينَ خَرِيفًا خَيْرًا لَهُ مِنْ أَنْ يَمُرَّ بَيْنَ يَدَيْهِ “Sikur ta dinte kalimtari (mëkatin) e kalimit para musaliut, do të ndalej dhe do të priste katërdhjetë vite, kjo do të ishte më mirë për të se sa të kalonte para tij”. (Transmeton Buhariu).

مَكْرُوهَاتُ الصَّلَاةِ

Mekruh në namaz është:

1. تَرْكُ وَاجِبٍ مِنْ وَاجِبَاتِ الصَّلَاةِ عَمْدًا - **Të lëshuarit e ndonjë *vaxhibi* në namaz, me qëllim.** Kur ndodhë që dikush ta lëshojë ndonjë *vaxhib* të namazit qëllimisht, konsiderohet mëkatar dhe nuk duhet bërë *sehvi sexhde* por duhet ta përsërisë namazin nëse ka kohë, e nëse kalon koha, namazi nuk duhet bërë *kaza*.
2. تَرْكُ سُنَّةٍ مِنْ سُنَنِ الصَّلَاةِ عَمْدًا - **Të lëshuarit e ndonjë *sunneti* të namazit me qëllim.** Nëse ndodhë që nga harresa të lëshohet ndonjë *sunnet* në namaz, në këtë rast lëshuarja e *sunnetit* nga harresa nuk konsiderohet *mekruh*.
3. الصَّلَاةُ مَعَ حَصْرِ بَوْلٍ أَوْ مَدَافَعَةٍ غَائِطٍ أَوْ رِيحٍ - **Të falurit e namazit duke e mbajtur nevojën e vogël, apo duke pasur presion prej nevojës së madhe ose gazrave.**
4. الصَّلَاةُ إِلَى نَارٍ أَوْ مَدَفَاةٍ فِيهَا نَارٌ - **Të falurit para zjarrit.**
5. الصَّلَاةُ إِلَى صُورَةٍ ذِي رُوحٍ إِنْسَانٍ أَمْ حَيْوَانٍ - **Të falurit para fotografisë së njeriut apo gjallesave që kanë shpirt.**
6. الصَّلَاةُ عَارِي الكِنْفَيْنِ أَوْ فِي ثِيَابٍ مُبْتَدَلَةٍ - **Të falurit duke i pasur supet e zbuluar, apo duke pasur të veshura rroba me të cilat nuk dëshirojmë të na shohin njerëzit¹⁰⁴.**
7. قِرَاءَةُ الْقُرْآنِ بِقَصْدٍ تَلَاوَةٍ فِي غَيْرِ الْقِيَامِ - **Të lexuarit e Kur'anit me qëllim të leximit përveç kur qëndrohet**

¹⁰⁴ Transmetohet nga Ibn Umeri r.a. se Pejgamberi s.a.w.s. ka thënë: (إِذَا صَلَّى أَحَدُكُمْ فَلْيَلْبَسْ ثَوْبَيْهِ فَإِنَّ اللَّهَ أَحَقُّ أَنْ يُرَى لَهُ رَوْبَاتُ عِيْنِهِ) ”Kur të falet dikush prej jush le t'i veshë rrobat e tij (më të mira) ngase Allahu është më meritori për t'u zbuluar para Tij”. (Transmeton Taberaniu).

në këmbë. Kur dikush lexon Kur'an në *ruku*, *sexhde*, ulje etj. më qëllim të leximit e jo për qëllim të *duasë*, një veprim i tillë konsiderohet *mekruh*.

8. تَغْمِيزُ الْعَيْنَيْنِ أَوْ رَفْعُ الْبَصَرِ إِلَى السَّمَاءِ – Të mbyllurit e syve¹⁰⁵ dhe të ngriturit lart kah qielli.

9. الصَّلَاةُ مَعَ حُضُورِ طَعَامٍ يَشْتَهِيهِ إِذَا كَانَ الْوَقْتُ مُتَسَعًّا. – Të falurit e namazit kur ushqimi është gati dhe *musaliu* është i uritur, me kusht që namazi të ketë kohë për tu falur.¹⁰⁶

10. الصَّلَاةُ مَعَ وَجُودِ مَا يَشْتَعْلُ الْبَالِ – Të falurit e namazit duke pasur diçka që të largojë vemenendjën në namaz. Si, f.v., ndonjë lojë; bisedë që ke dëshirë për ta degjuar; kur televizioni dhe radio janë të lëshuara dhe ta largojnë vëmendjen prej namazit etj.

11. قِرَاءَةُ الْقُرْآنِ عَكْسَ تَرْتِيبِ الْمَصْحَفِ – Të lexuarit e Kur'anit duke mos iu përmbajtur radhitjes së *Mus'hafit*. F.v. është *mekruh* të lexohet në *rekatin* e parë kaptina “el-Ihlas” e pastaj kaptina “el-Kevther”.

12. تَطْوِيلُ الرَّكَعَةِ الثَّانِيَةِ عَنِ الرَّكَعَةِ الْأُولَى – Të zgjaturit *rekatin* e dytë më tepër sesa *rekatin* e parë.

13. قِرَاءَةُ نَفْسِ السُّورَةِ فِي الرَّكَعَتَيْنِ فِي الْفَرْضِ – Të lexuarit e kaptinës së njejtë në të dy rekatet në namazet farze. F.v. të lexuarit e kaptinës “el-Kevther” në të dy *rekatet*.

¹⁰⁵ Transmetohet nga Ibn Abbasi r.a. se Pejgamberi s.a.w.s. ka thënë: (إِذَا قَامَ أَحَدُكُمْ فِي الصَّلَاةِ فَلَا يَغْمِزُ عَيْنَيْهِ) “Kur të ngrihet dikush prej jush për t'u falur mos t'i mbyllë sytë”. (Transmeton Taberaniu).

¹⁰⁶ Argument për këtë është fjala e Pejgamberit s.a.w.s. i cili ka thënë: (إِذَا قَامَ الْعَشَاءُ فَأَبْدُوا قَبْلَ أَنْ تُصَلُّوا الْمَغْرِبَ) “Kur darka është gati, hani darkën e pastaj faleni akshamin”.

Sa i përket leximit të kaptinës së njëjtë ne disa *rekate* në namazet *sunnete* nuk konsiderohet *mekruh*.

14. **تَهْلُكُ فِي الصَّلَاةِ فِي الْمَوَاطِنِ الَّتِي لَا تَتَنَاسَبُ مَعَ طَبِيعَةِ الصَّلَاةِ** – **Të falurit në ato vende që nuk i përshtaten natyrshmërisë së namazit.** Si psh. të falurit nëpër rrugë, vende të ndyta etj.

15. **كُلُّ فِعْلٍ يُعْتَبَرُ عَيْنًا** - **Çdo lëvizje e cila konsiderohet e panevojshme** si, f.v., të luajturit me rroba; me orë; me mjekër, mustaqe, flokë etj.

16. **التَّأْوُبُ فِي الصَّلَاةِ** - **Të hapurit e gojës në namaz.**¹⁰⁷

17. **رَدُّ السَّلَامِ بِالْيَدِ** - **Të kthyerit e selamit me dorë.**¹⁰⁸

18. **كُلُّ مَا يُتَافَى الْأَدَبِ** - **Çdo veprim jo i hijshëm.** Si, f.v., të kërsiturit e gishtave, të lëvizurit e qafës etj.

Shënim: Thënë shkurt çdo lëshuarje e *sunnetit* në namaz konsiderohet *mekruh*. Dijetarët e *fikhut* kanë përmendur më shumë se 70 *mekruhe* të namazit, ndërsa ne i kemi përmendur vetëm disa prej tyre.

ÇKA NUK ËSHTË MEKRUH NË NAMAZ

مَا لَا يُكْرَهُ فِي الصَّلَاةِ

Sipas mendimit të *fukahenjeve* nuk është *mekruh* veprimi i këtyre gjërave në namaz:

¹⁰⁷ Argument është hadithi: إِذَا تَسَاءَبَ أَحَدُكُمْ فَلْيُرِدْهُ مَا اسْتَطَاعَ وَلَا يَقُولُ هَاهُ... هَاهُ فَإِنَّمَا ذَلِكَ مِنْ الشَّيْطَانِ يَضْحَكُ مِنْهُ “Kur t’i hapet goja ndonjërit prej jush le të mundohet që të mos lejojë të hapet dhe mos të bëjë haa... haa, ngase të hapurit e gojës shkaktohet prej shejtanit, dhe se në këtë rast shejtanit qesh”. (Transmeton Buhariu, Muslimi, Tirmidhiu dhe Ebu Davudi).

¹⁰⁸ Argument për këtë është rasti i Pejgamberit s.a.w.s. i cili ishte duke u falur i kishin dhënë selam Ibn Mes’udi dhe Xhabiri r.a. e Pejgamberi s.a.w.s. nuk ua kishte kthyer selamin as me gjuhë e as me dorë.

(أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ لَمْ يَرُدَّ عَلَى جَابِرٍ وَابْنِ مَسْعُودٍ سَلَامَهُمَا عَلَيْهِ فِي الصَّلَاةِ يَدَهُ وَلَا بِلِسَانِهِ)

1. Po që se gjatë namazit *musaliut* i paraqitet nevoja për kruarje, por kruarja të mos jetë e tepruar.

2. Nuk është *mekruh* të bëhet *sexhde* në ndonjë *sexhade* ku ka fotografi.

3. Nëse gjatë namazit *musaliu* i kapë rrobat me dorë që të mos i ngjiten për trupi.

4. Nuk është *mekruh* që të falet namazin në ndonjë shtrojë, porse më prioritare është falja e namazit në tokë

5. Nuk është *mekruh* të shtrëngohet rrypi në brez apo mënjanimi i armës, por që të mos bëhet levizje e madhe në namaz.

PERDEJA NË NAMAZ

السُّتْرَةُ فِي الصَّلَاةِ

Mustehab është që *musaliu* të vendosë perde para vetës kur falet në ndonjë hapsirë apo ndërtesë ku ka mundësi të kalojë dikush duke u falur. Për atë se ka vlerë vendosja e kësaj perde në namaz, kemi argument hadithin e Pejgamberit s.a.w.s. :

(إِذَا صَلَّى أَحَدُكُمْ فَلْيُصَلِّ إِلَى سِتْرَةٍ وَ لِيُدْنُ مِنْهَا) “Kur të falet ndokush prej *jush*, le të falet duke e vendosur perden para vetes”¹⁰⁹.

Si perde (السُّتْرَةُ) vlen shkopi me gjatësi të një "kuti" (80 cm) trashësi përafërsisht sa gishti. Mu për këtë Pejgamberi s.a.w.s. thotë: (إِذَا صَلَّى أَحَدُكُمْ فَلْيَجْعَلْ تَلْقَاءَ وَجْهِهِ شَيْئًا) فَإِنْ لَمْ يَجِدْ فَلْيَنْصِبْ عَصًا فَإِنْ لَمْ يَكُنْ مَعَهُ عَصًا فَلْيَحِطْ حِطًّا ثُمَّ لَا يَضُرُّ مَنْ مَرَّ بَيْنَ يَدَيْهِ) “Kur të falet ndonjëri prej *jush* le të vendosë diçka para vetes, nëse nuk gjenë asgjë, le të vendosë një

¹⁰⁹ Transmeton Ibn Maxhe dhe Ebu Davudi.

*shkop, e nësë nuk ka shkop, le ta vëjë një pe, e pastaj kush të kalojë para tij nuk i pengon asgjë (për namaz).*¹¹⁰

Sunnet është që *musaliu* të qëndrojë në afërsi të perdes, e cila do t'i bjerë në anën e një vetulle e jo ndërmjet të dyjave. Nëse i gjithë *xhemati* falen në fushë, mjafton perdeja vetëm para *imamit*.

Musaliu, i cili është duke u falur, atë që rastësisht kalon para tij, të mos e kthejë prapa edhe pse i lejohet një veprim i tillë. Kur *musaliu* mendon të pengojë dikë që të mos i kalojë përpara, mund ta ndalë me dorë ose duke thënë me zë fjalën *subhanallah* ose duke lexuar Kur'an me zë të lartë. Femra ua tërheq vërejtjen duke i rënë me dorën e djathtë dorës së majtë.

Kur ndodh që ndokush doemos duhet të kalojë para atij që është duke u falur, duhet të vendosë diçka si perde para *musaliut* e pastaj të kalojë.

KUR DUHET TË NDËRPREHET NAMAZI DOEMOS

مَتَى يَكُونُ قَطْعُ الصَّلَاةِ وَاجِبًا

Namazi ka vlerë dhe gradë të madhe tek Allahu xh.sh. dhe nuk duhet të ndërpritet pa ndonjë arsye të justifikueshme, por, nganjëherë, ndodhë që duhet të ndërpritet. Kur ndodh që namazi duhet të ndërpritet duhet të jepet *selam*, por sipas nevojës ka mundësi të ndërpritet edhe pa *selam*. Rastet kur namazi doemos duhet të ndërpritet janë:

¹¹⁰ Transmeton Ahmedi.

1. Kur kërkohet ndihmë e shpejtë për të shpëtuar dikë nga rreziku, si f.v. kur dikush po mbytet në ujë etj. Namazi duhet të përsëritet prej fillimit.

2. Për të penguar zjarrin që të mos vijë deri të djegia e shtëpisë e të ngjashme.

3. Për të penguar çdo gjë të dëmshme.

Në disa raste lejohet të priset namazi, por nuk kërkohet doemos të ndërpritet. Këto raste janë:

1. Për të penguar vjedhjen, si f.v. nëse dikush tenton t'i vjedhë këpucet e *musaliut* apo dikujt tjetër, atëherë në këtë rast lejohet të priset namazi.

2. Nëse amvisja ka frikë se po i digjet ushqimi apo ka frikë se nëse gjella derdhet do ta dëmtojë fëmijën etj.

3. Për shkak të presionit të nevojës fiziologjike qoftë e madhja apo e vogla.

4. Nëse është nevoja për ta mbytur ndonjë gjallesë që sjell dëm si, f.v. gjarpërin, akrepin etj.

5. Kur ndodhë që ndonjëri prej prindërve e thërret *musaliun*, lejohet të ndërpritet namazi *sunnat*, po që se prindi nuk e di se fëmija i tij është në namaz, ndërsa në këtë rast *farzi* nuk ndërpritet.

DISA RREGULLA TË VEÇANTA PËR FEMRËN NË NAMAZ

Edhe femra në namaz duhet të veprojë sikur mashkulli, por dallon me disa forma të veprimit. Ato dallime janë:

1. Femra kur t'i ngrejë duart në *tekbirin* fillestar nuk i ngre sikur mashkulli deri tek veshët, por i ngre deri te supet dhe gishtat i mbanë të mbledhur mes vete, e jo si mashkulli që i mbanë të hapur.

2. Femra kur t'i lidhë duart duke qenë në këmbë i vendos mbi gjoks në mënyrë që dora e djathtë të jetë mbi të majtën dhe e mbajtur rrafsh njëra mbi tjetrën.

3. Femra kur të shkojë në *ruku* nuk vepron si mashkulli, shpinën nuk e drejton rrafsh, por e mbanë pak a shumë të pjerrtë e jo horizontale sikur mashkulli.

4. Femra kur të bëjë *sexhde* duhet të jetë sa më e strukur dhe gjunjë dhe barkun duhet t'i bashkojë.

5. Kur të qëndrojë ulur, femra duhet këmbët t'i kthejë nga ana e djathtë.

Shënim: Të gjitha këto veprime konsiderohen të preferueshme për t'u zbatuar nga ana e femrës po edhe nëse nuk zbatohen, namazi konsiderohet i kryer.

SEHVI SEXHDEJA

سُجُودُ السَّهْوِ

Sehvi sexhdeja (sexhdeja e harresës) në terminologjinë e *fikhut* nënkupton *sexhden* kur *musaliu* nga harresa lëshon, vonon, ose kryen para kohe ndonjë *vaxhib* të namazit dhe, po ashtu, nëse e vonon apo e kryen më herët ndonjë *rukun* të namazit. Në këtë rast në uljen e fundit, pasi të këndohet *teshehudi*, jepet *selam* nga ana e djathtë pastaj, të shkohet dy herë në *sexhde*

dhe qendrojmë ulur derisa t'i lexojmë të gjitha ato që duhet të lexohen dhe pastaj japim *selam*.

Norma e *sehvi sexhdes* është *vaxhib* për t'u zbatuar. *Sehvi sexhdeja* është e ligjësuar për të bërë plotësimin e mangësive në namaz në mënyrë që të mos përsëritet namazi. Obligueshmeria e zbatimit të *sehvi sexhdes* vlen si për imamin ashtu edhe për xhematin. Po që se ndodhë që xhemati ta arrijë imamin duke bërë *sehvi sexhden* dhe, më pastaj, lidhen pas tij, në këtë rast xhemati nuk e ka obligim zbatimin e *sehvi sexhdes*. E nëse ndodh që gjatë faljes së xhematit me imam të paraqitet nevoja për *sehvi sexhde*, atëherë xhemati e ka obligim t'i bashkangjitet imamit në zbatimin e *sehvi sexhdes*, pa marrë parasysh nëse xhemati janë *mudrik*¹¹¹ apo *mesbuk*¹¹² madje edhe nëse janë pas imamit pas harresës së tij.

Shkaqet që e shkaktojnë *sehvi sexhden* janë:

1. إِذَا سَهَا الْمُصَلِّيُّ أَوْ سَبَقَهُ لِسَانُهُ فَقَرَأَ السُّورَةَ قَبْلَ الْفَاتِحَةِ – **Kur musaliu harron ose gabimisht e lexon suren para fatihasë.** Po që se *musaliu* ka lexuar suren apo ajetin para *fatihasë*, e mandaj e ka lexuar *fatihanë* por prapë e ka përsërit leximin e sures apo ajetit, në këtë rast nuk duhet bërë *sehvi sexhde*. E nëse nuk e ka përsëritur leximin e *sures* apo *ajetit* pas *fatihasë* në këtë rast duhet bërë *sehvi sexhde* ngase leximi i *fatihasë* para *sures* është *vaxhib*, e lëshuarja e *vaxhibit* shkakton *sehvi sexhden*.

¹¹¹ *Mudrik* konsiderohet ai person i cili e ka arritur namazin prej fillimit.

¹¹² *Mesbuk* konsiderohet ai person që është vonuar në namaz dhe nuk e ka arritur imamin prej fillimit të namazit.

2. إِذَا قَرَأَ الْمُصَلِّيُّ السُّورَةَ وَ سَهَا عَنِ الْفَاتِحَةِ أَوْ قَرَأَ الْفَاتِحَةَ وَ سَهَا عَنِ السُّورَةِ – **Kur musaliu lexon suren dhe harron për ta lexuar fatihanë, apo anasjelltas, lexon fatihanë por harron të lexojë suren.** I tilli duhet të bëjë *sehvi sexhde* për të kompensuar atë që ka harruar ta lexojë.

3. إِذَا سَهَا الْمُصَلِّيُّ فَخَرَّ إِلَى السُّجُودِ دُونَ أَنْ يَرُكَعَ. – **Kur musaliu harron dhe bie në sexhde pa bërë ruku.** Nëse ndodhë që pasi ketë shkuar në *sexhde* i kujtohet se nuk ka bërë *ruku*, menjëherë duhet të ngrihet në këmbë, të bëjë *ruku*, e pastaj *sexhden*. Në këtë rast *rekati* është i kryer por duhet bërë *sehvi sexhde*. Nëse ndodhë që kur të ngrihet në *rekatin* më radhë i kujtohet se nuk ka bërë *ruku* i tilli në këtë rast duhet ta përsërisë *rekatin* dhe duhet të bëjë *sehvi sexhde*.

4. إِذَا قَامَ الْمُصَلِّيُّ إِلَى الرَّكْعَةِ الثَّلَاثَةِ سَاهِيًا عَنِ الْقُعُودِ الْأَوَّلِ. – **Kur musaliu, nga harresa, ngrihet në rekatin e tretë pa qëndruar në uljen e parë.** Nëse *musaliut* i kujtohet, i tilli mund të kthehet dhe të qëndrojë ulur me kusht që të jetë më afër uljes sesa ngritjes, e në këtë rast qëndron ulur dhe nuk duhet të bëjë *sehvi sexhde*, e nëse i kujtohet kur ngritja e tij është më afër qëndrimit në këmbë, në këtë rast duhet vazhdojë *rekatin* e tretë dhe në fund duhet të bëjë *sehvi sexhde*.

5. إِذَا قَعَدَ الْمُصَلِّيُّ الْقُعُودَ الْأَوَّلَ وَ سَهَا عَنِ قِرَاءَةِ التَّشْهِيدِ حَتَّى قَامَ إِلَى الرَّكْعَةِ الثَّلَاثَةِ – **Kur musaliu ulet në uljen e parë por harron të lexojë teshehudin dhe ngrihet në rekatin e tretë.** Në këtë rast *musaliu* vazhdon *rekatin* e tretë dhe në fund e bën *sehvi sexhden*.

6. إِذَا قَعَدَ الْمُصَلِّيُّ فِي نِهَائِيَةِ الرَّكْعَةِ الثَّلَاثَةِ وَهُوَ يَظُنُّ أَنَّهُ فِي الرَّكْعَةِ الرَّابِعَةِ

Kur musaliu ulet në rekatin e tretë duke menduar se është në rekatin e katërt. Në këtë rast, kur musaliut t'i kujtohet se është ulur gabimisht, ai duhet të ngrihet menjëherë, e nëse është ndalur sa ka qenë ulur dhe ka qendruar më pak sesa të thuhet tri herë *subhanallah*, nuk duhet të bëjë *sehvi sexhde*, e nëse ka qëndruar më tepër se sa të thuhet tri herë *subhanallah* duhet të vazhdojë *rekatin* e katërt dhe të bëjë *sehvi sexhde*.

7. إِذَا سَلَّمَ الْمُصَلِّيُّ خَاتِمًا صَلَاةَ الْفَرَضِ

Kur musaliu jep selam duke menduar se e ka përfunduar namazin farz. Kur ndodhë kjo dhe ende pa folur asgjë që e prish namazin, pa e leshuar vendin dhe pa e larguar gjoksin prej *kibles*, i tilli duhet ta vazhdojë namazin dhe në fund të bëjë *sehvi sexhde*.

8. إِذَا سَهَا الْمُصَلِّيُّ فَسَجَدَ فِي إِحْدَى الرَّكْعَاتِ سَجْدَةً وَاحِدَةً

Kur ndodhë që musaliu të harrojë dhe në ndonjërin prej rekateve e bën vetëm një *sexhde* e jo dy *sexhde* si kërkohet. Në këtë rast *musaliu* duhet ta vazhdojë namazin, por, më kusht që në fund të namazit të bëjë *sexhden kaza*, e pastaj të japë *selam* dhe të bëjë *sehvi sexhden*.

9. إِذَا سَهَا الْمُصَلِّيُّ فَسَجَدَ ثَلَاثًا أَوْ رَكْعَ مَرَّتَيْنِ

Kur ndodhë që musaliu të harrojë dhe t'i bëjë tri *sexhde*, ose t'i bëjë dy *ruku*. Në këtë rast duhet të bëhet *sehvi sexhde*.

10. إِذَا شَكَّ الْمُصَلِّيُّ فِي صَلَاتِهِ فَلَمْ يَدْرِ كَمْ صَلَّى

Kur ndodhë që musaliu dyshon në vete dhe nuk e di se sa *rekate* i ka falur. Në këtë rast do të veprojë sipas asaj kah i anon mendja më shumë, f.v., nëse ia merr mendja se i ka

falur tri *rekate* dhe duhet ta plotësojë edhe një, vepron kështu, por në fund duhet të bëjë *sehvi sexhde*.

11. إِذَا شَكَّ الْمُصَلِّي فِي صَلَاتِهِ وَأَطَالَ التَّفَكِيرَ مَقْدَارَ أَدَاءِ رُكْنٍ - Nëse **musaliu** dyshon dhe të menduarit e tij zgjat sa që është e mundur të kryhet një *rukun*, ai duhet të bëjë *sehvi sexhde*.

12. إِذَا قَامَ سَاهِيًا إِلَى رُكْعَةٍ زَائِدَةٍ عَنِ صَلَاتِهِ - Kur ndodhë që **musaliu** nga harresa ngrihet dhe e shton një *rekate* në namaz. Nëse i ndodhë kjo *musaliut*, atëherë, nëse i kujtohet, duke qëndruar në këmbë apo edhe në *ruku* pa e bërë *sexhden* në *rekatin* e shtuar, i tilli duhet të ulet dhe të bëjë *sehvi sexhde*.

Shënim: Kur ndodhë që *musaliu* duke falur namaz *farz* pasi ka qëndruar në uljen e fundit, pavarësisht se namazi a është dy *rekate*, tre apo katër *rekate*, i tilli i ka dy mundësi:

a. të kryejë *rekatin* e tepërt dhe në fund të bëjë *sehvi sexhde*,

b. të kryejë edhe dy *rekate*, në mënyrë që katër *rekate* e parë të jenë *farz* ndërsa dy të fundit *nafile* dhe të bëjë *sehvi sexhde*.

Po që se ndodhë që nuk ka qëndruar fare në uljen e fundit, namazi *farz* duhet të përsëritet, por është mirë që të kryhen edhe dy *rekate* dhe këto *rekate* të falura konsiderohen *nafile*.

13. إِذَا سَهَا الْمُصَلِّي فَلَمْ يَقْنُتْ فِي الْوُثْرِ حَتَّى رَكَعَ - Kur **musaliu** harron të bëjë *kunut* në namazin e vitrit she ka shkuar në *ruku*. Kur të ngrihet *musaliu* prej *rukusë* nuk duhet të bëjë *kunut*, por duhet të bëjë *sehvi sexhde*.

14. إِذَا سَهَا الْمُصَلِّيُّ أَكْثَرَ مِنْ مَرَّةٍ فِي الصَّلَاةِ الْوَاحِدَةِ - **Kur musaliu harron më shumë se një herë në namaz.**

Shënim: Nëse ndodhë që *musaliu* nga harresa të lexojë më zë në namazet që falen pa zë ose anasjelltas, nuk duhet të bëjë *sehvi sexhde*.

SEHVI SEXHDEJA NË NAMAZIN ME XHEMAT

1. Kur ndodhë që imami të harrojë në namaz, *musaliu* mund t'ia tërheq vërjetjen duke thënë “**subhanallah**”, e nëse imami nuk e vëren vërejtjen *musaliu* duhet ta ndjekë imamin, pavarësisht prej gabimit që është duke e bërë imami. Në këtë rast imami duhet të bëjë *sehvi sexhde*, po që se gabimi e shkakton *sehvi sexhden*.

2. Kur imami harron dhe lexon më zë në namazet pa zë apo anasjelltas, lexon pa zë në namazet që lexohet më zë, imami duhet të bëjë *sehvi sexhde*.

3. Kur të bëjë imami *sehvi sexhde* edhe *musaliu* duhet të bëjë, pavarësisht nëse ka vërejtur gabimin e imamit apo jo, po ashtu, nëse *musaliu* është *mesbuk*, duhet ta ndjekë imamin në *sehvi sexhde* po që se ka gabuar imami edhe në ato *rekate* të cilat nuk i ka falur me imamin.

4. Nëse ndodhë që *muktediu* të gabojë kur është duke u falur pas imamit, në këtë rast *muktediu* nuk duhet të bëjë *sehvi sexhde*.

5. Po që se ndodhë që imami të ketë bërë ndonjë gabim për të cilin duhet bërë *sehvi sexhde* gjatë namazit të xhumasë, bajrameve dhe namazeve të ngjashme ku ka shumë xhemat, në këtë rast, ai nuk do të bëjë *sehvi*

sexhde vetëm e vetëm që të mos shkaktohet huti në xhemat.

SEXHDETU TILAVETI- Sexhdeja e leximit

سَجْدَةُ التَّلَاوَةِ

Sexhdu tilaveti është ajo *sexhde* e cila zbatohet kur lexohet apo dëgjohej ajeti i *sexhdes*. Zbatimi i *sexhdes* së tillë është *vaxhib*. *Sexhden* e tillë duhet zbatuar doemos ai që e lexon ajetin e *sexhdes* apo e degjon. Veprimi i *sexhdetu tilavetit* ka bazë në *hadithin* e Pejgamberit s.a.w.s. të transmetuar nga Ibn Umeri r.a. i cili ka thënë: (كَانَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقْرَأُ الْقُرْآنَ فَيَقْرَأُ سُورَةَ فِيهَا) ... (سَجْدَةٌ فَيَسْجُدُ وَنَسْجُدُ مَعَهُ ... “Pejgamberi s.a.w.s. duke lexuar *Kur'an*, kishte lexuar kaptinën në të cilin kishte *sexhde*, me ç'rast bëri *sexhde* e edhe ne bëmë *sexhde* me atë...”¹¹³

Mënyra e zbatimit të *sexhde* tilavetit

Personi i cili duhet të bëjë këtë *sexhde* duhet të kthehet nga *kibla* të marrë *tekbir*, pa i ngritur duart, pastaj të bjen në *sexhde* dhe e lartësojn Allahun tri herë (*tesbih*) e pastaj duke thënë *Allahu Ekber* e kryen *sexhden* e tillë.

Ruken i kësaj *sexhdeje* është të vendosurit e ballit në tokë, ndërsa dy *tekbiret* dhe *tesbihi* janë *sunnat*. *Sexhdeja* e tillë mund të zbatohet edhe duke qenë ulur,

¹¹³ Tranmseton Buhariu dhe Muslimi

por më mirë është që të ngrihemi e pastaj të bijmë në *sexhde*.

Mënyra e zbatimit të sexhdetu tilavetit në namaz

Kur ndodhë që ajeti në të cilin ka *sexhde* të lexohet në namaz, qoftë namazi më zë apo pa zë, duhet të kryhet *sexhdeja* e tillë. Kur ndodhë që të lexohet ajeti i *sexhdes* në namaz menjëherë pas *fatihasë* dhe musaliu mendon të lexojë ende pas ajetit të *sexhdes*, duhet të shkojë menjëherë në *sexhde*, pa shkuar fare në *ruku*, që ta kryejë *sexhden* e leximit, e pastaj të ngrihet dhe ta vazhdojë leximin dhe ta kryejë *rekatin* normal. Po nëse ndodhë që ajeti i *sexhdes* të jetë ajeti me të cilin mendon të përfundojë *musaliu* leximin në namaz, në këtë rast ai ben *ruku* dhe *sexhde* normale dhe me kryerjen e *rekatit* kryhet edhe *sexhdeja* e leximit.

Disa rregulla që kanë të bëjnë me sexhden e leximit

1. *Sexhdeja* e leximit është obligim për secilin që e ka detyrim faljen namazit. Kjo *sexhde* nuk është obligim të zbatohet nga fëmija, gruaja me menstruacine (*hajz*) dhe në kohën e lehonisë (*nifas*).

2. Për zbatimin e kësaj *sexhdeje* janë të obliguar si lexuesi ashtu edhe dëgjuesi, pavarësisht nëse dëgjuesi e ka pasur për qëllim dëgjimin e ajetit apo jo.

3. Kur ndodhë që lexuesi, të lexojë disa herë të njëjtin ajet në të njëjtin vend, ai duhet të bëjë vetëm një herë *sexhde*. E nëse ndodhë që të njëjtin ajet ta lexojë në disa vende, atëherë duhet bërë *sexhde* sa herë që është lexuar ajeti.

4. Po që se ndodhë që ajetin e *sexhdes* e lexojnë vetëm me sy ose, e mendon por nuk e shqipton me gjuhë, në këtë rast nuk kërkohet zbatimi i *sexhdes*.

5. Kur ndodhë që *ajeti* i *sexhdes* të lexohet jashtë namazit, kryerja e kësaj *sexhdeje* mund të shtyhet për më vonë, por, më mirë është që ajo të zbatohet menjëherë.

6. Nëse ndodhë që *sexhdeja* e tillë të bëhet obligim për t'u kryer në namaz, atëherë, duhet doemos të zbatohet në të njejtin namaz, pa marrë parasyshë se në këtë namaz lexohet pa zë apo më zë.

Ajetet në të cilat duhet të bëhet sexhde

Sexhdetu tilaveti kërkohet të bëhet në katërmbledhjetë vende në Kur'an:

1. إِنَّ الَّذِينَ عِنْدَ رَبِّكَ لَا يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِهِ وَيُسَبِّحُونَهُ وَلَهُ يَسْجُدُونَ
Kaptina El-A'raf, ajeti : 206
2. وَلِلَّهِ يَسْجُدُ مَنْ فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ طَوْعًا وَكَرْهًا وَظِلَالُهُم بِالْعُدْوِ
Kaptina Err-Rr'ad, ajeti: 15.
3. وَلِلَّهِ يَسْجُدُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ مِنْ دَابَّةٍ وَالْمَلَائِكَةُ وَهُمْ لَا يَسْتَكْبِرُونَ
Kaptina En-Nahl, ajeti : 49
4. قُلْ آمَنُوا بِهِ أَوْ لَا تُؤْمِنُوا إِنَّ الَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ مِنْ قَبْلِهِ إِذَا يُتْلَى عَلَيْهِمْ يَخِرُّونَ
Kaptina el-Isra, ajeti: 107
5. إِذَا تُتْلَى عَلَيْهِمْ آيَاتُ الرَّحْمَنِ خَرُّوا سُجَّدًا وَبُكِيًّا
6. وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ اسْجُدُوا لِلرَّحْمَانِ قَالُوا وَمَا الرَّحْمَانُ أَنَسْجُدُ لِمَا تَأْمُرُنَا وَزَادَهُمْ
Kaptina el-Furkan, ajeti: 60
7. أَلَا يَسْجُدُوا لِلَّهِ الَّذِي يُخْرِجُ الْخَبَاءَ فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَيَعْلَمُ مَا تُخْفُونَ
Kaptina en-Neml, ajeti: 25.
8. إِنَّمَا يُؤْمِنُ بِآيَاتِنَا الَّذِينَ إِذَا ذُكِرُوا بِهَا خَرُّوا سُجَّدًا وَسَبَّحُوا بِحَمْدِ رَبِّهِمْ وَهُمْ لَا يَسْتَكْبِرُونَ
Kaptina es-Sexhdetu, ajeti: 15)

9. وَظَنَّ دَاوُودُ أَنَّمَا فَتَنَّاهُ فَاسْتَغْفَرَ رَبَّهُ وَخَرَّ رَاكِعًا وَأَنَابَ Kaptina Sad,
ajeti: 24
10. فَاسْجُدُوا لِلَّهِ وَاعْبُدُوا Kaptina en-Nexhm, ajeti: 62.
11. وَإِذَا قُرِئَ عَلَيْهِمُ الْقُرْآنُ لَا يَسْجُدُونَ Kaptina el-Inshikak,
ajeti: 21
12. كَلَّا لَا تُطِيعُهُ وَاسْجُدْ وَاقْتَرِبْ Kaptina el-Alek, ajeti: 19.
13. أَلَمْ تَرَ أَنَّ اللَّهَ يَسْجُدُ لَهُ مَنْ فِي السَّمَاوَاتِ... Kaptina el-Haxh,
ajeti: 18
14. لَا تَسْجُدُوا لِلشَّمْسِ وَلَا لِلْقَمَرِ وَاسْجُدُوا لِلَّهِ... Kaptina
Fussilet: 37

NAMAZI I VITRIT

صَلَاةُ الْوَيْتْرِ

Namazi i *vitrit* është *vaxhib*, dhe si i tillë duhet falur gjithësesi. Nëse *musaliut* ky namaz i kaoln pa falur, duhet bërë *kaza*. Koha e këtij namazi është menjëherë pas faljes së namazit të jacisë dhe zgjatë deri në kohën e sabahut. Namazi i vitrit ka gjithsej tri *rekate*, por, në *rekatin* e tretë pas leximit të *fatihasë* dhe *suress*, duhet të ngrihen duart sikur në fillim të namazit dhe pastaj të lidhen dhe të lexohet duaja e *kunutit*. Të bërit

kunut është *vaxhib* pavarësisht se çfarë duaje këndohet, ndërsa leximi i duas është *sunnet*, e kjo dua është :

اللَّهُمَّ إِنَّا نَسْتَعِينُكَ وَنَسْتَغْفِرُكَ وَنَسْتَهْدِيكَ وَنُؤْمِنُ بِكَ وَنُتُوبُ إِلَيْكَ وَنَتَوَكَّلُ
عَلَيْكَ وَنُشِي عَالِيكَ الْخَيْرَ كُلَّهُ نَشْكُرُكَ وَلَا نَكْفُرُكَ وَنَخْلَعُ وَنَتْرُكُ مَنْ
يَفْجُرُكَ. اللَّهُمَّ يَاكَ نَعْبُدُ وَ لَكَ نُصَلِّي وَ نَسْجُدُ وَ إِلَيْكَ نَسْعَى وَ نَحْفِدُ نَرْجُو رَحْمَتَكَ
وَ نَخْشَى عَذَابَكَ إِنَّ عَذَابَكَ بِالْكَفَّارِ مُلْحِقٌ

Musaliu, namazin e vitrit e falë vetmas, përveç në muajin e ramazanit, nëse e falë namazin e *teravisë*, atëherë ky namaz falet me imam dhe në këtë namaz se imami këndon më zë *fatihanë* dhe *suren* në të tre *rekatet*, ndërsa duanë e këndon pa zë, në heshtje.

TË ARRITURIT E FARZIT ME IMAMIN

ادْرَاكَ الْفَرِيضَةِ مَعَ الْإِمَامِ

Kur ndodhë që *musaliu* fillon të falë namazin *farz* vetmas apo të falë *farz kaza*, e pastaj formohet xhemati, i tilli duhet t'i bashkangjitet xhematit. Bashkangjitja e xhematit mund të bëhet kështu: nëse që *musaliu* ka filluar namazin e sabahut është në *rekatin* e parë duhet ta nderpresë namazin me një *selam* dhe t'i bashkohet xhematit madje edhe nëse ka rënë në *sexhden* e rekatit të parë; po ashtu, nëse ndodhë që *musaliu* është në *rekatin* e dytë të sabahut apo të akshamit por, ende nuk ka rënë në *sexhde*, i tilli duhet ta ndërpresë namazin dhe t'i bashkohet xhematit, e nëse ndodhë që *musaliu* ta ketë kryer qëndrimin në *sexhde* në *rekatin* e dytë i tilli duhet të plotësojë namazin deri në fund pa e ndërprerë.

Kur ndodhë që *musaliu* është duke falur vetmas *farzin* katër *rekatësh* dhe pastaj formohet xhemati, në këtë rast po që se *musaliu* është në *rekatin* e parë, por,

para se të bjerë në *sexhde*, i tilli duhet ta ndërpresë namazin dhe t'i bashkohet xhematit, e nëse *musaliu* e ka kryer *sexhden* në *rekatin* e parë i tilli në këtë rast do ta kryejë edhe *rekatin* e dytë e pastaj do t'i bashkangjitet xhematit. Këto dy *rekate* që i ka falur *musaliu* konsiderohen *nafile*. Nëse *musaliu* është në *rekatin* e tretë para se të shkojë në *sexhde*, ai duhet ta ndërpresë namazin dhe t'i bashkohet xhematit. Kur ndodhë që të formohet xhemati e *musaliu* është në *rekatin* e tretë të akshamit, apo në *rekatin* e katërt në namazet katër *rekateësh*, *musaliu* në këtë rast do ta plotësojë namazin deri në fund, e pastaj mund t'i bashkohet xhematit për të falur namaz *nafile*.

Sa i përketë faktit se kur duhet të bëhet *ikamet* për *farzin* e sabahut, *musaliu* mund të falë *sunnetin* e sabahut nëse ia merr mendja se mund ta arrijë xhematin, e nëse mendon se nuk mund ta arrijë xhematin, atëherë duhet t'i bashkohet xhematit, ndërsa *sunnetin* duhet falur pas lindjes së diellit. Nëse ndodhë që *musaliu* ta ketë ka falur *farzin* e drekës më xhemat, lejohet që pas *farzit* t'i falë katër *rekatet* e para *sunnet* të drekës e pastaj t'i falë dy *rekate sunnet*.

Kur *musaliu* fillon të falë *sunnetin* e xhumasë dhe *hatibi* hyp në *hutbe*, ose *musaliu* ka filluar të falë *sunnetin* e parë të drekës, në këtë rast *musaliu* duhet t'i falë vetëm dy *rekatet* e parë dhe të japë *selam*.

NAMAZET KAZA

قَضَاءُ الْفَوَائِتِ

Zbatimi i namazit me kohë në shkencën e *fikhut* njihet si (الأداء), namazi që nuk falet me kohë quhet (الغائبة)

), ndërsa falja e namazit pas kohës së duhur quhet *kaza* (قضاء). *Musaliut* të cilit i ka kaluar ndonjë namaz *farz* apo *vaxhib* duhet bërë *kaza*, por gjithashtu duhet kërkuar falje nga Allahu xh.sh. pse është vonuar zbatimi i obligimit me kohë.

Arsyet të cilat lejojnë që namazi të falet më vonë

Rastet kur *musaliu* ka të drejtë për të vonuar faljen e ndonjë namazi dhe që të mos konsiderohet mëkatar janë:

1. Arsyet të cilat shkaktohen jo nga vullneti i *musaliut* si, f.v., gjumi, alivanosja, harresa etj.
2. Arsyet që shkaktohen jo nga vullneti por janë të natyrshme, si f.v., sëmundja e papritur, luftimet në luftë, operimi i domosdoshëm nga ana e mjekut etj.

Arsyet që namazi të mos jetë obligim për shkak të çmendurisë, alivanosjes dhe dobësimit fizik

Nëse *musaliun* e ka goditur çmenduria apo alivanosja dhe të ngjashme; dhe kjo gjendje zgjatë aq sa të kalojnë gjashtë kohë të namazit, i tilli kur të përmendet nuk duhet bërë *kaza* namazet që i kanë mbetur pa falur gjatë kësaj gjendje. E nëse ndodhë që gjatë kësaj gjendje *musaliut* t'i kalojnë pesë kohë a më pak, i tilli kur të përmendet duhet t'i bëjë *kaza* namazet e tilla.

Shënim:

Nëse ndodhë që njeriu ta humbë vetëdijen me gjëra të ndaluara, siç është alkooli, ai obligohet me *kaza*. Po ashtu është obligim falja e namazit *kaza* për atë që nuk është në gjendje të mirë psikike si pasojë e barërave të lejuara. Gjithashtu femra nuk obligohet për t'i bërë *kaza* namazet e mbetura për shkak të menstruacioneve (*hajz*) dhe gjakderdhjes së lehonisë (*nifas*). *Kaza* nuk kërkohet të bëhet namazi edhe nga personi i cili është bërë renegat (*murted*) ngase i tilli e merr normën e atij që konsiderohet pabesimtarë (*kafir*).

Namazet të cilat duhet të bëhen kaza

Namazet që duhet të bëhen *kaza* janë pesë kohët e namazit, namazi i *vitrit* dhe namazet që *musaliu* ia ka bërë obligim vetes duke bërë besatim (*nedher*).

Ai që ka qenë duke falur namaze *nafile* dhe për një moment e ka prishur, e ka *vaxhib* për ta bërë *kaza*. Namazet *sunnete* nuk bëhen *kaza*, përveç *sunnetit* të sabahut i cili ka mundësi të bëhet *kaza* nëse dëshiron *musaliu*.

Namazi i bajrameve dhe i *xhenazes* nuk bëhet *kaza*.

Si dhe kur bëhen kaza namazet

Namazi i cili ka kaluar pa u falur duhet të bëhet *kaza*, f.v., nëse *musaliut* i kalon pa e falur ndonjë namaz duke qenë udhëtar duhet ta e bëjë *kaza* si namaz i udhëtarit edhe nëse është vendas-*mukim*, apo anasjelltas. Namazet *kaza* lejohet të falen në cilën do kohë, përveç në kohët kur të falurit është *mekruhi*

tahrimen, në të cilat kohë nuk lejohet të bëhet *kaza* asnjë namaz.

Sahibu tertibi dhe të bërit kaza

Sahibi tertib konsiderohet ai person i cili e ka falur vazhdimisht namazin qysh prej kohës kur i është bërë obligim namazi. Të tillit, kur i ndodhë që ndonjë namaz t'i ketë kaluar pa e falur, kur të bëjë *kaza*, duhet falur namazin që ka kaluar, e pastaj namazin e kohës.

Sahibi tertibi e humb *tertibin* në namaz për këto shkaqe:

1. Po që se namazet të cilat i kanë kaluar pa i falë janë gjashtë namaze njëra pas tjetrës. Si psh. i ka mbetur pa e falur sabahu, dreka, ikindia, akshami, jacia dhe sabahu.

2. Nëse harron të falë namazin e pa falur para namazit të cili i ka hyrë koha, si f.v., i ka mbetur pa falur dreka, dhe ky duke harruar se nuk e ka falur drekën, e falë ikindinë, atëherë në këtë rast e humb të drejtën e *tertibit*.

3. Kur i ngushtohet koha për t'i bërë *kaza* namazet e mbetura, para se të hyjë koha e namazit *eda*.

Shënim: Personi i cili nuk është *sahibi tertib* kur të bëjë *kaza* namazin e pa falur, duhet që së pari të falë njëherë namazin e kohës e pastaj namazin e mbetur, si p.sh., nëse i ka kaluar namazi i drekës dhe ka hyrë koha e ikindisë, ai së pari duhet falur ikindinë e pastaj namazin e drekës. Ky rregull nuk vlen për atë që është *sahibi tertib*.

Të bërit kaza ato namaze kur nuk u dihet numri

Atij personi të cilit i kanë mbetur shumë namaze pa i falur dhe nuk është në gjendje ta përcaktojë numrin e namazeve të mbetura, obligohet që të falë *kaza* derisa të bindet se i ka plotësuar namazet e mbetura.

Sa i përketë mënyrës së *nijjetit*, *musaliu* në këtë rast ka mundësinë e zgjedhjes, ose të bëjë *nijjet* që të falë, f.v., ikindinë e parë që i ka mbetur pa e falur, ose të bëjë *nijjet* të falë ikindinë e fundit që i ka mbetur pa e falur.

NAMAZET SUNNETE DHE NAFILE

الصلوات السنن و النوافل

Namazet *sunnete* konsiderohen ato namaze të cilat Pejgamberi s.a.w.s. i ka kryer vullnetarisht duke mos i patur obligim por vetëm që t'i afrohet sa më shumë Allahut të Lartësuar.

Namazet *nafile* janë ato namaze të cilat muslimani i kryen vullnetarisht duke mos i pasur obligim, por i kryen për respekt të Allahut të Madhëruar.

Në namazet *nafile* përfshihen të gjitha llojet e namazeve që nuk janë të obliguara për t'u zbatuar. Në këtë grup hyjnë edhe namazet *sunnete*, mirëpo, namazet *sunnete* kanë më shumë *sevab* se sa namazet *nafile*.

Norma e namazeve nafile

Muslimanit i rekomandohet që t'i zbatojë namazet *nafile* dhe po qe se i zbaton ka shpërblimin e Allahut xh.sh., e nëse nuk i zbaton nuk ndëshkohet nga Ai.

Namazet sunnete dhe llojet e tyre

Namazet *sunnete* ndahen në dy lloje:

1. **السُّنُنُ الرَّوَاتِبُ Sunnetet e radhitura.** Në këtë grup të *sunneteve* bëjnë pjesë ato namaze të vullnetshme-jo obligative, të cilat Pejgamberi s.a.w.s. i ka falur para dhe pas namazeve *farze*. Këto lloje të namazeve *sunnete* ndahen në dy grupe:

a. **السُّنُنُ الْمُؤَكَّدَةُ - Sunnetet e forta.** Si *sunnete* të forta konsiderohen ato *sunnete* të cilat Pejgamberi s.a.w.s. i ka kryer gjithmonë dhe rrallë herë ka ndodhur t'i ketë lënë pa falur. Si *sunnete* të forta konsiderohen:

1. **Sunneti i sabahut**¹¹⁴. Po që se namazi i sabahut falet me xhemat dhe personi e gjen xhematin në *farz*, atëherë, nëse fiton bindje se do ta arrijë imamin, do ta falë *sunnetin* dhe do t'i bashkohet imamit qoftë edhe në *rekatin* e dytë. E nëse frikësohet se do t'i kalojë falja me xhemat, në këtë rast nuk e falë *sunnetin* por i bashkohet xhematit, kurse *sunnetin* e sabahut e falë si *kaza* pas lindjes së diellit.

¹¹⁴ Për këtë Pejgamberi s.a.w.s. ka thenë: (رَكَعَتَا الْفَجْرِ خَيْرٌ مِنَ الدُّنْيَا وَمَا فِيهَا) “Dy rekatet e sabahut janë më të vlefshme se e tërë bota dhe ajo që është në të”. (Transmeton Muslimi).

2. **Katër rekatet e para të drekës.**¹¹⁵

3. **Dy rekatet e mbrama të drekës.**
RekomandohetE preferuar është që këtyre dy *rekatëve* t'u bashkangjiten edhe dy *rekatë* të tjera të bëhen katër.¹¹⁶

4. **Sunneti i akshamit.**

5. **Dy rekatë sunnet pas farzit të akshamit.**

6. **Dy rekatë sunnet pas farzit të jacisë.**

Shënim:

Vlera e faljes së këtyre *sunneteve* mund të argumentohet vetëm me hadithin:

(مَنْ صَلَّى فِي يَوْمٍ وَ لَيْلَةٍ ثِنْتَيْ عَشْرَةَ رَكْعَةً بُنِيَ لَهُ بَيْتٌ فِي الْجَنَّةِ)

“Ai i cili gjatë ditës dhe natës falë dymbëdhjet rekatë, atij i është ndërtuar një shtëpi në Xhennet”.

(Transmeton Muslimi). Në këtë *hadith* me shprehjen dymbëdhjetë *rekatë* përfshihen këto *sunnete*: dy *rekatë* para *farzit* të sabahut, katër *rekatë* para *farzit* të drekës, dy rekat pas *farzit* të drekës, dy *rekatë* pas *farzit* të akshamit dhe dy *rekatë* pas *farzit* të jacisë.

¹¹⁵ Transmetohet nga Aishja r.a se: كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ لَا يَدْعُ أَرْبَعًا قَبْلَ الظُّهْرِ وَ رَكْعَتَيْنِ قَبْلَ الْفَجْرِ عَلَى حَالٍ “Pejgamberi s.a.w.s. nuk i linte asnjëherë katër rekatet para *farzit* të drekës dhe dy rekatet para *farzit* të sabahut”. (Transmeton Buhariu).

¹¹⁶ Për këtë është argument fjala e Pejgamberit s.a.w.s. مَنْ صَلَّى أَرْبَعَ رَكْعَاتٍ قَبْلَ الظُّهْرِ وَ أَرْبَعًا بَعْدَهَا حَرَّمَ اللَّهُ عَزَّ وَ جَلَّ عَلَى النَّارِ “Kush i falë katër rekatë para *farzit* të drekës dhe katër pas *farzit* të drekës, Allahu xh.sh. do t'ia ndalojë zjarrin e Xhehennemit”. (Tranmston Muslimi)

7. **Katër rekate para farzit të xhumas dhe katër pas farzit të xhumasë me një selam.** Pejgamberi s.a.w.s. gjithmonë ka falë katër *rekate sunnet* para *farzit* të xhumasë me një *selam* e ngjashëm edhe pas *farzit* të xhumasë.

b. **السُّنُنُ غَيْرُ الْمُؤَكَّدَةِ - Sunnetet jo të forta.** *Sunnete* jo të forta konsiderohen ato *sunnete* të cilat nganjëherë Pejgamberi s.a.w.s. i ka lënë pa i falur. *Sunnetet* të tilla konsiderohen:

1. Të falurit e katër *rekate* dy *sunnetet* e mbrama të drekës.

2. Katër rekate *sunset* para *farzit* të ikindisë.

3. Katër rekate para *farzit* të jacisë¹¹⁷.

2. **السُّنُنُ غَيْرُ الرُّوَاتِبِ - Sunnete jo të radhitura.** Në këtë grup të *sunneteve* bëjnë pjesë ato *sunnete* të cilat nuk kanë lidhmëri me atë se a duhen falur para ose pas *farzeve*. Edhe *sunnetet* e tilla mund të jenë *sunnete* të forta dhe jo të forta. Si *sunnete* të tilla mund të përmendim:

1. **صَلَاةُ التَّرَاوِيحِ - Namazi i teravisë.** Ky lloj i namazit është *sunneti muekkede-sunset* i fortë. Këtë lloj të namazit është *sunset* për ta kryer si meshkujt ashtu edhe femrat. Ky lloj i namazit përbehet prej njezetë *rekateve* duke u bazuar në veprimin e tre hulefai rrashidinëve, Umerit r.a., Uthmanit r.a. dhe Aliut r.a. dhe; po ashtu

¹¹⁷ Këtë e argumenton hadithi i Pejgamberit s.a.w.s.: **من صلى قبل العشاء أربعاً، كان**

كأنما تمجد من ليلته و من صلاهن بعد العشاء كان كمثلهن من ليلة القدر "Kush i fal katër rekat para farzit të jacisë, është sikur të ishte falur gjithë natën, ndërsa ai cili i falë katër rekat pas farzit të jacisë është sikur të ishte falë në natën e kadrit". (Seid bin Mensuri ne sunenin e tij)

për këtë janë unanimesë që të katër imamët e *medh'hebeve*.

Koha e faljes së këtij namazi është pas namazit të jacisë dhe para namazit të *vitrit*. Mundë të falet në atë mënyrë që në çdo dy *rekate* të jepet *selam*, por mund të jepet *selam* edhe në çdo katër *rekate*. Po që se falët nga katër *rekate* falet njësoj si *sunneti* i ikindisë, d.t.th. në uljen e parë lexohen *salavatet* kurse në fillim të rekatit të tretë kur qëndrojmë në kembë, të këndohet *subhanekeja* para *fatihasë*. Ky namaz mund të falet vetmas dhe me xhemat, por më mirë është të falet me xhemat. Të falurit e *teravisë* me xhemat konsiderohet *sunneti kifaje*.

2. **صَلَاةُ الضُّحَى - Namazi duha.** Koha e këtij namazi është me zbardhjen e ditës, afërsisht njëzet minuta pas lindjes së diellit dhe zgjat deri para drekës. Mund të falen dy *rekate*, katër *rekate* më së shumti tetë *rekate*. Për këtë lloj namazi kemi transmetimin e Aishes r.a. e cila tregon: (كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يُصَلِّي صَلَاةَ الضُّحَى قَالَتْ) “Pejgamberi s.a.w.s. e falte namazin e duhasë katër *rekate*, ndonjëher shtonte sa dëshironte”.¹¹⁸

3. **صَلَاةُ التَّهَجُّدِ - Namazi tehexh-xhud.** Ky lloj i namazit falet natën dhe ky namaz ka vlerë dhe shpërblim të madh. Për vlerën e këtij namazi Pejgamberi s.a.w.s. ka thënë: (أَفْضَلُ الصَّلَاةِ بَعْدَ الْفَرِيضَةِ صَلَاةُ اللَّيْلِ) “Ma i vlefshmi namaz pas farzeve është namazi i natës”.¹¹⁹

¹¹⁸ Transmeton Muslimi

¹¹⁹ Transmeton Muslimi

4. **سُنَّةُ الْوُضُوءِ - Namazi pas abdestit.** Ky namaz mund të kryhet pasi të merret *abdest* dhe përbëhet prej dy rekateve.

5. **تَحِيَّةُ الْمَسْجِدِ - Namazi për nderim të xhamisë.** Ky namaz falet kur hyhet në ndonjë xhami dhe i ka dy *rekate*.

6. **صَلَاةُ الْإِسْتِخَارَةِ - Namazi istihare.** Ky namaz është dy *rekatësh*, falet në rast se njeriu, në ndonjë gjë të lejuar nuk e di se ku është interesi i tij. Psh., kur njeriu dëshiron të fejojë dhe nuk di se a është në dobi të tij fejesa apo jo, e të ngjashme.

7. **صَلَاةُ الْحَاجَةِ - Namazi haxheh.** Ky namaz përbëhet prej dy *rekateve*. Ketë namaz mund ta falë *musaliu* që Allahu t'ia lehtësojë veprimin e ndonjë gjëje.

8. **صَلَاةُ التَّسْبِيحِ - Namazi tesbih.** Ky namaz përbëhet prej katër *rekateve* por mund të falë edhe dy *rekate*. Ky lloj i namazit falet në këtë mënyrë: pasi të lexohet *subhaneke* thuhet pesëmbëdhjetë herë kjo shprehje:

(سُبْحَانَ اللَّهِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ)

e pastaj lexohet *fatiha* dhe një *sure* dhe pastaj prapë dhjetë herë lexohet:

(سُبْحَانَ اللَّهِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ)

e kur të shkohet në *ruku* dhe të lexohet tri herë ajo çka lexohet në *ruku*, duhet të lexohet dhjetë herë:

(سُبْحَانَ اللَّهِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ)

e pasi të ngrihemi prej *rukus*, lexojmë dhjetë herë:

(سُبْحَانَ اللَّهِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ)

pastaj kur të shkohet në *sexhde* dhe të lexohet ajo që lexohet në *sexhde* pastaj duhet të thuhet dhjetë herë:

(سُبْحَانَ اللَّهِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ)

e pastaj në uljen në mes dy *sexhdeve* lexojmë dhjetë herë:

(سُبْحَانَ اللَّهِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ)

poashtu në *sexhden* e dytë veprojmë njejtë si në *sexhden* e parë, d.t.th. lexojmë dhjetë herë:

(سُبْحَانَ اللَّهِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ)

Në këtë mënyrë vepohet gjatë gjithë namazit. Duhet patur të qartë që kur ngrihemi në *rekatin* e dytë nuk lexojmë *subhaneken* por para *fatihasë* lexojmë pesëmbëdhjetë herë:

(سُبْحَانَ اللَّهِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ).

Disa rregulla të veçanta që kanë të bëjnë me namazet sunnete dhe nafilë

Namazet *nafilë* i kanë rregullat e njejtë me namazet *farze*, por disa rregulla në namazet *nafilë* mund të mos zbatohen sa për lehtësim. Përjashtimet e tilla janë:

1. Të qëndruarit në këmbë në namazet *farze* është *rukn* dhe ai që ka mundësi duhet doemos ta kryejë këtë *ruken*, mirëpo në namazet *nafilë*, *musaliu* mund të falet ulur dhe të mos qendrojë në këmbë por *thevabi* është përgjysmë. Se namazet *nafilë* mund të falën ulur argumenton hadithi:

(مَنْ صَلَّى قَائِمًا فَهُوَ أَفْضَلُ وَمَنْ صَلَّى قَاعِدًا فَلَهُ نِصْفُ أَجْرِ الْقَائِمِ)

“Kush falet në këmbë është më mirë, ndërsa ai që falet ulur ka gjysmën e shpërblimit”.

2. Kur *musaliu* të fillojë faljen e namazit *nafile*, apo *sunnete*, doemos duhet ta kryejë, e nëse e prish, duhet ta përsërisë.

3. *Sunnetet* e radhitura gjithmonë falen pa zë pavarësisht a falen natën apo ditën. Ndërsa, sa u përket *sunneteve* tjera ato mund të falen më zë dhe pa zë, do të thotë varet kryesisht prej dëshirës së *musaliut*.

4. Në parim, namazet *nafile* falen nga dy *rekate*, por nëse ndodhë që *musaliu* t'i falë namazet *nafile* nga katër *rekate* duhet që pas *fatihasë* të lexojë edhe *suren* në *rekatin* e tretë dhe të katërt.

5. Nëse ndodhë që *musaliu* në *sunnetet* katër *rekatësh* të ulet në uljen e parë, e pastaj e bën ndonjë gabim i cili e prish *rekatin* e tretë ose të katërt, në këtë rast dy *rekatet* e para janë të vlefshëm.

6. Kur ndodhë që *musaliu* të bëjë *nijjet* për t'i falur katër *rekate sunnet* por i falë vetëm dy *rekate*, namazi i tij konsiderohet i vlefshëm.

7. Në *sunnetet* e natës rekomandohet që në *kijam* të qëndrohet më gjatë se sa në *ruknet* e tjera.

NAMAZI ME XHEMAT

صَلَاةُ الْجَمَاعَةِ

Të falurit me *xhemat* është *sunnet* i fortë për meshkujt. Falja e namazit me *xhemat* ka vlerë më të madhe se sa të falurit vetëm. Për këtë kemi argument *hadithin* e Pejgamberit s.a.w.s. : (صَلَاةُ الْجَمَاعَةِ أَفْضَلُ مِنْ صَلَاةٍ) (أَحَدِكُمْ وَحْدَهُ بِخَمْسَةِ وَعِشْرِينَ دَرَجَةً) “*Namazit me xhemat është*

më i vlefshëm se sa ai që falët vetmas për njezetë e pesë herë”.

Po ashtu, kur lexojmë disa *ajete* kur'anore vërejmë se ato na urdhërojnë të bëjmë *ruku* e *sexhde* me ata të cilët bëjnë *ruku* e *sexhde*.

Vlera e *thevabit* të xhematit arrihet edhe me një xhemat, qoftë fëmijë apo edhe grua. Sa më i madh të jetë numri i xhematit më i madh është *thevabi*. Xhemati mund të formohet në shtëpi, xhami etj., mirëpo xhemati i formuar në xhami është më i vlefshëm. Është mirë që të mos lihet xhemati pa arsye të justifikueshme.

Kushtet e imamit

Imami përveçqë duhet të jetë musliman dhe i mençur duhet t'i plotësojë këto kushte:

1. **الْبُلُوغُ** - madhor. Imami duhet të jetë i hyrë në moshën madhore dhe pa e plotësuar këtë kusht nuk lejohet falja e namazit pas tij, si imam.
2. **الذَّكُورَةُ** - të jetë mashkull.¹²⁰ Femra nuk lejohet t'u bëhet imam meshkujve.
3. **أَنْ يُحْسِنَ قِرَاءَةَ مَا تَصِحُّ بِهِ الصَّلَاةُ دُونَ فَافَأَةٍ** - që të lexojë Kur'anin mirë, që namazi të jetë i vlefshëm dhe të mos ketë pengesa në shqiptim. Po që se imami ka pengesa të cilat e pengojnë në shqiptim; dhe pengesa e tillë gjatë shqiptimit ia humb kuptimin e fjalës, në këtë rast, i tilli nuk lejohet të bëhet imam.
4. **السَّلَامَةُ مِنَ الْأَعْدَارِ** - Të mos jetë *sahibi udhër*. Kur personi është *sahibi udhër* nuk lejohet t'u bëhet imam

¹²⁰ Argument për këtë është hadithi: (لَا تُؤْمَنُ امْرَأَةٌ رَجُلًا) “Nuk lejohet që femra të bëhet imam për mashkullin”. (Transmeton Ibn Maxhe)

atyre që nuk janë *sahibi udhër*, ndërsa *sahibi udhëri* mund t'u bëhet imam atyre që janë si ai.

Kush është më meritor për imam

Namazi si obligim mund të falet në shtëpi, në xhami e në vende të tjera. Kur namazi falet në shtëpi më meritori për të qenë imam është i zoti i shtëpisë ose ai të cilit i jep leje i zoti i shtëpisë që të bëhet imam. E po që se namazi falet në xhami, atëherë më meritori për të dalë imam është ai që është imam i rregullt në xhami me përjashtim nëse në xhami është udhëheqësi i muslimanëve-*halifi* apo *muftiu*, në këtë rast më meritorë janë këta.

Kur nuk është asnjëri prej këtyre si *halifi*, *muftiu* apo i zoti i shtëpisë, nëse namazi falet në shtëpi, atëherë më meritori është ai person i cili i plotëson këto kushte:

1. Ai që i njeh më së miri rregullat-dispozitat e namazit.
2. Ai që lexon Kur'anin më së miri.
3. Ai që është më i devotshëm.
4. Ai që është më i moshuar si respekt ndaj tij.
5. Ai që e ka zërin më të bukur.

Mekruh është të bëhet imam *fasiku*, ai që bën *bidate*, ai i cili është injorant dhe i verbëri.

Kur vlerësohen të gjitha këto, atëherë ai që më së shumti i plotëson këto kushte.

Kushtet që duhet të plotësohen për të qenë i vlefshëm falja me imam

Kushtet e tilla janë:

1. **النِّيَّةُ - Nijjeti.** Nuk kushtëzohet që imami kur ua falë namazin meshkujve të bëjë *nijjet* se është imam i meshkujve, ndërsa kur ndodhë që në mesin e xhematit të ketë edhe femra, imami duhet doemos ta bëjë *nijjet* se është imam edhe i femrave. *Nijjeti* mjafton të jetë i bërë vetëm me zemër. Nuk kushtëzohet që imami të bëjë *nijjet* se është imam edhe i femrave në namazin e xhumasë dhe të bajrameve.

2. **أَنْ لَا يَسْتَقَدَّمَ الْمُقْتَدِي عَلَى إِمَامِهِ بَلْ يَتَأَخَّرُ عَنْهُ أَوْ يُحَادِثِهِ عَلَى الْأَقَلِّ.**

Që muktediu mos të qëndrojë para imamit, por të qëndrojë pas tij ose se paku të jetë krah për krah me të. Po që se *muktediu* qëndron para imamit, namazi i tij konsiderohet i prishur.

3. **أَنْ لَا تَكُونَ صَلَاةُ الْإِمَامِ أَدْنَى مِنْ صَلَاةِ الْمَأْمُومِ.** **Që namazi i imamit të mos jetë në gradë me të ulët se namazi i muktediut.** Kur ndodhë që imami është duke falur namaz *nafile*, ndërsa *muktediu* i bashkohet për të falur namaz *farz*, në këtë rast muktediu duhet ta përsërisë namazin e tillë, ngase, kategoria e namazit të tij ka qenë më e fortë se e imamit. Nëse ndodhë që namazi i *muktediut* është i kategorisë më të ulët se i imamit, atëherë namazi i *muktediut* konsiderohet i pranuar.

4. **أَتَحَادُ فَرَضِ الْإِمَامِ وَالْمَأْمُومِ.** **Që namazi farz të jetë i njëjtë si i imamit ashtu edhe i muktediut.** Doemos duhet që imami dhe muktediu të falin *farzin* e njëjtë, f.v., imami është duke falur *farzin* e drekes edhe *muktediu* doemos duhet ta falë *farzin* e drekës, e nuk lejohet që imami ta falë *farzin* e drekës e *muktediu* t'i bashkangjitet imamit për ta falur *farzin* e ikindisë.

5- **Që** - أَنْ لَا يَكُونَ الْمُصَلِّيُّ مَسْبُوقًا بِأَنْ كَانَ تَابِعًا لِإِمَامٍ آخَرَ.

musaliu të mos jetë i vonuar në namaz, e t'i bashkohet imamit tjetër për t'i vazhduar rekatet e mbetura. Nëse ndodhë që *musaliu* është vonuar në namaz dhe e i ka kaluar ndonjë rekat pa e falur, nuk guxon që pasi imami i tij ta kryejë namazin, t'i bashkohet ndonjë imamit tjetër për ta plotësuar *rekatin* e kaluar.

6- **Që musaliu të mos** - أَنْ لَا يُصَلِّيَ خَلْفَ امْرَأَةٍ مُقْتَدِيَةٍ بِإِمَامِهِ.

falet prapa femrës madje edhe nëse ata të dy janë duke u falur prapa imamit të njëjtë. Nëse femra, para mashkullit, namazi i mashkullit konsiderohet i prishur, dhe, mu për këtë arsye, nuk lejohet që mashkullit t'i bashkohet imamit nëse femra është në rresht para tij.

7- **Që të mos e** - أَنْ لَا يَفْصَلَ بَيْنَ الْإِمَامِ وَالْمُقْتَدِيَّ طَرِيقٌ عَامٌّ.

ndajë imamin prej muktediut ndonjë rrugë frekuentive. Nëse ndodhë që xhemati të bëjnë rreshta në rrugë dhe kështu të bëhet lidhshmëria e rreshtave të xhematit, namazi i tillë është i vlefshëm. Por nëse në mes rreshtave të xhematit gjendet ndonjë mur, saqë xhemati që mbeten prapa murit nuk mund ta dëgjojnë imamin, atëherë namazi i tyre konsiderohet i prishur. Po që se ka mjete të smadhimit të zërit, atëherë namazi mund të vazhdohet dhe konsiderohet i vlefshëm.

8- **تَصِحُّ الصَّلَاةُ مُقْتَدِيًّا عَلَى سَطْحِ الْمَسْجِدِ الَّذِي يُصَلِّيَ إِمَامُهُ إِذَا كَانَ**

Namazi është i vlefshëm kur muktediu falet në sipërfaqen e jashtme të xhamisë më kusht, që zëri i imamit të dëgjohet nga ana e muktediut.

إِذَا اشْتَدَّ الرَّحَامُ فِي الْمَسْجِدِ أَمَكَنَ لِلْمُصَلِّيِّ الَّذِي لَا يَجِدُ مَكَانًا يَسْجُدُ 9. **Kur** فيه أن يسجد على ظهر المُصَلِّيِّ أَمَامَهُ إِذَا كَانَ يُصَلِّي نَفْسَ صَلَاتِهِ **ndodhë të jenë grumbulluar një numër i madh i xhematit, i lejohet muktediut të bëjë sexhde në shpinë të muktediut tjetër me kusht, që namazi i xhematit të jetë i rangut të njëjtë.**

Shënim:

Namazi është i vlefshëm po që se imami është me *tejmum* e *muktediu* është me *abdest*, po ashtu, kur ndodhë që imami t'i ketë larë kembët, ndërsa *muktediu* i ka dhënë *mes'h* këmbëve, namazi në këtë rast është i vlefshëm.

Namazi konsiderohet i vlefshëm edhe kur imami është udhëtar e *muktediu* vendas, por është e rekomanduar që imami ta lajmërojë *muktediun* se është udhëtar dhe se do të japë *selam* në *rekatin* e dytë në mënyrë që *muktediu* të ketë mundësi për të vazhduar *rekatet* e tjerë vetmas. Po ashtu, namazi është i vlefshëm kur ndodhë që imami të jetë vendas e *muktediu* udhëtar, por, në këtë rast *muktediu* edhepse është udhëtar duhet t'i bashkohet imamit deri në fund dhe nuk duhet ta shkurtojë namazin.

Lejohet që *muktediu* të falet pas imamit i cili është i sëmurë dhe nuk mund të qëndrojë në këmbë por falet ulur. Po ashtu lejohet që *muktediu* të falët prapa imamit i cili konsiderohet *fasik*, f.v., pi alkool; merret me kamatë etj. pavarësisht prej asaj se ai konsiderohet mëkatar.

Nuk lejohet që *muktediu* i cili nuk është *sahibi udhër* të falet prapa atij që është *sahibi udhër*, ndërsa, lejohet që *sahibi udhëri* të falët para atij që nuk është

sahibi udhër. Po ashtu, lejohet të falët *sahibi udhëri* para atij që është *sahibi udhër*.

Disa veprime të muktediut kur është duke u falur me imam

Muktediu mund të jetë: ***mudrik, lahik dhe mesbuk***.

Mudrik: konsiderohet ai *musali* i cili e ka arritur namazin prej fillimit me imamin dhe e ka vazhduar deri në fund.

Lahik: është ai *musali* i cili e ka arritur namazin prej fillimit me imamin, por e ka ndërprerë namazin për ndonjë shkak të justifikueshëm, pastaj, prap i është bashkuar imamit, por, kur t'i bashkohet imamit i plotëson vetëm ato *rekate* që i kanë mbetur prej momentit kur e ka ndërprerë namazin, ndërsa ato që i ka falur me imamin nuk i plotëson.

Mesbuk: konsiderohet ai *musali* i cili është vonuar, por e ka arritur imamin se paku pa dhënë *selam*. Ky do t'i plotësojë ato *rekate* që i kanë kaluar pa i falur.

Si veprime të *muktediut* mund të përmendim:

1. Kur *musaliu* hyn në xhami por *ikameti* për t'u falur *farzi* është bërë, ose, është duke u bërë, në këtë rast *musaliu* duhet t'i bashkohet xhematit, e jo të filloj faljen e ndonjë *sunneti*. Nga ky rregull bënë përjashtim vetëm *sunneti* i sabahut që, nëse *musaliu* mendon se mund ta arrijë imamin pa e përfunduar *farzin*, do të fillojë të falë *sunnetin*, e nëse frikësohet se nuk mund ta arrijë, atëherë, menjëherë i bashkohet xhematit.

2. Kur *muktediu* hyn në namaz ndërkohë që imami ka filluar leximin, atëherë *muktediu* e ka për obligim të heshtë dhe të mos lexojë as *subhaneken*.

3. Po që se *muktediu* e zë imamin në *ruku*, ai duhet të drejtohet në *saff*, të bëjë *tekbirin* fillestar e pastaj të shkojë në *ruku* dhe nëse e arrin imamin në *ruku* veç e ka arritur *rekatin*.

4. Kur ndodhë që *muktediu* të jetë *mesbuk* ai duhet ta bëjë *tekbirin* fillestar e pastaj të shkojë për t'iu bashkuar imamit.

5. Është *mekruh*, që nëse *musaliu* është vonuar dhe kur sheh se xhemati është formuar të vrapojë sepse në këtë rast mund të shkaktojë huti në mesin e xhematit. Rekomandohet që kur të arrijë për të hyrë në xhemat, edhe nëse jemi vonuar, duhet të ecim në mënyrë të qetë qoftë edhe nëse kalon *rekati*. Mu për këtë Pejgamberi s.a.w.s. ka thënë:

إِذَا أُقِيمَتِ الصَّلَاةُ فَلَا تَأْتُوهَا تَسْعُونَ وَائْتُوهَا تَمْشُونَ
وَعَلَيْكُمْ السَّكِينَةُ فَمَا أَدْرَكْتُمْ فَصَلُّوا وَمَا فَاتَكُمْ فَأْتُوا

“Kur të bëhet *ikameti* për t'u falur namazi, mos shkoni duke vrapuar, por shkoni duke ecur dhe të jeni të qetë (gjatë ecjes), atë çka e arrini prej rekateve faleni, e atë që iu ka kaluar pa e falur plotësojeni.”¹²¹

6. Kur të arrijë *musaliu* dhe e gjenë imamin ulur në *sexhde*, ose duke shkuar në *sexhde*, ai duhet ta bëjë *tekbirin* fillestar e pastaj të shkojë duke bërë *tekbir* për t'iu bashkuar imamit aty ku e ka zënë. Për këtë veprim të tillë ka shpërblim edhe pse *rekatin* nuk e ka arritur.

¹²¹ Transmeton Buhariu dhe Muslimi

7. Kur ndodhë që *musaliu* e ka zënë imamin në *ruku*, por imami ngirhet ende pa thënë *musaliu subhane rabbijel adhim*, në këtë rast *musaliu* do ta ndjekë imamin dhe nuk do të ndalet për të thënë *subhane rabbijel adhim*, ngase ndjekja e imamit është *vaxhib*, e thënia *subhane rabbijel adhim* është *sunnet*.

8. Po që se imami ngrihet apo jep *selam* para se *muktediu* të lexojë *teshehudin*, i tilli duhet ta lexojë *teshehudin* dhe pastaj ta ndjekë imamin, dhe nuk duhet t'i lexojë në këtë rast as *salavatet* e as *duatë*, sepse leximi i këtyre është *sunnet* e ndjekja e imamit është *vaxhib*.

9. Kur imami bën *sehvi sexhde* edhe *muktediu* duhet të bëjë *sehvi sexhde*, pavarësisht nëse *muktediu* e di arsyen e të bërit *sehvi sexhde* apo jo.

10. Kur ndodhë që imami duke lexuar ndalet dhe nuk i kujtohet se çka të lexojë në vazhdim, *muktediu* ka të drejtë t'ia rikujtojë leximin, por, nëse imami ka lexuar aq sa mjafton për t'u kryer *rukni*, nuk ka nevojë rikujtimi por imami duhet të shkojë në *ruku* dhe të vazhdojë namazin në mënyrë normale.

11. Po që se imami jep *selam*, *muktediu* që është *mesbuk* duhet t'i plotësojë *rekatet* e mbetura menjëherë pasi imami të ketë dhënë *selam*. Kur ndodhë që *mesbuki* të ketë falur *rekatin* e tretë dhe të katërt me imam, i tilli, kur të ngrihet për t'i plotësuar dy *rekatet* e mbetura duhet të lexojë *fatihanë* dhe *suren*.

NAMAZI I XHUMASË

صلاة الجمعة

Obligueshmërinë e namazit të xhumasë e vërejmë qartë nga ajeti:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نُودِيَ لِلصَّلَاةِ مِنْ يَوْمِ الْجُمُعَةِ فَاسْعَوْا إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ وَذَرُوا (البَيْعَ)
 “O ju që keni besuar, kur të thirret për t’u falur xhumaja, nxitoni ta përmendni Allahun dhe leni shitblerjen...”.

Namazi i xhumasë është *farzi ajn* për çdo *mukel-lef* që është mashkull, i shëndoshë, vendës, në qytet në të cilin ka prijës ose gjykatës.

Xhumaja nuk konsiderohet obligim për:

1. fëmijët të cilët ende nuk kanë hyrë në moshën madhore,
2. femrat, nuk e kanë obligim faljen e xhumasë,
3. i sëmuri, i verbri, plaku i moshës së thellë që vetë nuk mund të shkojë në xhami, dhe
4. udhëtari.

Kushtet e xhumasë

Për të qenë e vlefshme, xhumaja duhet t’i plotësojë këto kushte:

1. أَنْ تَكُونَ فِي مِصْرٍ - **Që xhumaja të falet në vendbanime.** Prej kushteve të xhumasë është që të falet në atë vend ku ka udhëheqës ose *kadi*.

2. أَنْ تَتَقَدَّمَ عَلَيْهَا خُطْبَةُ الْجُمُعَةِ - **Që para faljes së namazit të bëhet hutbeja.** Namazi i xhumasë konsiderohet i pavlefshëm nëse falet pa u bërë hutbeja.

3. أَنْ يَكُونَ الْإِمَامُ وَالْحَاطِيبُ هُوَ الْأَمِيرُ أَوْ نَائِبُهُ أَوْ مَنْ يَأْذَنُ لَهُ - **Që imami dhe hatibi të jetë vetë prijës i muslimanëve ose zëvendësi i tij apo personi të cilin e ka autorizuar vetë prijësi.** Autorizimin e imamit dhe hatibit e ka bërë

prijësi i muslimanëve, por tash, institucioni i *halifatit*, për fat të keq, nuk ekziston, kështu që autorizimin e tillë bëjnë organet kompetente fetare të secilit vend¹²².

4. **أَنْ تَكُونَ عَامَّةً – Që xhumaja të jetë e lirë që të gjithë ta falin.** Me këtë kusht nënkuptohet se nëse dikush prej njerëzve pengohet që të mos e falë xhumanë, namazi i xhumasë në këtë rast nuk është i vlefshëm.

5. **لَا يَشْتَرُ كَثْرَةَ الْعَدَدِ فِي صَلَاةِ الْجُمُعَةِ – Nuk kushtëzohet që të kihet numër të madh të xhematit.** Kërkohet që së paku të jenë tre veta xhemat dhe imami për t'u konsideruar namazi i xhumasë i vlefshëm. I këtij mendimi është Ebu Hanifja r.a. dhe imam Muhammedi r.a., ndërsa Imam Ebu Jusufi r.a. mendon që mjafton të jenë dy veta xhemat dhe imami, mirëpo mendimi i parë është më i pranuar, d.t.th., të jenë tre veta.

6. **أَنْ تَفْعَلَ فِي وَقْتِ الظُّهْرِ – Që namazi i xhumasë të falet në kohën e namazit të drekës.**

DISA RREGULLA TË VEÇANTA PËR XHUMANË

1. Kur të thirret *ezani* për të shkuar në namazin e xhumasë duhet nxituar për namaz dhe duhet lënë shitblerjen.

2. Nuk është detyrim namazi i xhumasë për atë që ka arsye të justifikueshme si, f.v., i verbri, i sëmuri, mjeku kujdestar i cili doemos duhet të jetë pranë pacientit, ai që ka frikë se do ta dëmtojë nxehtësia e madhe apo të

¹²² Në këtë ras tek ne, autorizimet i ka në kompetencë, Bashkësia Islame e Kosovës.

ftohtët e madh. Po ashtu, xhumaja nuk është detyrim edhe për atë person që është në armiqësi me dikë dhe ka frikë se po doli , do të vijë deri tek ndonjë problem serioz etj.

3. *Mekruh* është dalja nga qyteti pasi të ketë thirrur *ezani* për atë person i cili e ka detyrim xhumanë.

4. Kur imami është duke ligjëruar në *minber*, të falurit dhe të folurit konsiderohet *mekruh*. Mu për këtë Pejgamberi s.a.w.s. ka thënë:

إِذَا دَخَلَ أَحَدُكُمْ الْمَسْجِدَ وَ الْإِمَامُ يَخْطُبُ فَلَا صَلَاةَ وَلَا كَلَامَ حَتَّى يَفْرُغَ (الْإِمَامُ) “Kur dikush prej jush hyn në xhami dhe imami është duke ligjëruar në minber, nuk lejohet të falet namaz e as të flitet derisa imami ta kryejë hutben”.¹²³

5. Kush e arrin imamin në namazin e xhumasë ende pa dhënë *selam*, i tilli duhet t'i bashkohet dhe pasi imami të japë *selam* ai duhet t'i falë dy *rekate* të xhumasë.

6. Ai i që nuk e ka arritur xhumanë duhet ta falë namazin e drekës.

7. Po qe se imami bën ndonjë lëshim për të cilin duhet bërë *sehvi sexhde*, nuk duhet bërë *sehvi sexhden* sepse ka numër të madh të xhematit.

8. Rekomandohet që në ditën e xhumasë muslimani të pastrohet. Transmetohet nga Enes bin Maliku r.a. se Pejgamberi s.a.w.s. ka thënë:

(مَنْ تَوَضَّأَ يَوْمَ الْجُمُعَةِ فِيهَا وَ نَعِمَتْ وَ مَنْ اغْتَسَلَ فَالْغَسْلُ أَفْضَلُ) “Kush ka marrë abdest ka bërë mirë, ndërsa kush është larë është më mirë”.

¹²³ Transmeton Taberaniu në “el-Kebir”

9. Është mirë që të vishen rrobat më të bukura dhe të përdoren erëra të mira.

10. Rekomandohet të shkohet në xhuma para se imami të ketë hipur në *minber*.

11. Preferohet që të mbulohet koka me ndonjë kapuç kur të shkohet në xhami. Për këtë mund të permendim transmetimin e Amr bin Hurejthit i cili ka treguar:

(أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ خَطَبَ النَّاسَ وَعَلَيْهِ عُمَامَةٌ سَوْدَاءُ)

“Në të vërtetë Pejgamberi s.a.w.s. e mbajti hutbenë para njerzëve dhe në kokë kishte një kapuç të zi”.¹²⁴

12. Nuk preferohet që të veçohet vetëm dita e xhuma për të agjëruar.

Hutbeja e xhumasë

Kemi përmendur më lart se të mbajturit e *hutbesë* është kusht për t'u plotësuar dhe konsideruar i plotë namazi i xhumasë, d.t.th., nëse nuk bëhet *hutbeja*, namazi i xhumasë nuk është i kryer.

Ajo që më së paku duhet doemos të shprehet në zbatimin e *hutbesë* është që të shprehet lartësimi dhe falënderimi ndaj Allahut xh.sh. *Hutbeja* e xhumasë përbëhet prej dy *hutbeve*; në mes dy *hutbeve* bëhet një ulje e shkurtër sa të lexohen tri *ajete* të shkurtra. E pëlqyer është që duke hipur shkallëve të *hutbesë* të hipet vetem me këmbën e djathtë. Kur *hatibi* të ngrihet për të mbajtur *hutbenë* duhet vepruar sipas *sunnetit* të

¹²⁴ Transmeton Muslimi

Pejgamberit s.a.w.s., të fillojë *hutbenë* me falënderim ndaj Allahut xh.sh., të shprehë dëshminë se Allahu është i vetëm, i pa shoq, po ashtu të konfirmojë se Muhammedi a.s. është Pejgamber i Zotit dhe t'i dërgojë *salavate* atij e pastaj të hyjë në shpjegimin e temës për të cilën është përcaktuar *hatibi*.

NAMAZI I BAJRAMEVE

صَلَاةُ الْعِيدَيْنِ

Namazi i bajrameve është *vaxhib* për atë, që të cilit është *farz* xhumaja. Pra namazi i bajrameve është *vaxhib* për këta persona:

1. الذُّكُورُ - Për atë që është mashkull. Femra nuk e ka *vaxhib* namazin e bajrameve.

2. الْمُقِيمِينَ فِي بَلَدٍ لَهُ أَمِيرٌ أَوْ قَاضٍ أَوْ مُفْتٍ - Ata që janë vendës në atë vend ku ka prijës, kadi apo mufti. Namazi bajrameve nuk është *vaxhib* për atë që konsiderohet udhëtar dhe që jeton në ato vende ku nuk ka prijës, *kadi* apo *mufti*.

3. أَلَّا يَكُونَ مَرِيضًا. - Që personi të mos jetë i sëmurë. Personi i cili është i sëmurë dhe nuk mund të shkojë në xhami nuk e ka obligim faljen e namazit të bajrameve.

Koha e namazit të bajrameve

Namazi i bajrameve mund të falet afërsisht njëzetë minuta pasi të ketë lindur dielli e deri para se të hyjë koha e namazit të drekës.

Mënyra e të falurit të namazit të bajrameve

Për namaze të bajrameve nuk këndohet *ezani* e as *ikameti*. Ky namaz përbëhet prej dy *rekateve*, njëjtë sikur namazi i sabahut, por dallon në atë se në këtë namaz është *vaxhib* të këndohen *tekbiret*. Këto *tekbire* këndohen në këtë mënyrë: tri *tekbire* këndohen pas leximit të *subhanekes* në *rekatin* e parë, pastaj lexohet *fatihaja* dhe *sureja*, ndërsa kur të ngrihemi në *rekatin* e dytë pasi të lexohet *fatihaja* dhe *sureja* këndohen tri *tekbire*. Po që se *tekbiret* lexohen para leximit ose pas leximit, namazi megjithatë konsiderohet i vlefshëm. Sa herë që të bëhen *tekbiret* duhet të ngrihen duart.

Disa rregulla që kanë të bëjnë me namazin e bajrameve

1. Namazi i bajrameve ka *shartet* dhe *ruknet* sikur edhe namazet e tjera të zakonshme, mirëpo, nëse namazi i bajramit është duke u falur, *musaliu* nuk ka *abdest* dhe nuk i mjafton koha për të marrë *abdest*, atëherë, i tilli, duhet të marrë *tejemmum* për shkak se i është ngushtuar koha e faljes së bajramit.

2. Kur ndodhë që *musaliu* të arrijë imamin pasi t'i ketë kryer *tekbiret*, në këtë rast *musaliu* do ta bëjë *tekbirin* fillestar e pastaj do t'i bëjë *tekbiret* e namazit të bajramit pa lexuar fare *subhaneken*. Nëse e arrinë imamin në *ruku*, nëse ka mundësi i kryen *tekbiret* dhe shkon në *ruku*, e nëse nuk mundet, i bën në *ruku*.

3. Po që se *musaliu* e arrin imamin në *rekatin* e dytë, ai duhet ta plotësojë *rekatin* duke i kënduar edhe *tekbiret*.

4. Kur ndodhë që imami të këndojë më tepër se tri *tekbire muktediu* duhet ta ndjekë doemos imamin.

5. Atij që i kalon namazi i bajramit pa e falur me imam, nuk duhet ta falë *kaza*.

6. Konsiderohet *mekruh* të falurit e namazeve *nafile* qoftë në shtëpi apo në xhami para se të falet bajrami, po ashtu, *mekruh* është të falet *nafile* pasi të jetë falur bajrami në xhami, ndërsa, në shtëpi, pasi të jetë falur bajrami nuk është *mekruh* të falësh namaz *nafile*.

7. Sunnet është që pasi të falet bajrami të mbahet *hutbeja*.

Kendimi i tekbirit të teshrikut

Me shprehjen *tekbiri teshrik* nënkuptohen ato *tekbire* të cilat fillojnë të këndohen pas namazit të sabahut të ditës së *Arefatit* d.t.th., natës së kurban bajramit dhe këto *tekbire* vazhdojnë të këndohen pas çdo namazi *farz* deri në *farzin* e ikindisë të ditës së katërt.

Forma e *tekbirit teshrik* është kjo:

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ
أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ وَاللَّهُ أَحْمَدُ

Të kënduarit e *tekbiri teshrikut* është *vaxhib* vetëm një herë, e po që se këndohet më tepër është *mustehab*. Gruaja kur të këndojë *tekbiri teshrikun* duhet të këndojë me zë të ulët.

Hutbeja e bajrameve

Të mbajturit e *hutbesë* është *sunnet*. *Hutbeja* e bajramit përbëhet prej dy *hutbeve*, sikurse *hutbeja* e xhumasë. *Hatibi*, *hutben* e bajramit e fillon me *tekbire*.

NAMAZI I UDHËTARIT

صَلَاةُ الْمُسَافِرِ

Udhëtar në terminologjinë e *fikhut* konsiderohet personi që vendos të bëjë një udhëtim në një distancë ecjeje në këmbë tri ditë apo përafërsisht 81.km. Personi që konsiderohet udhëtar, prej momentit kur largohet prej lagjes së tij duhet ta shkurtojë namazin deri kur të arrijë në vendin në të cilin synon të shkojë dhe, nëse vendos që atje të qëndrojë më pak se pesëmbëdhjetë ditë, i tilli, duhet t'i falë namazet e shkurtuara, e nëse ndodhë që personi ka vendosur të qëndrojë pesëmbëdhjetë , atëherë duhet të falë namaz normal pa e shkurtuar.

Të shkurtuarit e namazeve katër *rekatësh* në dy *rekate* gjatë udhëtimit është *vaxhib*¹²⁵. Sa i përket namazeve që janë tre *rekatësh* ato nuk duhet të shkurtohen.

Kur musaliu konsiderohet udhëtar?

Musaliu konsiderohet udhëtar dhe duhet ta shkurtojë namazin kur vendos që të udhëtojë në një distancë ecjeje tri ditë në këmbë apo përafërsisht 81.km. *Musaliu* kur është udhëtar duhet të fillojë shkurtrimin e namazit sa po të jetë larguar nga lagjja e tij.

¹²⁵ Për atë se duhet të shkurtohen namazet kemi argument hadithin të cilin e transmeton Aishja r.a. *فُرِصَتِ الصَّلَاةِ رَكْعَتَيْنِ إِلَّا الْمَغْرِبَ فَإِنَّهُ وَثُرَ النَّهَارِ ثُمَّ زِيدَتْ فِي الْحَضَرِ وَأَقْرَتْ فِي السَّفَرِ عَلَى مَا كَانَتْ* “Në fillim, namazet farze ishin nga dy rekate, përveç akshamit, ngase namazi i akshamit është namazi tek i ditës, pastaj disa namaze u bënë katër rekatesh, por gjatë udhëtimit mbeten dy rekatesh siku që ishin obligim në fillim”. (Transmeton Ahmedi).

Kur musaliu pasi ka qenë udhëtar mund të konsiderohet vendës(mukim)?

Musaliu udhëtar konsiderohet vendës (*mukim*) atëherë kur të kthehet në vendbanimin e tij të përhershëm apo nëse vendosë që në vendin në të cilin ka shkuar, të qëndrojë pesëmbëdhjetë ditë e më tepër. Po që se *musaliu* vendosë të qëndrojë si udhëtar më pak se pesëmbëdhjetë ditë, i tilli duhet të shkurtojë namazin, por nganjëherë mund të ndodhë që *musaliu* të mos mund të vendosë se sa do të qëndrojë në mënyrë të prerë, f.v., *musaliu* vendosë të qëndrojë dy ditë në ndonjë vend dhe pas dy ditëve prapë vendosë të qëndrojë edhe dy ditë të tjera dhe në këtë mënyrë mund të zgjas koha e qëndrimit me vite e *musaliu* të konsiderohet si udhëtar.

Norma e të falurit pas personit i cili është udhëtar?

Lejohet që vendësi (*mukimi*) të falet pas imamit që është udhëtar (*musafir*) pavarësisht nëse është koha e namazit apo ka kaluar koha e tij. Kur ndodhë që udhëtari të bëhet imam duhet t'i paralajmërojë xhematin se është udhëtar dhe se ata që janë vendës duhet të vazhdojnë namazin deri në fund. Se duhet paralajmëruar xhematin kemi argument rastin kur Pejgamberi s.a.w.s. në vitin e çlirimit të Mekkes, ishte bërë imam dhe kishte shkurtuar namazin, por banorëve të Mekkes u kishte

thënë: (أَتَمُّوا صَلَاتَكُمْ يَا أَهْلَ مَكَّةَ فَإِنَّا قَوْمٌ سَفَرٌ) “*Plotësoni namazin tuaj o banorë të Mekkës, se ne jemi udhëtarë*”.¹²⁶

Musaliu i cili është falur pas imamit udhëtar, kur t’i plotësojë dy rekatet e fundit nuk duhet të lexojë asgjë derisa të jetë në *kijam*, por do të qëndrojë në heshtje sikur të ishte pas imamit, ose mund vetëm ta mendojë *fatihanë*, por jo edhe ta lexojë në mënyrë që të mos e humb koncentrimin në namaz.

Norma e të falurit të udhëtarit pas vendësit?

Lejohet që udhëtari të falet pas vendësit, mirëpo *musaliu* udhëtar në këtë rast doemos duhet ta ndjekë imamin deri në fund të namazit dhe nuk i lejohet ta shkurtojë namazin. Po që se *musaliu* udhëtar dëshiron të falet pas vendësit, por koha e namazit ka kaluar, nuk i lejohet udhëtarit të falet pas vendësit.

Disa rregulla që kanë të bëjnë me namazin e udhëtarit

1. *Vaxhib* është që namazet katër *rekatësh* të shkurtohen në dy *rekate*.

2. Të shkurtuarit e namazit vlen vetëm për namazet *farze* që janë katër *rekatësh*, ndërsa për *farzin* e akshamit që është tri *rekate*, *vitrin* dhe namazet *sunnete*, të shkurtuarit e namazit nuk lejohet.

3. Kur udhëtari e bën *nijjet* që ta falë drekën, ikandinë apo jacinë nga katër *rekate*, por, duke u falur i kujtohet se është udhëtar, i tilli në këtë rast do t’i falë nga dy *rekate* pavarësisht nga *nijjeti* se si e ka shprehur.

¹²⁶ Transmeton Ebu Davudi dhe Tirmidhiu

4. E nëse udhëtari harron se duhet ta shkurtojë namazin dhe e falë të plotë, namazi në këtë rast konsiderohet i vlefshëm. Po që se *musaliu* është ulur në uljen e parë, atëherë dy *rekatet* e mbrama konsiderohen namaz *nafile*, ndërsa, nëse harron të ulet në uljen e parë atëherë, namazi i tillë konsiderohet krejtësisht si *nafile* dhe *farzin* duhet doemos ta falë edhe një herë.

5. Kur ndodhë që udhëtarit i kalon ndonjë namaz pa e falur, atij nuk i lejohet të bëjë *kaza* pas atij që është vendës edhe nëse kategoria dhe namazi janë të njëjtë, f.v., udhëtarit i ka kaluar pa e falur drekën, po ashtu edhe vendësit i ka kaluar pa e falur drekën, në këtë rast udhëtari nuk mund të falet pas vendësit.

6. Po që se ndodhë që udhëtari duke u falur e bën *nijjet* që të qëndrojë pesëmbëdhjetë ditë e më tepër atëherë, i tilli, namazin e falë të plotë, d.t.th., nuk e shkurton.

7. Nëse ndodhë që namazi i kalon pa u falur, atëherë namazi i tillë duhet të bëhet *kaza* ashtu si ka mbetur pa u falur, f.v., nëse *musaliut* i ka kaluar pa falur dreka duke qenë vendës, i tilli nëse është udhëtar duhet të bëjë *kaza* katër *rekate*, apo anasjelltas, nëse ndodhë që t'i kalojë ndonjë namaz pa e falur duke qenë udhëtar, i tilli kur ta bëjë *kaza* duhet ta bëjë të shkurtuar.

8. Po që se që dikush ka familje në dy vende dhe distanca në mes atyre është aq sa njeriu mund të konsiderohet udhëtar, ndërsa në të dy vendet konsiderohet vendës (*mukim*).

9. Kur ndodhë që dikush është vendas (*mukim*) në një vend, por punon në ndonjë vend të largët dhe ky blen shtëpi tek ai vend, në këtë rast i tilli në vendin ku ka blerë shtëpinë konsiderohet udhëtar përveç nëse

vendos të qëndroj në atë vend pësëmbëdhjetë ditë e më tepër.

NAMAZI I ZËNIES SË DIELLIT

صَلَاةُ الْكُسُوفِ

Namazi i zënies së diellit përbëhet prej dy *rekateve*. Ky namaz është *sunneti muekkede* dhe për këtë lloj namazi nuk thirret *ezan* e as nuk bëhet *ikamet*. Mund të falet vetëm por edhe me xhemat. Nëse dëshirohet të falet namazi i tillë me xhemat, kërkohet imami i cili mund ta falë namazin e xhumasë, d.t.th., imami të ketë autorizim. Po ashtu duhet që në çdo *rekat* të lexohet *fatihaja* dhe një *sure*, pa zë. Duhet të lexohet gjatë dhe të rrihet gjatë si në *ruku* ashtu edhe në *sexhde*, e pastaj të bëhet *dua* derisa të kaloje zënia e diellit. Kur të bëhet *dua*, xhemati duhet të jenë të kthyer nga *kibla* dhe mund të qëndrojnë ulur por edhe në këmbë, por më mirë është të qëndrohet në këmbë. Nëse ndodhë që nuk gjendet imami, namazi i tillë mund të falet vetëm nëpër shtëpi dhe se kur falet vetëm mund të falet dy *rekatesh* dhe katër *rekatesh*. Ky namaz nuk lejohet të falet në kohët kur është *mekruh* por mjafton të bëhet vetëm *dua*.

NAMAZI I ZËNIES SË HENËS

صَلَاةُ الْخُسُوفِ

Ky namaz është *sunnet* jo i fortë (مسنودة), falet vetëm nëpër shtëpi dhe mund të falet nga dy dhe katër *rekate* dhe në fund të namazit bëhet *dua*.

NAMAZI NË LUFTË- NAMAZI I FRIKËS

الصَّلَاةُ فِي الْحَرْبِ \ صَلَاةُ الْخَوْفِ

Kur muslimanët gjenden në luftë duhet ta falin namazin, por me disa rregulla të veçanta. Prijësi i muslimanëve duhet ta ndajë ushtrinë në dy grupe, njëri grup duhet të falen ndërsa grupi tjetër të bëjnë roje që të mos rrezikohen befas nga armiku. Ky lloj i namazit mund të falet kështu: *pasiqë imami ta ndajë ushtrinë në dy grupe, njëri grup falet e tjetri bën roje; grupi i cili është duke u falur me imamin, nëse është namazi sabahut, së pari e falin vetëm një rekat, e nëse është namazi katër rekatësh apo tre rekatësh, ky grup i falin nga dy rekate me imamin dhe shkojnë, pastaj vjen grupi tjetër, i bashkohet imamit dhe i falin rekatet të cilat kanë mbetur, pastaj imami jep selam vetëm, ndërsa grupi i dytë shkon në roje e grupi i parë vjen dhe i plotësonë rekatet e mbetura duke mos lexuar as fatihanë e as suren, por veprojnë sikur të ishin **lahikë**. Pasi t'i kenë plotësuar rekatet e mbetura duhet të japin selam dhe të shkojnë në rojë. E pastaj grupi i dytë vjen dhe i plotëson rekatet e mbetura, të tillët duhet të lexojnë fatihanë dhe suren, d.t.th. do të veprojnë sikur **mesbuki**. Për të dy grupet, lejohet që rekatet e mbetura t'i plotësojnë në atë vend ku janë falur me imamin apo në vendin ku janë duke qëndruar. Gjithashtu lejohet që një grup ta falë namazin deri në fund me imam, e pastaj grupi tjetër me imam tjetër ta falë namazin deri në fund. Kur ndodhë që lufta të jëtë ashpërsuar dhe është e pamundur të formohet xhemati, atëherë secili duhet ta falin namazin vetmas në betejë, nëpër hendeqe, duke ecur, hipur në ndonjë mjet të kthyer nga armiku edhe nëse armiku nuk është në drejtim të kiblës, ngase në rast të tilla nuk kërkohet kushti për t'u kthyr nga kibla.*

Rekomandohet (mustehab) që arma të mbahet me vete duke u falur.

NAMAZI I SHIUT

صَلَاةُ الْإِسْتِسْقَاءِ

Allahu xh.sh. nganjëherë e ndal shiun apo e pakëson rënien e tij dhe kështu shkaktohet shkatërrimi i të mbjellave dhe i gjallesave, e kjo, në rastet e shumta, shkaktohet për shkak të veprimeve të këqija nga njerëzit. Mu për këtë, të penduarit dhe të kërkuarit falje është kusht thelbësor për t'u falur namazi i shiut, dhe se pendimi dhe kërkimi i faljes janë elementet kryesore që Allahu xh.sh. t'i përgjigjet *duasë* së robërve. Për këtë Allahu xh.sh. thotë:

(فَقُلْتُ اسْتَغْفِرُوا رَبَّكُمْ إِنَّهُ كَانَ غَفَّارًا يُرْسِلُ السَّمَاءَ عَلَيْكُمْ مِدْرَارًا)

*“Unë u thashë: “Kërkoni falje Zotit, se vërtetë Ai falë shumë. Ai ju lëshon shi nga qielli me bollëk”.*¹²⁷

Ky namaz i ka dy *rekate* dhe mund të falet vetëm po edhe me xhemat, po ashtu mund të bëhet vetëm *istigfar*, *dua*, të falënderohet Zoti dhe të lartësohet Ai. Kur namazi i tillë falet me xhemat imami duhet të lexojë me zë, nuk këndohet *ezan* dhe as nuk bëhet *ikamet*, e pastaj e mban *hutben* duke iu përkujtuar rëndësinë e *istigfarit* dhe *tevbës*. Kur ta kryejë *hutben* imami kthehet nga *kibla* dhe i kthen rrobat mrapsht, e lut Allahun dhe kërkon falje për besimtarët.

Rekomandohet që gjatë këtij namazi të veprohet kështu:

¹²⁷ Nuh: 10-11

1. Të dilet tri ditë vazhdimisht në shkretëtirë ose në fushë, përveç në Mekkë, Medinë dhe Kuds, se në këto tri vende njerëzit duhet të mblidhen në *Harem*.

2. Të dalin njerëzit duke ecur në këmbë, me rroba të vjetra dhe koka të ulura sepse më këtë veprim shprehet devotshmëria dhe modestia para Allahut xh.sh.

3. T'u jepet *sadaka* të varfërve para se të dilet për namaz dhe njerëzit sa më shumë të bëjnë *tevbe*.

4. Të merren kafshët me të vegjlit e tyre, të moshuarit, fëmijët, bile edhe fëmijët që janë në gji dhe kështu të ndahen fëmijët nga nënat dhe të vegjlit e kafshëve nga nënat e tyre.

5. Të këndohet kjo *dua*:

(اللَّهُمَّ اسْقِنَا غَيْثًا مُغِيثًا مَرِيئًا مَرِيئًا نَافِعًا غَيْرَ ضَارٍّ عَاجِلًا غَيْرَ آجِلٍ)

“O Zoti ynë, lëshona shiun që të jetë shpëtim, të mjaftueshëm, të begatshëm, produktiv dhe të dobishëm e jo të dëmshëm, të mënjëhershëm, e jo të vonuar”. Mund të këndohet edhe kjo *dua*:

الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ يَفْعَلُ مَا يُرِيدُ
اللَّهُمَّ أَنْتَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ ، أَنْتَ الْغَنِيُّ وَ نَحْنُ الْفُقَرَاءُ ، أَنْزِلْ عَلَيْنَا الْغَيْثَ وَاجْعَلْ
مَا أَنْزَلْتَ لَنَا قُوَّةً وَ بَلَاغًا إِلَى حِينٍ

NAMAZI NË ANIJE, TREN, AEROPLAN, AUTOBUS DHE HIPUR MBI KALI APO DEVE

الصَّلَاةُ فِي السَّفِينَةِ وَ فِي الْقَطَارِ وَ فِي الطَّائِرَةِ وَ عَلَى الْفَرَسِ أَوْ الْجَمَلِ

Nuk lejohet që në namazet *farze e vaxhibe* të lëshohet qëndrimi në këmbë (*kijami*), përveç kur ka arsye të justifikueshme sipas Sheriatit. Personi i cili është hipur mbi shtazë apo në ndonjë mjet udhëtimi, si f.v., tren, anije etj. duhet të zbresë dhe ta falë namazin

duke i plotësuar të gjitha *shartet* dhe *ruknet* e namazit. Por kur ndodhë që *musaliu* nuk mund të zbresë nga shtaza apo mjeti i udhëtimit, ai do të falet hipur si në shtazë apo në mjet. F.v. kalorsi do të falet hipur mbi shtazë nëse ka frikë se pasi të zbresë nuk do të mund të hipë për shkak të ashpërsisë së shtazës, ka frikë nga hajnat apo huliganët që i paraqesin rrezik për vete, plaçkat apo kalin (devenë, gomarin etj.), nga frika prej egërsirave ose nga balta e madhe.

Sa i përket namazit në anije, tren, autobus, aeroplan etj. namazi do të falet ashtu si mundet. Po që se në këto mjete ka mundësi të falet në këmbë duhet doemos të falet në këmbë, e nëse nuk ka mundësi, do të falet ulur. *Musaliu* në tren, anije etj. është i detyruar të kthehet drejt kibles nëse i jepet mundësia, e po që se ndodhë që duke u falur, anija, treni etj. ndërrojnë drejtimin, *musaliu* duke u falur do të kthehet prap nga *kibla*, e nëse ndodhë që nuk mund të drejtohet nga *kibla* i tilli do të falet nga cila anë të mundet.

NAMAZI I TË SËMURIT

صَلَاةُ الْمَرِيضِ

Sëmundja është një proces që e godet njeriun dhe ndikon në plogështinë e fuqisë fizike të tij. Allahu xh.sh. me vendosjen e rregullave të fesë ka përcaktuar se *mukelefi* nuk është i stërngarkuar, por kur ndodhë që njeriu të ketë arsye të justifikueshme sipas Sheriatit, atëherë vijnë në shprehje lehtësimet nga Ligdhënësi i vetëm- Allahu xh.sh.

Para se të hyhet në shpjegimin e namazit të të sëmurit do t'i përmendim disa rregulla që kanë të bëjnë më të sëmurin, ato janë:

1. Kur *mukel-lefi* merr *abdest*, por, ndonjë pjesë e trupit do të dëmtohet apo do t'i keqësohet gjendja, atëherë i tilli në këtë rast vetëm do t'i japë *mes'h* asaj pjesë të trupit. E nëse edhe dhënia *mes'h* e dëmton, atëherë nuk duhet dhënë fare *mes'h*.

2. Kur t'i jepet *mes'h* vendit të sëmure mjafton që dora të jetë vetëm e lagur duke mos insistuar që uji të pikë nga dora.

3. Nëse ndodhë që i sëmuri duhet doemos të pastrohet, atëherë i tilli nuk do t'i lagë pjesët e trupit që i ka të sëmura por vetëm do t'u japë *mes'h*.

4. Kur ndodhë që i sëmuri nuk guxon të pastrojë trupin, sepse nëse pastrohet do t'i keqësohet gjendja, i tilli nuk do të pastrohet por vetëm do të marrë *tejemum*.

5. Nës ndodhë që të sëmurin nuk e dëmton përdorimi i ujit, por dëmtohet nga lëvizjet për t'u pastruar apo për të marrë *abdest*, do të marrë vetëm *tejemum*.

6. Nëse ndodhë që *mukel-lefi* e ka të thyer dorën apo ndonjë pjesë tjetër të trupit, dhe e ka të mbështjellur me ndonjë material që nuk e dëmton si, f.v., gipsi, lejohet që uji ta përshkojë atë pjesë, pavarësisht nëse *mukel-lefi* merr *abdest* apo pastrohet. Por, nëse ndodhë që e ka ndonjë material të cilin e dëmton uji, atëherë mjafton vetëm dhënia *mes'h*, e nëse edhe *mes'hi* e dëmton, atëherë nuk jepet as *mes'h*.

7. Nëse ndodhë që i sëmuri në plagën që ka, ka gjak të mbledhur, dhe nëse e heq, do t'i dëmtohet plaga, i tilli do të falet pa e hequr fare atë gjak të mbledhur. E nëse

ndodhë që largimi i gjakut nuk e dëmton plagën, por pas pastrimit paraqitet gjaku sërisht, edhe në këtë rast gjaku i mbledhur nuk duhet të lahet e as të largohet.

Mënyra e të falurit nga i sëmuri

Kemi përmendur më lart se normat apo dispozitat e Sheriatit nuk janë stërngarkesë dhe kur ndodhë që *mukel-lefti* nuk mund t'i zbatojë ato për arsye të justifikueshme, atëherë vjen në shprehje lehtësimi. Kur ndodhë që i sëmuri nuk mund të qëndrojë në këmbë ose frikësohet që, nëse qëndron në këmbë do t'i keqësohet sëmundja, i tilli ka të drejtë të falet ulur. I sëmuri, kur falet ulur *rukun* do ta kryejë duke u kërrusur pak, ndërsa *sexhden* do ta bëjë normalisht. Po që se ndodhë që i sëmuri nuk mund të bijë në *sexhde*, atëherë do të kërruset pak me tepër për *sexhde* e pak më pak për *ruku*. Po nëse i sëmuri nuk mund të qëndrojë as ulur, ai do të falet i shtrirë në krah apo i shtrirë në shpinë, në krah është më e preferuar dhe këmbët duhet drejtuar nga *kibla* pastaj do të falet duke e levizur kokën. Në këtë rast është *mustehab* të ngrihen gjunjë dhe po ashtu t'i vendoset një jastëk nën kokë që të drejtojë fytyrën nga *kibla*. Nëse i sëmuri nuk mund të bëjë lëvizje me kokë, atëherë nuk e falë namazin por e le që ta bëjë *kaza* pasi t'i ketë kaluar sëmundja, e po që se ndodhë që sëmundja t'i zgjasë aq sa t'i kalojnë mbi pesë kohë të namazit pa i falur, i tilli, namazet e kaluara nuk do t'i bëjë *kaza*.

Shënim: Nëse dikush është i sëmurë në atë gjendje sa që vetë nuk është në gjendje të marrë *abdest*, as të lëvizë nga shtrati, as t'i ndërrojë rrobat, e as të drejtohet nga *kibla*, i tilli, sipas imam Ebu Hanifes r.a.

duhet të marrë *tejemum* në vend të *abdestit* apo pastrimit dhe të falet me ato rroba që i ka të veshura. Ndërsa, sipas dy imamëve Ebu Jusufit dhe Muhammedit r.a., nëse ka mundësi që dikush t'i ndihmojë të marrë *abdest* apo të pastrohet, duhet të marrë *abdest*, të pastrohet dhe të falet, e nëse nuk ka kush t'i ndihmojë, atëherë vetëm merr *tejemum* dhe falet.

RREGULLAT E XHENAZES DHE NAMAZI I TË VDEKURIT

أَحْكَامُ الْجَنَائِزِ وَصَلَاةُ الْجَنَازَةِ

Vdekja është një proces natyror të cilit i nënshtrohet çdo krijesë e gjallë. Për këtë Allahu xh.sh. thotë: (كُلُّ نَفْسٍ (دَائِقَةُ الْمَوْتِ) “Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen...”¹²⁸

Vdekja si fenomen nganjëherë vjen befasisht e nganjëherë vërehen parashenjat e saj. Pa dyshim vdekja mjafton që njeriu të marrë mësim që askend të mos e dëmtojë, të mos bëjë mëkate, të mos gënjejë, të mos tradhëtojë etj. Për çudi pjesa më e madhe e njerzëve nuk marrin mësim edhe pse para syve të tyre kryhet një proces apo fenomen i tillë.

Feja islame parasheh rregulla të cilat duhet t'i zbatojnë muslimanët për personin i cili gjendet në momentet e vdekjes dhe po ashtu parasheh rregulla që duhet të zbatohen edhe pas vdekjes se njeriut. Si rregulla të parapara janë:

¹²⁸ Ali Imran: 185

1. التَّجْهِيزُ - Veprimet që duhet të zbatohen për personin që është në agoni të vdekjes dhe menjëherë pas vdekjes së tij.
2. التَّغْسِيلُ - Pastrimi i personit të vdekur.
3. التَّكْفِينُ - Të veshurit me qefin.
4. الصَّلَاةُ عَلَيْهِ - Të falurit e namazit personit të vdekur.
5. الْحَمْلُ - Të barturit e kufomës.
6. الدَّفْنُ - Të varrosurit e kufomës.

Veprimet që duhet të zbatohen për personin që është në agoni të vdekjes dhe menjëherë pas vdekjes së tij.

التَّجْهِيزُ

1. Personi që është në agoni të vdekjes është e rekomanduar që ta shtrijmë në krah nga ana e djathtë dhe i drejtuar nga *kibla*, nëse kjo është e mundur. E nëse nuk mund të kthejmë në krah nga ana e djathtë atëherë duhet lënë shtrirë në shpinë në atë mënyrë që koka t'i ngritet pak me jastuk dhe këmbët t'i ketë të shtrira nga *kibla*. E kur ndodhë që këto veprimet vështirë të zbatohen, atëherë i vdekuri duhet të lënë në atë gjendje çfarë gjendet në ato momente.

2. Sunnet është që personi që është në agoni të vdekjes t'i përkujtohet qetë *shahadeti*. Për këtë mund të përmendim *hadithin* e Pejgamberit s.a.w.s.:

لَقِّنُوا مَوْتَكُمْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ فَإِنَّهُ لَيْسَ مُسْلِمٌ يَقُولُهَا
(عِنْدَ الْمَوْتِ إِلَّا أُنْجَاهُ اللَّهُ مِنَ النَّارِ)

“Shprehjuni atyre që janë në agoni të vdekjes *shahadetin*, ngase nuk ka musliman që në momentet e

vdekjes e shpreh këtë e që Allahu të mos e shpëtojë prej Xhehhennemit".¹²⁹

3. Rekomandohet që të afërmit, miqtë dhe fqinjët të jenë afër atij që është në agoni të vdekjes dhe që mundësisht t'ia lexojnë suren "**Jasin**". Disa nga *muxhtehidët* e mëvonshëm preferojnë që të lexohet edhe sureja "**Err-Rr'ad**".

4. Preferohet dhe rekomandohet që personit i cili është në agoni të vdekjes nga pak t'i lagën buzët me ujë të ftohtë.

5. Kur personi vdes duhet t'i mbyllën sytë, i mbyllet goja dhe i drejtohen duart drejt anash, duhet të mbulohet me ndonjë çarçaf dhe duhet t'i vendoset në bark diçka që të mos i enjtet barku.

6. Ai i cili ia mbyll sytë preferohet të lexojë këtë dua:

بِسْمِ اللَّهِ وَعَلَىٰ مِلَّةِ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ ، اللَّهُمَّ يَسِّرْ عَلَيْهِ أَمْرَهُ وَسَهِّلْ عَلَيْهِ مَا بَعْدَهُ ، وَأَسْعِدْهُ بِلِقَائِكَ وَأَجْعَلْ مَا خَرَجَ إِلَيْهِ خَيْرًا مِمَّا خَرَجَ عَنْهُ

7. *Mustehab* është që njerëzit të lajmërohen për vdekjen e personit, më qëllim që sa më shumë të marrin pjesë në faljen e namazit dhe në varrimin e të tij.

8. Sunnet është që nëse i vdekuri ka pasur borxh, t'i paguhet borxhet, ngase për këtë Pejgamberi s.a.w.s. ka thënë: (نَفْسُ الْمُؤْمِنِ مُعَلَّقَةٌ بِدَيْنِهِ حَتَّىٰ يُقْضَىٰ عَنْهُ) "*Shpirti i besimtarit është i varur me borxhin e tij, derisa të paguhet ai*".¹³⁰

¹²⁹ Transmetojnë të gjithë përveç Buhariut.

¹³⁰ Transmeton Ahmedî dhe Tirmidhiu.

9. Për personin e vdekur duhet folur vetëm fjalë të mira dhe duhet përmendur vetëm të mirat e tij. Për këtë Pejgamberi s.a.w.s. ka thënë:

(إِذَا حَضَرْتُمْ الْمَيِّتَ فَقُولُوا خَيْرًا فَإِنَّ الْمَلَائِكَةَ يُؤْمِنُونَ عَلَى مَا تَقُولُونَ)

“Kur jeni pran të vdekurit, folni mirë se vërtetë melekët i thonë “**amin**” asaj çka ju flisni”.

Pastrimi i personit të vdekur

التَّغْسِيلُ

Pastrimi i të vdekurit është *farzi kifaje* d.t.th., nëse ndonjëri prej muslimanëve e zbaton të tjerët janë të liruar nga ky obligim.

Mënyra e pastrimit të të vdekurit është : *i vdekuri do të vendoset mbi teneshir ose mbi ndonjë dërrasë, duhet mbuluar pjesët e turpshme dhe t'i çveshen rrobat e pastaj me një leckë t'i pastrohen pjesët e turpshme- t'i jepet istinxha, e pastaj do t'i jepet abdest duke mos i futur ujë në gojë dhe hundë, përveç nëse është xhunub apo me hajz dhe nifas, atëherë i lahet goja dhe hunda. Pasi t'i jepet abdest, të lahet me ujë të ngrohtë, nëse ka, përndryshe mund të lahet edhe me ujë të rëndomtë. Në fillim i lahet koka me sapun që ka erë të mirë e pastaj i vdekuri mbështetet në krahun e majtë që t'i lahet ana e djathtë aq sa uji ta përfshijë edhe shpinën, e mandej mbështetet në krahun e djathtë për t'iu larë ana e majtë. Ai i cili e lanë xhenazen do ta drejtojë pak xhenazen (në pozitë ulur) duke e mbajtur me dorë ose me gju dhe me dorën tjetër ia lëmon barkun. Kur ndodhë që të*

rrjedhë diçka, nuk ka nevojë të përsëritet larja dhe abdesti por duhet vetëm të shpërlahet. Kur t'i pastrohen pjesët e turpshme, duart do të mbështillen me ndonjë harrën ose dorëza . Mënyra e shpjeguar e larjes do të përsëritet tri herë e pastaj do të fshihet me ndonjë peshqir.

Disa rregulla që kanë të bëjnë me pastrimin e xhenazes

1. Më së miri është që të vdekurin ta lajë i afërmi i tij, e nëse nuk ka të tillë atëherë duhet ta lajë ndonjë person që njihet si i devotshëm dhe besnik, i cili, edhe po që se sheh diçka jo të zakonshme tek i vdekuri, nuk do t'ua kumtojë të tjerëve.

2. Nuk duhet t'i priten thonjtë, as t'i shkurtohen flokët dhe mjekra. Po ashtu as nuk duhet t'i krihen flokët dhe mjekra, ngase pas të gjitha këtyre i vdekuri do të mbështillet me *qefin* dhe më nuk ka nevojë për zbukurim.

3. Nëse ndodhë që nuk ka pasur ujë dhetë vdekurit i është dhenë *tejemum*, e, i është falur namazi, ka ardhur uji, atëherë duhet të pastrohet dhe prapë t'i falet namazi.

4. Atij të cilit i është enjtur barku mjafton që në bark t'i hudhet vetëm ujë.

5. Gruaja mund ta lajë bashkëshortin e saj, kurse burri nuk mund ta lajë bashkëshorten e tij. Nëse ndodhë që gruaja është shkurorëzuar para vdekjes me

shkurorëzim të përhershëm (*bain*), nuk lejohet që ta pastrojë dhe ta shikojë atë.

6. Fëmijën e vdekur, pavarësisht nga gjinia dhe që ende nuk ka hyrë në moshën madhore, lejohet ta lajnë edhe mashkulli edhe femra.

7. Nëse ndodhë që të vdes femra në mesin e meshkujve, atëherë duhet dhënë vetëm *tejemum* me ndonjë leckë, apo, nëse ndodhë që mashkulli të vdesë në mesin e femrave, të tillit i jepet vetëm *tejemum* me ndonjë leckë. Po që se në mesin e meshkujve apo femrave ka ndonjë që është i afërm, mund t'i japë *tejemum* të vdekurit pa e përdorur fare leckën.

8. Lejohet të përqafohet dhe të uthet i vdekuri. Për këtë mund të përmendim transmetimin e Aishes r.a. e cila tregon: (أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَبَلَ عُثْمَانَ بْنِ مَطْعُونٍ وَهُوَ مَيِّتٌ) “Vërtetë Pejgamberi s.a.w.s. e ka uthur Uthman bin Medh’unin i cili ishte i vdekur”.¹³¹

9. Lejohet të qahet për të vdekurin, por nuk lejohet të vajtuarit për të.

10. Nuk lejohet t'i thyhen eshtrat të vdekurit. Për këtë Pejgamberi s.a.w.s. ka thënë:

(كَسْرُ عَظْمِ الْمَيِّتِ كَكْسْرِهِ حَيًّا) “Thyerja e eshtrave të të vdekurit është sikur t'i thyhen duke qenë gjallë”.¹³²

11. Kur ndodhë që personi është djegur dhe është frika se po që se lahet me fërkim, do t'i copëtohet trupi, atëherë mjafton që vetëm t'i hudhet uji. E nëse edhe hudhja e ujit e copton kufomën, atëherë do t'i jepet vetëm *tejemum*.

¹³¹ Transmeton Termidhiu

¹³² Transmeton Ebi Davudi

12. Obligim është që *avreti* t'i mbulohet të vdekurit, sepse nuk lejohet shikimi e as prekja e *avretit*. Po ashtu është obligim që të mbështillet dora me ndonjë leckë kur t'i pastrohet *avreti*.

Të veshurit me qefin

التَّكْفِينُ

Të mbështjellurit e të vdekurit me *qefin* është *farzi kifaje*. Sipas numrit të copave të *qefinit* ai ndahet në tri grupe:

1. *qefini sunnet* (سُنَّةٌ),
2. *qefini i domosdoshëm* (ضَرُورَةٌ), dhe
3. *qefini i mjaftueshëm* (كِفَايَةٌ).

Qefini sunnet te mashkulli përbëhet prej tri pjesëve:

a. الْقَمِيصُ - **këmisha**. Kjo këmishë duhet të jetë e gjatë prej qafës e deri tek këmbët, por pa krihë.

b. الْإِزَارُ - **izari**. Ky është një çarçaf i gjatë prej kokës e deri tek thembrat e kembëve.

c. اللَّفَافَةُ - **lifafi**. Ky është një çarçaf më i gjatë se *izari*, me të cilin mund të mbështillet i tërë trupi i kufomës dhe i cili mund të lidhet mbi kokë dhe nën këmbë.

Sa i përket *qefinit sunnet*, tek femra, ai, përbëhet prej pesë pjesëve, tri pjesët e para janë të njëjta me të mashkullit, ndërsa dy pjesët e tjera janë:

a. lidhësja e flokëve, dhe

b. pëlhura e cila përdoret për t'ia lidhur femrës së vdekur krahërorin.

Qefini i domosdoshëm është nga çka dhe me çfarë mund të mbështillet i vdekuri.

Qefini i mjaftueshëm është ai *qefin* i cili për mashkullin përbëhet prej *izarit* dhe *lifafit*, ndërsa tek femra përbëhet prej *lifafes*, *izarit* dhe *lidhëses së flokëve*.

Mënyra e veshjes së qefinit

Në fillim duhet të shtrohet *lifafi*, pastaj *izari*, mandej këmisha e cila i vishet të vdekurit, pastaj i palohet *izari*, së pari në anën e majtë e pastaj në anën e djathtë dhe kështu duhet të veprohet edhe me *lifafin*, në mënyrë që *lifafin* mund ta lidhim që të mos shpalohet. Ndërsa sa i përket veshjes së *qefinit* tek femra është e njëjtë sikur tek mashkulli, por, përjashtimi është se femrës flokët do t'ia ndajmë në dy pjesë dhe do t'ia shtrijmë në krahëror dhe mbi këmishë (*nëse janë të gjata*), pastaj vjen lidhësja e flokëve e cila shtrihet mbi këmishë nën *lifafi* dhe nën *izar*, e pastaj do t'i lidhet dizga që të mos hapet qefini.

Shënim: *Qefini* mund të jetë prej materialit të pambukut, lirit, leshit etj, kurse për femra mund të jetë prej mëndafshit, por më mirë është të jetë prej pambukut. Ngjyra e *qefinit* mund të jetë çfarëdo, por ngjyra më e preferueshme është ngjyra e bardhë. *Qefini* mundet të jetë pëlhurë e bartur, por më rendësi është që të jetë e pastër.

Të falurit e namazit të xhenazes

صَلَاةُ الْجَنَازَةِ

Të falurit e namazit të *xhenazes* është *farzi kifaje* dhe duhet të falet me xhemat. Edhe namazi i *xhenazes* ka kushtet, pjesët përbërëse, *vaxhibet* dhe *sunnetet* e veta.

Kushtet e namazit të xhenazes

شُرُوطُ صَلَاةِ الْجَنَازَةِ

1. - أَنْ يَكُونَ الْمَيِّتُ مُسْلِمًا. Që i vdekuri të jetë musliman. Namazi i xhenazes i falet vetëm muslimanit, ndërsa jomuslimanit nuk i falet kurrësesi, ngase namazi i *xhenazes* është lutje për ta falur Allahu xh.sh. dhe për ta shpërblyer me begatitë e Tij, kështu që një lutje e tillë nuk lejohet të bëhet për jomuslimanin.
2. - أَنْ يَكُونَ الْمَيِّتُ طَاهِرَ الْبَدَنِ وَالْكَفَنِ وَالْمَكَانِ. Që i vdekuri të jetë i pastruar, të jetë i mbështjellur me qefin dhe që vendi të jetë i pastër.
3. - أَنْ يَكُونَ الْإِمَامُ مُتَقَدِّمًا عَلَى الْمُصَلِّينَ. Që imami të jetë para xhematit.
4. - كَوْنُ الْمُصَلِّيِّ عَلَيْهَا غَيْرَ رَاكِبٍ وَغَيْرَ قَاعِدٍ إِلَّا مِنْ عُدْرٍ. Që *musaliu* të mos jetë hipur apo ulur, përveç nëse *musaliu* ka arsye të justifikueshme.
5. - أَنْ تُوَضَعَ الْجَنَازَةُ عَلَى الْأَرْضِ حِينَ الصَّلَاةِ عَلَيْهَا أَوْ مَالَهُ حُكْمُ الْأَرْضِ. Që xhenazeja të jetë e vendosur në tokë kur t'i falet namazi, apo të jetë e vendosur në ndonjë gurë apo diçka që konsiderohet si element i tokës. Nuk lejohet të falet namazi i *xhenazes* nëse *xhenazen* e mbajnë në dorë njerëzit apo qoftë e ngarkuar mbi ndonjë shtazë.
6. - أَنْ يَكُونَ الْمَيِّتُ حَاضِرًا أَوْ أَكْثَرَ بَدَنِهِ. Që i vdekuri të jetë i pranishëm ose pjesa më e madhe e trupit të tij. Nuk

mund t'i falet namazi i *xhenazes* kur personi nuk është i pranishëm ose kufoma nuk e ka pjesën më të madhe të trupit.¹³³ Kur është gjysma e trupit të *xhenazes* me ose pa kokë duhet t'i falet namazi.

Elementet e brendshme të namazit të *xhenazes*

أَرْكَانُ صَلَاةِ الْجَنَازَةِ

1. التَّكْبِيرَاتُ الْأَرْبَعُ - Katër tekbiret. *Tekbiri* i parë është edhe *shart* edhe *rukn*, ndërsa tri *tekbiret* tjera janë *rukn* i namazit.
2. الْقِيَامُ - Të qëndruarit në këmbë. Në namazin e *xhenazes* nuk ka *ruku*, *sexhde* dhe ulje.

Vaxhibet e namazit të *xhenazes*

وَاجِبَاتُ صَلَاةِ الْجَنَازَةِ

Namazi i *xhenazes* e ka vetëm një *vaxhib* e ai është të dhënit *selam* pas leximit të katër *tekbireve*.

Sunnetet e namazit të *xhenazes*

سُنُنُ صَلَاةِ الْجَنَازَةِ

Sunnetet e namazit të *xhenazes* janë:

¹³³ Sipas medh'hebit tonë namazi i *xhenazes* që nuk është i pranishëm nuk i falet dhe argumentojnë me atë se Pejgamberi s.a.w.s. kur ia ka falur namazin e *xhenazes* mbretit Nexhashij, ai ka pasur mundësi ta shohë *xhenazen* e Nexhashiut, ky veprim ka qenë një prej mu'xhizeve të Pejgamberit s.a.w.s. ngase për të ka qenë prezent Nexhashiu ndërsa për tjerët jo.

1. Që imami të qëndrojë drejt krahërorit të vdekurit dhe që xhemati të jenë prapa imamit. Të qëndruarit e imamit në këtë mënyrë duhet të jetë i njëjtë si te kufoma mashkull ashtu edhe të kufoma femër.

2. Pas *بَعْدَ التَّكْبِيرَةِ الْأُولَى أَنْ يَقْرَأَ الْإِمَامُ وَالْمُقْتَدُونَ دُعَاءَ الْقَنَاءِ* - Pas thënies së *tekbirit* fillestar duhet që imami dhe xhemati të lexojnë *subhaneken*.

3. Pas *بَعْدَ التَّكْبِيرَةِ الثَّانِيَةِ أَنْ يَقْرَأَ الْإِمَامُ وَالْمُقْتَدُونَ الصَّلَوَاتِ الْإِبْرَاهِيمِيَّةَ* - Pas *tekbirit* të dytë imami dhe xhemati duhet t'i lexojnë *salavatet*.

4. Pas *بَعْدَ التَّكْبِيرَةِ الثَّلَاثَةِ: الدُّعَاءُ لِلْمَيِّتِ وَ لِنَفْسِهِ وَ لِجَمَاعَةِ الْمُسْلِمِينَ* - Pas *tekbirit* të tretë duhet të lexohet duaja për të vdekurin, për vetveten dhe për të gjithë muslimanët.

Mënyra e të falurit të namazit të xhenazes

Të katër *tekbiret* e namazit të *xhenazes* janë si një *rekat*. Prej katër *tekbireve* vetëm në *tekbirin* e parë ngirhen duart tek veshët si nga ana imamit po ashtu edhe nga xhemati, ndërsa, në tre *tekbiret* e tjerë nuk ngirhen duart, por vetëm shqiptohet *tekbiri*.

Falja bëhet në këtë mënyrë:

1. Pasi të merret *tekbiri* i parë duke i ngritur duart deri tek veshet, lidhen duart dhe lexohet “**subhaneke**” dhe pas fjalës (تَعَالَى جَدُّكَ) duhet të lexohet fjala (جَلَّ ثَنَاؤُكَ). *Fatihaja* nuk lexohet.

2. Pasi të merret *tekbiri* i dytë pa i ngritur duart tek veshët, lexohen “*salavatet*”.

3. Pas *tekbirit* të tretë lexohet duaaja. *Duaaja* e cila preferohet të lexohet është kjo:

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِحَيِّنَا وَمَيِّتِنَا وَشَاهِدِنَا وَغَائِبِنَا وَصَغِيرِنَا وَكَبِيرِنَا وَذَكَرِنَا وَأُنثَانَا. اللَّهُمَّ مَنْ أَحْيَيْتَهُ مِنَّا فَأَحْيِهِ عَلَى الْإِسْلَامِ وَمَنْ تَوَفَّيْتَهُ مِنَّا فَتَوَفَّهُ عَلَى الْإِيمَانِ . وَخُصَّ هَذَا الْمَيِّتَ (هَذِهِ الْمَيِّتَةُ) بِالرُّوحِ وَالرَّاحَةِ وَالْمَغْفِرَةِ وَالرِّضْوَانِ . اللَّهُمَّ إِنْ كَانَ مُحْسِنًا (إِنْ كَانَتْ مُحْسِنَةً) فَرِّدْ فِي إِحْسَانِهِ (إِحْسَانِهَا) وَإِنْ كَانَ مُسِيئًا (إِنْ كَانَتْ مُسِيئَةً) فَتَجَاوَزْ عَنْهُ (عَنْهَا) وَلَقَّهِ الْأَمْنَ (لَقَّهَا الْأَمْنَ) وَالْبَشْرَى وَالْكَرَامَةَ وَالرُّؤْفَى بِرَحْمَتِكَ يَا أَرْحَمَ الرَّحِمِينَ

Duke u falur namazi i *xhenazes* së fëmijës, mund të lexohet kjo dua:

(اللَّهُمَّ اجْعَلْهُ لَنَا فَرَطًا اللَّهُمَّ اجْعَلْهُ لَنَا أَجْرًا وَذُخْرًا اللَّهُمَّ اجْعَلْهُ لَنَا شَفِيعًا وَمُشَفَّعًا)

4. Pas *tekbirit* të katërt menjëherë jepet *selam*.

Shënim: Imami vetëm *tekbiret* dhe *selamin* i shqipton me zë të lartë, ndërsa tjerat i lexon pa zë.

Disa rregulla që kanë të bëjnë me namazin e *xhenazes*

1. Kur ndodhë që i vdekuri të jetë varrosur pa iu falur namazi dhe pa u pastruar, duhet t'i falet namazi i *xhenazes*. E po që se i vdekuri nuk është mbuluar me dhe duhet të merret, të pastrohet dhe t'i falet *xhenazja*.

2. Po që se ndodhë që të tubohen shumë *xhenaze* mund t'u falet namazi një nga një, por edhe me një namaz mund t'u falet namazi i *xhenazeve*. Më e pranuar është ajo që namazi t'i falet secilit në vete.

3. Ai që është vonuar në namazin e *xhenazes* dhe i ka kaluar ndonjë *tekbir*, i tilli duhet t'i bëjë *tekbiret* e kaluar pasi që imami të japë *selam*.

4. Ai që arrin imamin në namazin e *xhenazes* pas *tekbirit* të katërt, por para se të japë *selam*, namazi i të tillit i ka kaluar dhe nuk ka mundësi për ta falur pasi imami të japë *selam*.

5. Ai që vdes në anije dhe toka është larg dhe, ekziston frika se mund të infektohem prej tij, i tilli duhet të lahet, të mbështillet me *qefin*, t'i falet namazi dhe të hudhet në det.

6. Kur ndokush që nuk ka *abdest* dhe kohën e ka të ngusht për të marrë *abdest*, të tillit i lejohet të marrë *tejemum*.

7. Të falurit e namazit të *xhenazes* brenda në xhami konsiderohet *mekruh*.

Disa rregulla që kanë të bëjnë me fëmijën që lind i vdekur

1. Nëse ndodhë që fëmija të lind para kohe dhe nuk vërehen disa pjesë të trupit, si, f.v., dora, këmba etj., por është vetëm copë mishi, të tilli nuk i falet namazi, as nuk pastrohet dhe nëna e cila e ka lindur nuk konsiderohet me *nifas*.

2. E po që se fëmija i cili ka lindur para kohës dhe kanë filluar t'i vërehen disa pjesë të trupit si, f.v., dora, këmba etj., por nuk i janë formuar krejtësisht, i tilli duhet të mbështillet dhe të varroset dhe nëna e cila e ka lindur konsiderohet me *nifas*.

3. Kur ndodhë që fëmija i cili ka lindur para kohe, por që gjitha gjymyrët i ka të krijuara, ose ka vdekur ende pa dalur jashtë pjesa më e madhe e trupit, fëmija i tillë duhet të lahet, të emërtohet, të varroset por namazi nuk duhet t'i falet.

4. Kur fëmija lind i gjallë, apo, pasi të ketë dalë pjesa më e madhe e trupit jashtë, ka vdekur, i tilli duhet të emërtohet, të lahet, të mbështillet me *qefin*, i falet namazi dhe trashëgohet.

Të barturit e kufomës

الْحَمْلُ

Të barturit e kufomës është *farzi kifaje*, ndërsa përcjellja e saj deri në varr është *sunnat* për burrat. *Mustehab* konsiderohet bartja e *xhenazes* disa hapa, pastaj të nxituarit për përgatitje dhe varrim, të ecurit prapa *xhenazes*, të qëndruarit në heshtje gjatë ecjes dhe rikujtimi i vdekjes. Pejgamberi s.a.w.s. për atë që e përcjell *xhenazen* ka thënë:

مَنْ شَهِدَ الْجَنَازَةَ حَتَّى يُصَلِّيَ عَلَيْهَا فَلَهُ قَبْرًاطٌ وَمَنْ شَهِدَهَا حَتَّى تُدْفَنَ
كَانَ لَهُ قَبْرًاطَانِ. قِيلَ وَمَا الْقَبْرَاطَانُ؟ قَالَ: مِثْلُ الْجَبَلَيْنِ الْعَظِيمَيْنِ

“Kush prezenton në faljen e *xhenazes* ai ka shpërblim një “kirat”, ndërsa kush prezenton edhe në varrimin e *xhenazes*, i tilli ka shpërblim dy “kirate”. I është thënë (Pejgamberit s.a.w.s.) çka janë dy “kirate”. E ai ka thënë: janë të njëjtë sa dy kodra të mëdha (shpërblim).”

Të varrosurit e kufomës

الدَّفْنُ

Kofoma do të varroset në tokë nga e cila edhe është krijuar. Varrri do të mihet thellë sa gjysma e shtatit të njeriut ose deri në krahëror, por sa më thellë që të jetë, është më mirë. Në fund të varrit do të bëhet një gropë në anën e *kibles* e cila quhet “*lahd*” në të cilën do të

vendoset i vdekuri dhe varri do të mbetet i zbrazur. I vdekuri duhet të lëshohet në varr i kthyer drejtë nga *kibla*¹³⁴ pastaj do t'i vihet pak dhe pas shpinës që i vdekuri të mbështet pak sa të mos bijë në shpinë, kurse ai i cili e lëshon duhet të thotë:

(بِسْمِ اللَّهِ وَعَلَى مِلَّةِ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ).

Pasi të jetë lëshuar i vdekuri duhet t'i zgjidhen lidhëset me të cilat është lidhur *qefini*. Pastaj gropa "*lahd*" do të mbyllet me qerpiç apo thupra e po që se nuk ka këso, atëherë çkadoqoftë. Tek ne i vdekuri thjeshtë lëshohet në varr i kthyer në anën e djathtë nga kibla, e pastaj mbulohet me dërrasa dhe hudhet dheu sipër.

Disa rregulla që kanë të bëjnë me varrimin

1. *Haram* është të ndërtohet diçka mbi varr për zbukurim dhe mburrje. Për këtë Pejgamberi s.a.w.s. ka thënë:

(نَهَى أَنْ يُجَصَّصَ الْقَبْرُ وَأَنْ يُقَعَّدَ عَلَيْهِ وَأَنْ يُبْنَى عَلَيْهِ)

"Ka ndaluar Pejgamberi s.a.w.s. që të ndërtohet me gjips varri (për dekorim), që të ulët mbi të dhe të ndërtohet (ndonjë ndërtesë) mbi të".¹³⁵

2. *Mekruh* është të varroset njeriu në shtëpi.

3. Lejohet që shumë veta të varrosen në një varr, por me kusht që secilit t'i vendoset nga pak dhe për t'u ndarë mes vete.

¹³⁴ Argument për këtë është transmetimi i Ibn Abbasit r.a. i cili thotë: (كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وَأَبُو بَكْرٍ وَعُمَرُ يُدْخِلُونَ الْمَيِّتَ الْقَبْرَ مِنْ قِبَلِ الْقِبْلَةِ "Pejgamberi s.a.w.s., Ebu Bekri dhe Umeri i shtinin të vdekurit në varr nga kibla").

¹³⁵ Transmeton Muslimi dhe Ahmedi.

4. Kur ndodh që kufoma është shkatërruar krjetësisht dhe është shndërruar në dhe, lejohet që mbi atë varr të varroset dikush tjetër.

5. Lejohet të shkruhet emri dhe mbiemri në ndonjë nishan.

6. Nuk lejohet që pasi të varroset, të zhvarroset dhe të bartet në ndonjë vend tjetër, përveç nëse ai është varrosur në truall të huaj.

7. Varri lejohet të rihapet kur dihet me siguri se në të ka rënë diçka me vlerë.

8. Varri nuk lejohet të rihapet nëse në varr vërtetohet se i vdekuri nuk është vendosur si duhet, f.v., nuk është kthyer nga *kibla* etj.

9. *Mendub* është që të vizitohen varrezat si nga ana e meshkujve ashtu edhe nga ana e femrave. Për këtë kemi si argument fjalët e Pejgamberit s.a.w.s. :

(كُنْتُ نَهَيْتُكُمْ عَنْ زِيَارَةِ الْقُبُورِ فَزُورُوهَا فَإِنَّهَا تُذَكِّرُ بِالْآخِرَةِ)

“Unë ua kam ndaluar t’i vizitoni varrezat, tash vizitoni ato se ua kujtojnë Ahiretin”¹³⁶.

10. Ai që i viziton varrezat duhet të lexojë këtë *dua*:
(السَّلَامُ عَلَيْكُمْ دَارُ قَوْمٍ مُؤْمِنِينَ وَإِنَّا إِن شَاءَ اللَّهُ بِكُمْ اللَّاحِقُونَ أَسْأَلُ اللَّهَ لِي وَلكُمْ)
(الْعَاقِبَةَ).

Të përgatiturit e ushqim për familjen e të vdekurit

صَنَعَ الطَّعَامِ لِأَهْلِ الْمَيِّتِ

Mustehab është që të afërmit dhe fqinjët e familjes së të vdekurit t’u përgatisin ushqim atë ditë familjes së

¹³⁶ Transmeton Muslimi dhe të tjerët.

të vdekurit. Për këtë si argument kemi hadithin e Pejgamberit s.a.w.s. i cili ka thënë: (اصْنَعُوا لآلِ جَعْفَرٍ طَعَامًا فَإِنَّهُ) (قَدْ جَاءَهُمْ أَمْرٌ يَشْغَلُهُمْ ”Përgatitni për familjen e Xha’ferit ushqim, ngase atyre u ka ardhur një gjë që i angazhon (për çështjen e përgatitjes së të vdekurit)”¹³⁷.

Mekruh është që familja e të vdekurit t'u përgatisë ushqim njerëzve, përveç nëse ndodhë që ndonjë mysafir është i largët dhe se nuk mund të kthehet në shtëpinë e tij.

Ngushëllimi

التَّعْزِيَةُ

Rekomandohet që anëtarët e familjes së të vdekurit të ngushëllohen, ngase ngushëllimi ua zbut mërzin dhe i qetëson shpirtërisht familjen e të vdekurit. Gjatë ngushëllimit duhet të përdoren shprehje të cilat kërkojnë faljen e të vdekurit dhe shtimin e durimit të atyre që janë gjallë. Preferohet që ditët e ngushëllimit të mos zgjasin më tepër se tri ditë, por përjashtim nga kjo bëjnë udhëtarët, të sëmurët dhe ata që kanë arsye të justifikueshme, të cilët kur të munden mund t'u shprehin ngushëllimin familjes së të vdekurit. Lejohet që ngushëllimi të bëhet si nga ana e meshkujve ashtu edhe nga ana e femrave, por duke mos u përzier mes vete. Është mirë që të bisedohet dhe të përmenden të mirat që i ka pasur i vdekuri gjatë jetës së tij dhe kurrësesi të mos përmenden të metat dhe të këqijat e të vdekurit.

¹³⁷ Transmeton Tirmidhiu , Davudi dhe Ibn Maxhe.

Shënim: Të mbajturit zi (الْحَدَادُ) për të vdekurin më shumë se tri ditë konsiderohet *mekruhi tahrimen*¹³⁸, përveç gruas së të vdekurit e cila duhet të mbajë zi derisa t'i kalojë *id'deti* i cili zgjatë katër muaj e dhjetë ditë. Gruaja kur është duke mbajtur zi i ndalohet t'i bëjë këto veprime:

1. Nuk i lejohet të zbukurohet me gjëra të çmueshme si ari, argjendi e të ngjashme.
2. Nuk mund t'i zbukurojë flokët, por lejohet që t'i krehë flokët vetëm e vetëm që të mos i shpushpuriten.
3. Nuk duhet të përdorë parfume.
4. Nuk duhet të përdorë rroba të shndritshme.

NAMAZI I SHEHIDIT

صَلَاةُ الشَّهِيدِ

Shehidi kategorizohet në tri kategori:

1. شَهِيدُ الْحَرْبِ وَ الْقِتَالِ فِي سَبِيلِ اللَّهِ تَعَالَى - Shehidi në luftë për hirë të Allahut xh.sh. I tilli, nëse është musliman, i mençur, në moshën madhore, i pastër nga *xhenabeti* dhe ka vdekur prej shkaktimit të plagës duke mos ngrënë e pirë asgjë. *Shehidi* i tillë nuk duhet të lahet, përveç nëse është goditur me ndonjë ndytësi përveç gjakut e nëse dihet se është i papastër, atëherë duhet të

¹³⁸ Për atë se nuk lejohet të mbahet zi më tepër se tri ditë e kemi argument trasnemtimit e Ummi Habibes r.a. të cilës i kishte vdekur babai, dhe pas tri dite kishte filluar të zbukurohet, r në këtë rast kishte thënë: “Nuk kam nevojë të zbukurohem, por këtë po e bëjë vetëm për atë se Pejgamberi s.a.w.s. ka thënë: (لَا يَحِلُّ لِامْرَأَةٍ تُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَ الْيَوْمِ الْآخِرِ أَنْ تَحِدَّ عَلَى مَيِّتٍ فَوْقَ ثَلَاثَةِ أَيَّامٍ إِلَّا عَلَى زَوْجِ أَرْبَعَةِ أَشْهُرٍ وَ عَشْرًا) “Nuk i lejohet një gruaje që beson në Zotin dhe në Ditën e Fundit që të mbajë zi për të vdekurin më shumë se tri ditë, përveç kur i vdes burri me ç'rast duhet të mbajë zi katër muaj e dhjetë ditë”. (Transmeton Buhariu).

lahet. Duhet t'i falet namazi dhe të varroset me rrobat e tij me gjak, përveç nëse ka ndonjë armë apo diç të vlefshme, duhet t'i hiqet prej rrobave. Nëse ndodh që ndokush nuk vdes në betejë ose, menjëherë pas betejës aq sa ka mundësi të hajë apo të pijë, i tilli duhet të lahet, të mbështillet me *qefin* dhe t'i falet namazi, por kjo nuk d.t.th. se i paksohet shpërblimi dhe kategoria e *shhidllëkut*.

2. الشَّهِيدُ الْمَقْتُولُ ظُلْمًا - Shehidi i mbytur pa të drejtë. Kur ndodhë që dikush të mbytet pa faj si f.v. i mbyturi nga kriminelët, hajnat etj. Me këtë lloj të *shhidit* veprohet njëjtë sikur me shehidin që mbytet në luftë.

3. الشَّهِيدُ الْمَيِّتُ بِحَوَادِثٍ أَوْ عَوَارِضٍ خَاصَّةٍ - Shehidi i cili ka vdekur për shkaqe normale. Në këtë lloj të *shhidëve* bënë pjesë ai që vdes nga përmytja, djegia, nga rënia e murit etj. Me këtë lloj të *shhidit* veprohet sikur me njerëzit e tjerë të zakonshëm, ky lloj i *shhidit* duhet të lahet, të mbështillet me *qefin* dhe i falet namazi *xhenazes*.

LITERATURA

1. Kemalud-din Muhammed bin Abdul Vahid es-Sivasi- Ibnul Humame el-Henfiju, FET'HUL KADIR, boton "Darul Fiker", Bejrut. pa vit. botimi.
2. Abdullah bin Mahmud bin Meudud el-Musiliju el-Hanefijju, EL-IHTIJARU LITA'LILI MUHTAR, boton "Darul Erkam" . bot. I. Bejrut 1420h./1999m.
3. Abdu Rrahman el-Xhuzejri, KITABUL FIKHI ALEL MEDHAHIBIL ERBE'ATI, boton "Darul Hadith", Kahiro
4. Es'ad Muhammed Se'id es-Sagruhxij, EL-FIKHUL HANEFIJU VE EDIL-LETUHU, boton "Darul Kelimi et-Tajjibi", bot. I. Damask-Bejrut 1420h/2000m.
5. Sejjid Sabik, FIKHU ES-SUNNEH, boton "Darul Fiker", bot. II. Bejrut 1419h./ 1998 m.
6. Burhanu Din Ebil Hasen bin Ebi Beker bin Abdul Xhelil err-Rreshdani el-Merganiju, EL-HIJDAJEH,

boton “Darul Kutubi el-Ilmijjeti”, bot. I. Bejrut 1410 h./1990m.

7. Dr. Vehbete Zuhajli, EL-FIKHUL ISLAMIJJU VE EDIL-LETUHU, boton “Darul Fikri”, bot. IV, Damask-Bejrut 1418 h./ 1997m.

8. Muhammed bin Ismail el-Kahlaniju/ Es-San’ani, SUBUL SELAM, boton “Darul Kutubil Ilmijjeti” , Bejrut. pa vit. botimi.

9. Sa’adi Ebu Xhejbi, EL-KAMUSL FIKHIJU, boton “Darul Fiker”, Damask 1419 h./ 1998m.

12. Muhammed Alijj Et-Tehanevijju, MEUSUAT KESH-SHAFI ISTILAHATIL FUNUNI VEL ULUMI, boton “Mektebetu Lubnan Nashirun”, bot. I, Liban 1996.

13. Muhammed bin Alijj Esh-Shewkaniju , NJELUL EVTAR, boton “Darul Hajri”, bot.II. Damask, 1418h./1998m.

14. Shemsuddin es-Serhasiu “KITABUL MEBSUT”, bot. I. Bejrut. 1993 m.

15. Ibrahim bin Muhammed bin Ibrahim el-Halebi , “MULTEKAL EBHUR” bot. I. Bejrut 1989m.

16. Muhammed Maxhid I'ter, "EL-MUFESSALU FIL FIKHIL HANEFIJJU", boton "Darul Fikri", bot. II. Damask 1418 h./ 1998 m.

17. Dr, Ibrahim Muhammed Selkini, "EL-FIKHUL ISLAMIJJU", boton "Xhamiatu Dimeshk", bot. i VII. Damask 1419 h. / 1999 m.

18. Alauddin Ebi Beker bin Mes'ud el-Kesaniju el-hanefijju, "BEDAIUS-SANAI'I FI TERTIBI SHERAI'I", boton " daru ihjai turathil arebijj" bot. i II. Bejrut 1419 h./ 1998m.

19. Ibn Abidini, "REDDUL MUHTAR", boton "Darul Fiker", Bejrut 1421 h./ 2000 m.
20. Abdul Ganij el-Gunejmi el-Mejdaniju, " EL-LUBABU FI SHERHIL KITABI", bot. III, boton "Darul Kitabil Arebijj", Bejrut 1418 h. / 1997 m.
21. Ibn Rushdi el-kurtubijj, "BIDAJETUL MUXHTEHIDI VE NIHAJETUL MUKTESIDI", bot. I. boton "Daru Ibn Hazmi", Bejrut 1416h./ 1995 m.
22. Fahrudin Ebibi, Irfan Abazi, Taxhedin Bislimi, Jusuf Zimer, "PESË SHTYLLAT E FESË ISLAME, Shkup 1998/1419
23. Vehbi Sulejman Gavoçi, "SHTYLLAT E ISLAMIT", boton "Instituti shqiptar i mendimit dhe qytetimit islam", Tiranë 1999.
24. Muhammed Seid Serdareviq "FIKHUL IBADAT", Prishtinë 1997.
25. Muhammed Ashik Ilahi el-Beruni, "ÇËSHTJE TË FIKHUT SIPAS KUDURIUT (I Ibadat)", përktheu Sabri Bajgora. prof. Prishtinë 2002

